47	Blerim Olluri	Parcelat 00657-0 dhe 00658-0 a qenë zonë	Pranohet	Rekomandohet që të trajtohet zona në kuader të veprimtarive ekonomike. Zonë për shërbime

		komerciale tani gjelbërim kundërshtojn këtë propozim		tregtare, sipas destinimit të percaktuar në PZHK Zona ekonomike M25. Pjese e zones
58	Liridon Hetemi	Në parcelën 01725-2 të rritet koeficienti të mosmbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet	Parcela është pjesë e zonës “Z2” nënzona “B2” e destinuar si zonë me densitet të mesëm të banimit ISN-3.2 , sipërfaqja e parcelës 20ari, ISHPKZH 40%, SNP 60%. Kjo pjesë rezulton me zhvillimet përgjate rrugëve , të cilat formojnë zonën mbështjellëse të qendrës së qytetit , dhe të njëjta janë planifikuar si zone kufizuese , pa ndonjë zgjerim .
60	Shqipdon Krasniqi Antigona Krasniqi	Parcela 01252-29 vetëm një cepë është prekur për ndërtim të lartë kërkojm që e gjithë parcela të hyjë në ndërtim me koeficient të lartë ose ndërtim të lartë	Pranohet	Parcelat të trajtohen në kuadër të zonës “Z6” nënzona “B4”. Zona banimi me densitet të mesëm.
61	Naim Stullca	Në parcelën P-71409044-02193-1 të rritet koeficienti të mosmbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet pjesërisht	Parcela është pjesë e zonës “Z2” nënzona “B2” me densitet të mesëm të banimit dhe “B7” densitet i ultë i banimit , pjesë e zones si teresi. Janë pjesë e zones e cila kufizohet me qendrën e qytetit .
62	Zenel Hetemi	Në parcelën P-71409044-01725-3 dhe 01725-4 të rritet koeficienti të mosmbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak.	Pranohet	Parcela është pjesë e zonës “Z2” nënzona “B2” e destinuar si zonë me densitet të mesëm të banimit ISN-3.2 , sipërfaqja e parces 20ari, ISHPKZH 40%, SNP 60%.

64	Zahir Hetemi	Në parcelën P-71409044-00743-2 të rritet koeficienti të mosmbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet	Parcela është pjesë e zonës “Z2” nënzona “B2” e destinuar si zonë me densitet të mesëm të banimit ISN-3.2 , sipërfaqja e parces 20ari, ISHPKZH 40%, SNP 60%.
72	“Standard Benz” SHPK	Parcelat 00751-1, 00768-3, 00768-4, 00771-2, 00772-1, 00773-4, 02083-16, 02083-17, 02083-18, 02083-19, 0283-20, 02083-37, 02083-39, 02083-41 dhe 02083-43 vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcela të përfshihen në banim të mesëm	Pranohet	Parcelat e shënuara janë pjese e zonës “Z2” nënzona “B6” , e destinuar i zonë me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat dhe definimi i zonave - “Zonat e mbrojtura sanitare”. Kjo zone do te jete pjese e zhvillimeve sipas Ligjit per ujerat , dhe kushtet kufizuese te ndertimeve .
73	“Gashi Invest- BF” SHPK	Në pjesën ZUP-1 ne si pronarë të kompleksit VERA kërkojm që koeficienti të vazhdoj të mbesë 3.6 siq ka qenë e jo të zbritet ne 2.8	Pranohet	Zona e cekur është pjesë e zones “Z6” nënzona “B2” e destinuar si zonë banimi me densitet te mesëm , K-3.2. Kjo pjese e shte pjese e zones e cila ka koeficient te jejt , dhe harmonizim me densitetin e parapar ne PZHK , ku zona ben pjese ne zonen e cila ka etazhitetin max P=8 .
74	Hysen Sahiti Idriz Kozhani Kushtrim Fazliu Hafir Gashi	Në pjesën ZUP-1 ne kërkojm që koeficienti të vazhdoj të mbesë 3.6 siq ka qenë e jo të zbritet ne 2.8	Pranohet , pjeserisht	Megjithese kërkesa nuk eshte specifikuar saktë, përketesisht zona e cila ka qasje në rrugen “Bashkim Krasniqi” është trajtuar në kuadër të zonës “Z6” nënzona “B4” e destinuar si zonë banimi me

	Heset Sahiti Gazmend Kozhani Rasim Gashi			densitet të mesëm , ISN-2.0. sipas PZHU kjo zone ka qene e planifikuar si zonë banimi individual. Kjo pjese e shte trajtuar si zone e banimit te mesem , mundesi harmonizimi me dendesine e para[pare ne PZHK , duke pase parasysh zonen si teresi .
76	NTP "LIMI PLAST"	Parcelat në pronësi tonë vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcelatë përfshihen në banim të mesëm 619-1, 619-40, 624-0, 625-1, 754-3, 764-4, 765-1, 766-1, 766-4, 72-5, 773-7. 2083-9, 2083-10 ,, 2083-14, 2083-35, 2083-40, 2083-44, 2083-45, 2083-48, 20830-49, 772-2, 773-3, 2083-38,	Pranohet	Parcelat janë pjesë e zonës "Z2" nënzona "B6" , e destinuar i zonë me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat dhe definimi i zonave - "Zonat e mbrojtura sanitare".
77	SHPK "XHELA"	Parcelat në pronësi tonë vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcelatë përfshihen në banim të mesëm 619-1, 619-40, 624-0, 625-1, 754-3, 764-4, 765-1, 766-1, 766-4, 72-	Pranohet	Parcelat e shënuara janë pjese e zonës "Z2" nënzona "B6" , e destinuar i zonë me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat dhe definimi i zonave - "Zonat e mbrojtura sanitare".

		5, 773-7. 2083-9, 2083-10 ,, 2083-14, 2083-35, 2083-40, 2083-44, 2083-45, 2083-48, 20830-49, 772-2, 773-3, 2083-38,		
78	Ekrem Misini Berat Reqica Enver Bislimi	Në pjesën ZUP-1 ne kërkojm që koeficienti të vazhdoj të mbesë 3.6 siq ka qenë e jo të zbritet në 2.8, 1888-0, 1887-2,	Pranohet	Parcelat e cekura janë pjesë e zonës “Z6” nënzona “B2” e destinuar si zonë banimi me densitet të mesëm , K-3.2, mundesi harmonizimi në teresinë e zonës , dhe harmonizim me PZHK .
79	Kreshnik Ademi	Parcelat 00771-4, 02083-47, 02212-0, 02213-0 dhe 02214-0 vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcela të përfshihen në banim të mesëm.	Pranohet	Parcelat janë pjesë e zonës “Z2” nënzona “B6” , e destinuar i zonë me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat përkatësisht kushtet dhe zonimi për “Zonat e mbrojtura sanitare”.
80	SHPK “CONEX GROUP”	Parcelat në pronësi tonë vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcelat të përfshihen në banim të mesëm 619-1, 619-40, 624-0, 625-1, 754-3, 764-4, 765-1, 766-1, 766-4, 72-	Pranohet	Parcelat e sheënuara janë pjesë e zonës “Z2” nënzona “B6” , e destinuar i zonë me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat dhe definimi i zonave - “Zonat e mbrojtura sanitare”.

		5, 773-7. 2083-9, 2083-10 ,, 2083-14, 2083-35, 2083-40, 2083-44, 2083-45, 2083-48, 20830-49, 2083-38,		
82	Besart Avdyli	Të mbetet plani siq ka qenë me PZHK tek Rr."Haxhi Kleqka" P-71409044-01878-3	Pranuar	Parcela është pjesë zonës "Z6" nënzona "B2" e destinuar si zonë banimi me densitet të mesëm , ISN-3.2
84	Sabit Grajqevci Hakif Grajqevci Naser Grajqevci Salije Troshupa Islam Beqaj Bedrije Arifi Kujtim Arifi Edita Arifi Gamend Arifi Zyhdi Avdullahu Feim Avdyli Lumne Avdyli Zyhdi Avdullahu Bashkim Marevci Besim Shefkriu Valbona Dragaqina	Banorët e Rr."Mbretëresha Teutë" kërkojm rritjen e koeficientit të bëhet banim i lartë sikurse në të dy anët e bllokut e të mos mbetet banim i mesëm por banim i lartë përkatësisht për parcelat 1306-1, 1306-2, 1306-2, 1306-3, 1037-2, 1307-3, 1308-4, 1304-4, 1309-4, 1308-6, 1306-8, 1306-7, 1306-6, 1306-5, 1306-4, 1306-1, 1305-0, 1308-7	Pranohet pjesërisht	Parcelat janë pjesë e zonës "Z1" dhe "Z5", përkatësisht nënzonat "B1" banim i lartë ISN-4.0 si zonë e cila krijon përmbyllje të Bllokut duke krijuar ndërlidhje me rrugën "Haradin Bajrami" dhe kryqëzim me rrugën "Isa Olluri" , ndërsa pjesa tjetër është planifikuar banim i mesëm nënzona "B3" . ISN-2.5. Mundesi harmonizimi me PZHK , krijim i silueteve të qytetit , dh mundesi nderhyrje ne zone si teresi .
87	Adriatik Beqa	Propozim Qendra, ZUP-1, ZUP-2 ZUL-8 ZUL-9	Pranohet pjesërisht	Janë trajtuar zonat dhe janë definuar si Zonat "Z1", "Z2", "Z3", "Z4", "Z5, Z6, Z7, Z9 dhe Z9 dhe ZE Në kuadër të zonave janë definuar nënzonat :

	ZBL , parcela Smin 2000m² Fronti i parceles 45m' ISN 3.8 Etazhiteti B+P+8 40% SNP min 65% SGJP 30% VNnt. L=15m' Distanca anesore mos te kete pelqim fqinjesor ZBM , Smin 1500m² Fronti i parceles L=35m' ISN 3.0 Etazhiteti B+P+7 ISHPKZH 40% SNP min 65% SGJP-40% VNnt= L=15m' ZBU Smax 1200, min 300 m2 ISN 0.8 Etazhitet B+P+2 ISHPKZH 40% SNP min 40% GJP 40% VN 10m'	B1, B2, Br, B4, B5, B6, B7, neë kuader të nënzonave janë prezentuar koeficientet e ndërtimit B1, K-4 B2, K-3.2 Br, K-2.5 B4, K-2 B5, K-1.8 B6, K-1.6 B7 , K-0.8
--	--	---

92	Shefqet Sylejmani Bedri Sylejmani	Në parcelën 01186-8 dhe 01186-9 të rritet koeficienti të mosmbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet	Parcelat janë pjesë e zonës "Z6" nënzona "B2"
7	Kadri Spahiu	Të largohet rruga e planifikuar parcelat P-71409044-00700-1, 700-2, 700-3, 700-4. 700-5, 700-6. 700-7, 700-8	Refuzohet	Rruga e planifikuar është pjesë e zonës "Z2" dhe krijon rrjetin primar në zonë që ndërlidh zonat banimore me densitet të mesëm dhe të ultë.
8	Ramadan Sejdiu	Parcela P-71409044-00175-0 të lejohet ndërtimi të mosmbesë gjelbërim	Refuzohet	Parcelat kadastrale P-71409044-00175-1 dhe P-71409044-00175-2, janë trajtuar sipas PZHK, kufiri ndërtimor i zonave .
9, 10 , 32-(ka pa qartësi në pyetje dhe përgjigje);				
9	Fadil Krasniqi	Zonat industriale të mbesin siq kanë qenë me PZHK, zone ekonomike M25, në ZK Grackë e Vjetër , e jo gjelbërim, që ka të bëjë me pjesën e planifikuar si zone ekonomike sipas PZHK, ndërsa me HZK nuk është parapare .	Pranohet	Zona është trajtuar sipas gjendjes së planifikuar me PZHK, e cila është destinuar si Zone Ekonomike M25 , edhe e njëjta planifikohet si Zonë për shërbime tregtare .
10	Behlul Sylja	Të largohet rruga e planifikuar në kuader të praelave kadatsrale P-	Pranohet	Planifikohet rruga që definon zonën ndërtimore kufizon parcelat e shënuara, që arsyeton faktin e kufizimit me kufirin ndërtimor të zonës.

		71409044-00173-3 , dhe p-71409044-00173-4 , rruga e emërtuar Rr. "Idriz Seferi" , e propozuar sipas HZK .		
32	Milazim Lubovci	I Pakënaqur me propozimin sipas HZK , i cili parashef zone komerciale dhe banim i ultë, përkatësisht zona ne t cilën jane koncentruar parcelat kadastrale P-71409044-01280-3, P-71409044-01280-1 dhe P-71409044-01280-2.	Pranohet	Ankesa pranohet , dhe e njehta eshte trajtuar sipas kushteve t percaktuara ne PZHK pasi qe kjo zone eshte e destinuar si zone banimi kolektiv dhe etazhitet max P+6, dhe bazuar në kete kjo zone eshte pjese e zones se planifikuar ne HZK, Zona "Z5" nënzona "B4" zonë banimi me densitet të mesëm dhe pjesa kufizuese me rrugën "Haradin Bajrami", sipas koeficienteve te përshktuar
13, 14, 19, 20, 21, 23, 24, 28,30 , 33, 34, 35, 36, 53, 54, 55, 65, 66, 67, 68, 69, 70,71, 85,91, -(të epet sqarim, nëse sipërfaqja e gjelbërimit është sipas NTPH. Vetëm me PZHK mund të ndryshohet densiteti dhe shfrytëzimi i tokës));				
13	Nazim Bytyqi	Të largohet gjelbrimi në hapësira ku komuna ka lëshuar Leje ndërtimore	Pranohet	
14	Sami Bytyqi	Kundërshtoj gjendjen e planifikuarTë largohet gjelbrimi në ZUL-4	Pranohet	

19	Ilir Zeqiri	Të largohet gjelbrimi dhe zona të kthehet në ndërtim siq ka qenë.	Pranohet	Kerkesat e prezentuara i referohen zones se njejt e cila sipas HZK ka parapare siperfaqe te lire – gjelbrim urban. Megjithëse nuk është specifikuar qartë parcela, te dhenat jane pmarre sipas konsultimeve me banoret , atëher bazuar ne planifikim ne HZK , zona e lire , pa ndonje destinim te caktuar apo gjelbrim urban , eshte trajtuar dhe e njejta eshte propozuar te jete zonë banimi me densitet te ultë , përkatësisht Zona “B2” Nënzona “B7”. Kjo pjese sipas PZHK eshte e desinur si zone banimi e ulte, andaj kerkesa pranohet duke iu referuar PZHK dhe numrit te kerkesave ne kete zone si dhe mundesise se krjimit te blloqeve , shfrytezimit racional te hapësires Si zone banimi individual , arritja e siperfqes se nevojisme te hapësires gjelberuese mund te arrihet permes zhvillimeve n kuader te parces individuale sipas koeficienteve te pershkrar ne pjese tekstuale .
20	Suzana Vehapi	Tek termoventi te largohet gjelbrimi	Pranohet	
21	Ramadan Bytyqi	Të largohet gjelbërimi ekziston shtepi, planifikojme që të ndertohen shtepi tjera	Pranohet	
23	Faton Bytyqi	Kundërshtoj zonën e gjelbërt tek Termoventi	Pranohet	
28	Lumnije Konxheli	Në parcelën 00671-11, të kthehet banim siq ka qenë e jo të	Pranohet	

		mbesë zonë gjelbëruese	
34	Visar Hashani	Parcelat P-71409044-02046-9, të hyjnë në banim të mesëm	Pranohet
53	Ilir Hajrollahu	Të largohet gjelbërimi përkatësisht nga parcelat P-71409044-00032, 33 dhe 34 ka qenë zonë ndërtimore dhe nuk mund të jetë në mes të qytetit zonë 30 hektarëshë zonë gjelbëruese	Pranohet
54	Fidan Ibrahimi	Parcelat kadastrale 51, 52, 645-2, 644-0, 643-0, 641-0 dhe 642-0 të largohet gjelbërimi dhe të kthehet zonë ndërtimore siq ka qenë.	Pranohet
55	Ramiz Ajeti	Parcela 00686-5 ZUL-4 të mos mbetet zonë e gjelbërt por të kthehet siq ka qenë banim i mesëm për shtëpi	Pranohet
65	Besim Ibrahimi	Parcelat P-71409044-00649-0, 02195-1, 02195-2, 02195-3 dhe 02195-6 janë planifikuar si zonë gjelbëruese, kërkojm të kthehen si zonë e banimit individual	Pranohet

66	Vadet Zatriq	Parcela P-7109044-00678-0 janë planifikuar si zonë gjelbëruese, kërkojm të kthehen si zonë e banimit individual	Pranohet
67	Burim Gashi	Parcelat 00679-0 dhe 00680-0 janë planifikuar si zonë gjelbëruese, kërkojm të kthehen si zonë e banimit individual	Pranohet
68	Shpejtim Ibrahimi	Parcelat P-71409044-00645-1, 00645-3, 00645-4, 00646-0, 00650-0 dhe 00675-0 janë planifikuar si zonë gjelbëruese, kërkojm të kthehen si zonë e banimit individual	Pranohet
69	Jetish Ibrahimi	Parcelat P-71409044-02195-4 dhe 02195-5 janë planifikuar si zonë gjelbëruese, kërkojm të kthehen si zonë e banimit individual	Pranohet
85	Naim Hajrizi	Në parcelat p-71409044-00662-4, 662-5, 662-7 dhe 662-8 është planifikuar si zonë gjelbëruese,	Pranohet

		kundërshtoj që të mbetet zonë gjelbëruese dhe sugjeroj që kjo pjesë të hyjë në kufij ndërtimor		
91	Nazim Ibrahim	Parcelat P-71409044-00655-0 656 , zona gjelbrimi te jete zone banimi	Pranohet	
24	Banush Fazliu	Në parcelat 01252-93, 01252-94, 02147-3, 02147-4, parcelat kanë qenë ndërtim i lartë ndërsa tani me HZK, është zonë ujore, në këtë pjesë ka shumë ndërtime B+P+8, dhe të vazhdohet edhe në këto parcela njejt siq ka qenë 1252-76	Pranohet pjesërisht	Parcela në fjalë do të trajtohet në kuadër të zonës së banimit me densitet të mesëm , si dhe kufizimet me zonën ekzistuese të ujërave., si dhe koeficienteve te pershkruar me lart "B4" . ku pjesa gjelberuese trajtohet ne kuader t blloqeve dhe zones si teresi sipas koeficienteve te pershkruar me larte .
30	Lutë Fetahu	Te kthehet banimi i larte siq ka qene	Pranohet	Zonë e planifikuar "Z5" nënzona "B4" zonë banimi me densitet të mesëm dhe zonë komerciale, koeficienti për nënzonën 2, sip. e parceles 10ari. Kjo zone eshte pjese e vendit te KK, e cila eshte destinuar si zone banimi kolektiv per kategorite e dala nga lufta e UCK , e njejta eshte e parapare me destinimin e njejt ne PZHK , e cila trajtohet sipas koeficienteve te pershkruar me larte .
33	Agron Buja	Parcela P-71409080-00166, P-71409080-00167-0 dhe 168 , 165, jane te rrethuara me parcelat e planifikuara si	Pranohet	Rekomandohet që të trajtohet zona në kuadër të veprimtarive ekonomike . Zonë për shërbime tregtare. Pasi parcelat jane pjese e zonese e cila sipas PZHK eshte e destinuar si zone ekonomike M25.

		zone ekonomike zona kadastrale Grackë e Vjetër kërkoj që të futen brenda zonës komerciale pasi që vie deri në kufi kjo zonë		
35	Rasim Gashi	Te lejohet banim i lartë te rruga “Tahir Sinani “	Pranohet pjesërisht	Kjo ehste trajtuar sipa s Z2 ZB2”.
36	Ismet Qukollci Sahit Krasniqi Shukri Kozhani Eset Bytyqi Ashim Sopjani Shemsi Banushi Milazim Bytyqi Senad Mustafa Musli Mustafa Osman Jashari	Të jetë banim i lartë pasi që deri në kufi me parcelat tona P- 71409044-01349- 4, 1349-1, 1350-0, 1349-1, 1349-2, 1348-2, 1348-6, 1348-5, 2099-0, 1450-8, 1348-1, 1348-3, 1347-7, 1347-6 dhe 1347- 1 është ndërtimi i lartë kërkojm që të vazhdohet edhe në bllokun tonë pasi që plotësojm të gjitha kriteret dhe nuk na u është ofruar mundësia asnjëherë	Pranohet	Rrekomandohet qe parcelat të trajtohen si zonë me densitet të mesëm, nënzona “B4”. Rritja e dendësise me qëllim te harmonizimit te zhvillimeve dhe krijimin e shtrirjes se qendres se Qytetit , si zone e cila nderlidhet me zonen e Z1. Me qlim te krijimit te siluetes se qytetit dh kerksave te banoreve .
70	“Pharmaplus” SHPK	Parcelat 00772-2, 00773-3 dhe 02083-38 vetëm një pjesë e këtyre parcelave është hyrë brenda ndërtimit të mesëm, kërkesa jonë është që të gjitha këto parcela të përfshihen në banim të mesëm	Pranohet	Parcelat e shënuara janë pjesë e zonës “Z2” nënzona “B6” , e destinuar i zone me densitet të mesëm të banimit , dhe trajtimi i tyre sipas kufizimeve përkatësisht kushteve të përcaktuara sipas Ligjit për ujërat dhe definimi i zonave - “Zonat e mbrojtura sanitare”.

71	Ragip Avdyli	Parcelat P-71409044-00686-3, 689-0, 690-1, 688-0, 693-1, 683, zona e gjelbër të jetë zonë banimi , dhe zonë industriale më e zgjeruar .	Pranohet	Parcelat janë pjese e zonës 'Z2" dhe jane trajtuar ne pjesën e destinuar zonë komerciale., pjese e njejt sipas PZHK .
37, 48- të rishikohet				
	Isuf Marevci Salihe Marevci	Të zhvendoset rruga e planifikuar nga parcela 02148-1 ku edhe jemi të paisur me Leje ndërtimi 8-351-16378	Refuzohet	Traseja e planifikuar e rrugës është e trajtuar me HZK dhe e njëjta është pjese ndërlidhëse e zonës . Kjo pjese e shte e definuar dhe nuk ndikon ndertimin ekzistues.
48	Pronarët e Rr."Isa Dema" 6 pronarë Islam Hajnuni	Banorët e Rr."Isa Dema", kërkojnë që të vazhdohet ndërtim i lartë pasi që deri në kufi është pozicionuar ndërtimi i lartë Rreth lumit Janjevka nga Banim i ulët të jetë banim i lartë, pasi që e gjith zona është me densitet të tillë	Refuzohet	Kjo zonë mbetet sipas gjendjes se planifikuar me HZK, përkatesisht e definuar në kuadër të Zonës "Z1", nënzona "B7" zonë banimi me densitet të ultë, pasi që zona eshte e kufizuar me kompleksin e Shkollës dhe lumin "Janjeva", kufizimet ne pjesën jugore dhe juglindore. Kjo ceshtje eshte trajtuar ne disa nga kerkesa , dhe bazuar ne poziten dhe madhesin e zones dhe pamundesit zgjerimi nuk ekzistojn kushtet per ndertim te laret perkatesisht rritje te dendesise , kjo mbetet sipas gjendje se PZHK dhe aktualisht HZK , zone banimi e ulte.
38, 52- të rishikohet dhe të sqarohet dhe trajtohet sipas dispozitave të dhëna me Ligjit për Zonat e Mbrojtura. Si e tillë nuk kemi pasqyrë të qartë!				
38	KBI Lipjan	Kundërshtojm gjendjen e në parcelën 01672-0 e pjesa e cila eshte percaktuar si ZVM, te definohen Kushtet	Pranohet	Parcela P-71409044-01672-0 është pjesë e ZVM, e njëjta do të trajtohet sipas Ligjit për ZVM. Parcela ne fjale e shte pjese e ZVM , dhe do te trajtohet konform Ligjit per ZVM.

		ndertimore , te trajtohet parcela		
52	OSBE-Blerim Agani	Të precizohet pjesa e zonës së mbrojtur përkatësish "Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës" këtu të precizohen parcelat të cilat hyjnë në këtë zonë	Pranohet	Rekomandohet që të vendoset kufiri i Zonës së veçantë të mbrojtur dhe të dhënat e përgjithshme – elementet e rregullimit në zonë. Parcelat që janë pjesë e ZVM , janë të definuara në PZHK , dhe HZK.
39, 51- Trajtimi dhe përgjigjja të jetë në harmoni me Ligjin dhe Udhëzimet Administrative. Çdo parcelë kadastrale për zhvillim duhet të ketë qasje në rrugë publike!				
39	Fitnete Burhani	Në parcelën 01252-52 parcela ka mbetur pa qasje në rrugë, për krahasim nga planifikimi i kaluar, propozoj që të vazhdohet siq ka qenë e planifikuar me PZHU .	Refuzohet	Parcela është pjesë e zonës “Z6” nënzona “B4” , e cila është planifikuar zonë banimi me densitet të mesëm, dhe varësisht nga pozita dhe kushtet e parcelës trajtohet në kuadër të zonës. Në këtë zonë definimi i qasjes dhe krijimi i blloqeve të banimit do të jenë pjesë e procesit implementues, që varet nga zhvillimet do të trajtohen në bashkëpunim me të gjithë pronarët në zonë, me qëllim të krijimit të kushteve për shfrytëzim të parcelës dhe hapësirave në interes publik, që do të rezultojnë me bonusetë zonimit si njëri nga proceset që do të jenë pjesë e zbatimit të HZK.
51	Shaban Zeneli Rexhep Bytyqi Ejup Sahiti Naim Zeqiri	Në parcelat 1282-6, 1287-7, 1282-8, 1282-9 dhe 1282-10 kërkojmë që të na mundësohet qasja në rrugë publike, apo të na ofrohet ndonjë mundësi qasjeje siq ka qenë me PZHU, e jo të na bllokohen parcelat, apo të ofrohet	Pranohet pjesërisht	Qasja në parcelat të trajtohet përmes rrugës së planifikuar , e cila do të shërbejë si rrugë për qasje në zonë . Qasja në rrugën publike do të jetë pjesë e procesit të rregullimit të parcelave, legalizimeve dhe krijimit të kushteve për planifikim perkatesisht rregullimi i bllokut , pasi që zona është mjaft e kufizuar dhe krijon kushte për krijimit të shtegut për qasje në

	Xhabir Sahiti	ndonjë munda që së bashku me pronën e shkollës "Ismail Luma" dhe ta lëshojmë rrugën së bashku		rruge publike e cila do të jetë pjesë e zhvillimeve tjera, si shporesimet apo marreveshjet për definimin e qasjes përmes pronave private.
49, 50-Përgjigja e dhënë lidhur me Kushtet zhvillimore është në kundërshtim me Ligjin për planifikimin hapësinor. Të rregullohet zona!				
49	Isak Gashi	Në parcelën 01720-0, 01722-0 të rritet koeficienti të mos mbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet pjesërisht	Parcela në fjalë është pjesë e zonës "Z2" në zonën "B2" e destinuar si zonë me densitet të mesëm të banimit ISN-3.2 , sipërfaqja e parces min. 20ari, ISHPKZH 40%, SNP 60%. Parcelat në fjalë janë pjesë e zonës e cila bazuar në gjendjen faktike dhe mundësitë zhvillimore është trajtuar si pjesë e zonës kufizuese me qendrën e qytetit , dhe se zhvillimet në këtë pjesë pjesërisht janë dendesi e mesme , dhe se të njëjta planifikohen në zonë kufizuese me pa mundësi zgjerimi ., bazuar në gjendjen e përgjithshme mundësia e formimit të bllokut dhe trajtimi i zonës së interesit .
50	Gani Gashi	Në parcelën 01722-1 të rritet koeficienti të mos mbes 2.8, si dhe sipërfaqja nëntokësore të rritet deri 70-80% sepse 35% është shumë pak	Pranohet pjesërisht	Parcela në fjalë është pjesë e zonës "Z2" në zonën "B2" e destinuar si zonë me densitet të mesëm të banimit ISN-3.2 , sipërfaqja e parces min. 20ari, ISHPKZH 40%, SNP 60%, përgjigja e dhënë në nr.49.
63- Të rishikohet. Shfrytëzimi i tokës mund të caktohet vetëm me PZHK!				
63	Bujar Salihu Eron Salihu Afrim Salihu	Parcelat 00022-20, 00022-21, 00022-22, 00022-23, 00022-24,	Pranohet	Sipas PZHK kjo pjesë është e destinuar si zonë banimi individual , mirëpo bazuar në kushtet e përgjithshme, dendësia banimore

	Ilir Salihu Mehdi Salihu	02190-6, 02190-1, 02190-2, 02190-3, 02190-4 dhe 02190-5 nuk janë përfshirë në zonën ekonomike, duke marrur parasysh se këto parcela kufizohen me zonën ekonomike, kërkojm që të hyjën brenda zonës ekonomike		dhe kushtet zhvillimore , eshte pranuar kerksea ashtu qe kjo pjese te jete vazdhimesi e zones ekonomike ekzistuese dhe se e njejta bazuar ne gjendjen faktike dhe kushtet zhvillimore ploteson kusht te zhvillohet si zone me sherbime tregtare . Parcelat janë pjesë e zonës “Z3” e cila planifikohet si zonë për shërbime tregtare.
88-Të merren parasysh Ligjet në fuqi dhe NTPH!				
88	Hashim Sopjani	Parcelat P-71409044-00921-1, 01145-0, 01211-2, 01211-7, 01545-4, 01546-1, 01546-2, 01546-3 dhe 01547-0 me PZHK ka qenë 50% ndërtim I lartë dhe 50% ndërtim I ulët ndërsa tani me HZK është e destinuar si zonë ujore, kërkoj që të mirret parasysh të kthehet siq ka qenë ose të ofrohet një zgjidhje e të mos mbetet siq është planifikuar tani	Pranohet pjesërisht	Parcelat janë pjesë e zonës “Z7” pjesë e destinuar si zonë komerciale , përgjate rrugës “Ibrahim Rugova” dhe pjesë e banimit me densitet të mesem nënzona “B6”. Pjese zones se kombinuar dhe eshte trajtuar si terei e zones , harmonizim me destinimne planifikuar ne PZHK .
89, 90, 93- Të jetë sipas Ligjit për planifikimin hapësinor dhe U.A. dhe PZHK në fuqi!				
89	Grupi parlamentar PDK-Lipjan Lulzim Rrustemi	1.Tek ish tregu i gjelbërt të planifikohet "Park", 2. Blloku i parcelave tek Rr."Haxhi Kleqka" në lidhje me "Haxhi	Pranohet pjesërisht	1. – zonë shërbyese rekreative 2. Banim i Mesëm 3. Banim i Mesëm 4. Banim i ulte, pershka te zones se kufizuar, pozita dhe madhesia, nuk mund


	Kleqka" nga zonë e banimit me densitet të mesëm të kalojë në dendsitet të lartë, 3. Rr."Lulzim Llugiqi" të kalojë në dendsitet të mesëm, 4. Blloku i parcelave tek lumi Janjeva dhe mes shkollës "Ulpiana" të kalojë ZBM, 5. Në të dy anët e Rr.'Haradin Bajrami" të dy anët e rruges të kalojnë në Zone e banimit të lartë, 6.Tek udhëkryqi Lipjan-Shtime-Magure të kthehet siq ka qenë banim i lartë për kategoritë e dala nga lufta e të mos mbesë banim i ulët, 7.Zona komerciale përgjatë magjistrales Shtime-Lipjan të mbesë e plotë e të mos ketë shkëputje, Rruga Lipjan-Banullë të planifikohet pa shkëputje dhe të jetë nga Zona banimit të ulët në banim të Lartë, 8.Të specifikohet zona e mbrojtur të	te kete dendesi me te madhe te banimit . 5. Zonë komerciale dhe banim i mesem 6. Banim i mesëm , sipas PZHK , dhe rekomandohet të trajtohet sipas kushteve të përcaktuara me Vendimit të Kuvendit të Komunës. 7. Zonë komerciale 8. Zona e mbrojtur sipas ZVM, eshte 9. Banim i mesem 10. Elementet rregullimit të përshkruara sipas zonave dhe nënzonave të definuara në pjesen tekstuale të Raportit . Te gjitha kerkesat kane te bejn me kushtete percaktuara kryesisht ne PZHK , dhe te njejt jane trajtuar ne, duke pase parasysh gjendjen faktike, numrin e kerkesave dhe arsyeshmerine duke marre perbaze , poziten gjendjen aktuale dhe kushtet zhvillimore.
--	---	--

		kisha ortodokse Lipjan, 9.Të planifikohet pa shkëputje tek blloku i parcelave nga udhëkryqi i hekurudhës rruga për Konjuh deri tek lumi Janjevka deri tek Standartbenz dhe të jetë banim i Mesëm. 10.Tek ISN, SHPKZH, ISHP, madhësia e parcelës dhe ballorja e parcelës të rishikohen 11.ZBM , madhësia e parces me shume njesi 1500m² , balli 25 m' ISN max 3 , SNP max 50% 12.Te ZBL madhësia e parces 2000 m2 , balli 40m' ISN max 3.6 SNP max 50%		
90	Lutë Fetahu	Në parcelën 00385-0 unë e kamë shëndrruar tokën nga bujqësore në ndërtimore dhe dëshiroj të metet siq ka qenë me PZHU	Pranohet	Zona të trajtohet si tërësi sipas Vendimit të KK, planifiohet të jete Zonë banimi densitet i mesem nënzona "B6", , pergjigja e dhene ne nr.89.
93	Fidaim Berbatovci	Pronar i parcelës 948-2 sipas HZK kjo zonë planifikohet banim individual ne si lagje propozojm që	Refuzohet	Kjo zonë mbetet sipas gjendjes së planifikuar me HZK, dhe PZHK përkatesisht e definuar në kuadër të Zonës "Z1", nënzona "B7" zonë banimi me densitet të ultë, pasi që zona është e kufizuar me

	të hyjë në banim kolektiv pasi që banimi kolektiv vie deri në kufi të parcelave tona		kompleksin e Shkollës dhe lumin “Janjeva”, kufizimet ne pjesën jugore dhe juglindore. Pergjigjja e dhene nr.89.
--	--	--	---

2.3 RAPORTI PËRMBLEDHËS I OBLIGIMEVE NGA DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

FIGURA 4: KONCEPTI ZHVILLIMOR I PHK



Me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova është ndarë në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona.

Zona ku bënë pjesë Komuna e Lipjanit: Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) – Zonë administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agro-industriale, turistike. Kjo tërësi paraqet pjesën verilindore të Kosovës të përbërë përpos Lipjanit edhe nga komunat: Prishtina, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Drenasi dhe Shtime në qendër me qytetin e Prishtinës. Vizioni i Portit të Kosovës: me Vizion të zonës parashihet si një Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet duke përfshirë edhe Lipjanin tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrent me

qytetet tjetra të zonës e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke tentuar të shfrytëzoj pozitën e të qenit afër Prishtinës si kryeqytet, me seli të qeverisë dhe zyrave diplomatike, lidhje të mira me qytetet fqinje kosovare dhe ato jashtë kufijve, përmes rrjetit të infrastrukturës fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, energjetike) si dhe asaj administrative dhe institucionale. Të lidhura në rrjet, Lipjani dhe qytetet thërra në këtë zonë krijojnë kushte të volitshme për veprimtari ekonomike, industriale, komerciale dhe shërbyese. Në qendër të zonës së kaltër (trekëndëshi Lipjan-Fushë Kosovë – Prishtinë), parashihet të zhvillohet si TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare. Lipjani si një Qendër e vogla e pozicionuar në zonën e kaltër, në zhvillimet e ardhshme hapësinore duhet të luajë rol aktiv në:

- Përmirësimin e ofertës së shërbimeve dhe ato të jenë më efikase,
- Në forcimin e lidhjeve me fshatrat përreth dhe
- Në përpjekjen që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të përcaktuara zhvillimore.


Komuna e Lipjanit pozicionohet në vend të rëndësishëm edhe për shkak të zonave dhe monumenteve të mbrojtura të natyrës: Shpella e Gadimes, Lipjan – gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore, si dhe Parku Nacional Blinaja, që do të mund të zhvillohej në një qendër rekreative, atraktive për tërë rajonin.

Zona me Interes të Veçantë Kleçkë – Divjakë, paraqet një hapësirë të rëndësishme të cilin gjenden të gjitha objektet me rëndësi të veçantë nga koha e luftës së UÇK-së në këtë zonë (shtabi përgjithshëm,

spitalet, varrezat e dëshmorëve, pikat e rëndësisë luftarake, „Radio Kosova e Lirë”, bunkerët e luftës, kampet e refugjatëve të luftës etj.) si dhe monumentet e natyrës, që shtrihen në territorin e tri komunave. Zona me Interes të Veçantë „SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë”, i ka në total 39km². Përveç Lipajnit pjesë e zonës me Interes të veçantë janë edhe komunat Malishevë dhe Glogoc. Prandaj synimet e përbashkëta zhvillimore me këto komuna janë si në vijim:

- Edukimi, informimi dhe promovimi i vlerave historike, kulturore, natyrore dhe turistike për ZIV“SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”; Promovimi i parkut historik dhe kulturor ZIV, brenda dhe jashtë Kosovës; Bashkëpunimi i komunave në të cilat gjendet zona;
- Menaxhimi objekteve historiko-kulturore dhe natyrore të zonës;
- Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut
 - Mbrojtja e ajrit, ujit dhe tokës
 - Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe monumenteve natyrore brenda zonës
 - Zhvillimi rural dhe turizmi fshatar- ekologjik
 - Zhvillimi i blegtorisë dhe bletarisë
 - Ngritja e cilësisë në arsimim dhe shëndetësi
 - Sigurimi i qasjes përmes rrugëve në të gjitha objektet dhe monumentet e zonës dhe sigurimi i transportit publik
 - Sigurimi i furnizimit me energji elektrike
 - Ndërtimi i infrastrukturës ujore dhe menaxhimi i mbeturinave


HARTA 2: SIPËRFAQET DHE NDËRTESAT ME RËNDËSI PËR KOSOVËN




3 KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtyre rregullave është që të ofrojë një platformë të standardizuar të normave për komunën e Lipjanit gjatë procesit të lëshimit të lejeve ndërtimore. Rrjedhimisht, këto rregulla dhe të tjerat në kaptinat në vijim do të ndihmojnë që të gjitha zhvillimet dhe rihvillimet në komunë të kontribuojnë pozitivisht në mjedisin e ndërtuar dhe kualitetin e jetës së qytetarëve. Në vijim janë paraqitur kushtet e përgjithshme për zhvillim të cilat janë të aplikueshme për të gjitha zonat e identifikuara në kaptinën 4 dhe të gjitha tipologjitë e ndërtimit. Rregullat në vijim paraqesin kushtet për parcelim dhe riparcelim, përfshi formën e parcelës, raportin në mes të brinjëve të parcelës, ballin e parcelës dhe thellësinë e parcelës. Në të njëjtën kohë, në këtë kaptinë janë paraqitur rregullat për vendosjen e objekteve në parcelë, matjen/përcaktimin e lartësisë së objektit në terren të pjertë dhe të rrafshët, dhe distanca në mes të objekteve dhe parcelës.

Parcelimi dhe riparcelimi: Format e të gjitha parcelave për zhvillim duhet të jenë forma të rregullta: katror apo drejtëkëndësh.




ILUSTRIMI 1: PARCELA KADASTRALE



Raporti në mes të brinjëve të parcelës, respektivisht në mes të gjerësisë dhe thellësisë, rregullohet sipas formulës në vijim:


$$a \leq b \leq a + \frac{1}{2} a$$



ILUSTRIMI 2: FORMAT E PARCELAVE


Në rastet kur forma e parcelës për zhvillim nuk ka formë të rregullt, kushtet si në figurat në vijm duhet të përmbushen.

ILUSTRIMI 3: PËRCAKTIMI I BRINJËVE PËR FORMA JO TË RREGULLTA TË PARCELËS




ILUSTRIMI 4: BALLI I PARCELËS SË SHËRBYER ME SERVITUT

Në rastet kur parcela ka qasje në rrugë vetëm nëpërmes servitutit, atëherë balli i parcelës llogaritet brinja nga e cila parcela ka qasje në rrugë përmes servitutit.



Në rastet kur parcela përdoret për rihvillim (objekt shumë banesor) e tërë gjerësia e parcelës duhet të kufizohet me rrugë. Do të thotë që, e tërë gjerësia e parcelës kadastrale për zhvillim duhet të jetë e barabartë me ballin e parcelës, pavarësisht nëse parcela e përmbush kriterin për ballë të parcelës.

ILUSTRIMI 5: PËRCAKTIMI I BALLIT TË PARCELËS




Përcaktimi i lartësisë së objekteve varësisht nga tipologjia e ndërtimit dhe terrenit rregullohet si në vijim:


ILUSTRIMI 6: PËRCAKTIMI I LARTËSISË SË OBJEKTEVE

Në terren të rrafshët, kuota zero llogaritet niveleta e rrugës.

Lartësia e objektit për banim me kulm të pjerrët përcaktohet nga kuota zero deri tek gjysma e lartësisë së kulmit të pjerrët.




Lartësia e objektit për banim me kulm të rrashët përcaktohet nga kuota 0.00 deri tek pika më e lartë e objektit.




Lartësia e katit në objektet (individuale, dyshe dhe në rend) për banim është 3.0m.

Objektet me kulm të pjerrët: këndi i kulmit max 30°


Objektet me kulm mansard: këndi i parë max 65°, dhe këndi i dytë max 30°.




Lartësia e përdhesës në objektet (individuale, dyshe dhe në rend) që shërbejnë për banim dhe afarizëm është max 4.0m.







Tek objektet shumë banesore me shfrytëzim të përzier, në rastet kur përdhesa dhe kati i parë shfrytëzohen për afarizëm, lartësia e katit është max 4.0m.



Në terren të pjerrët kuota zero llogaritet kuota mesatare në mes të kuotës me të ulët dhe asaj më të lartë.



Tek objektet me kullm të pjerrët lartësia e ndërtesës përcaktohet nga mesi i lartësisë së kulmit dhe kuotës zero.




Përcaktimi i distancave dhe pozita e objekteve


Përcaktimi i distancave në mes të objektit në raport me vijën ndërtimore, vijave anësore, të fundmë të parcelës, dhe në raport me objektet tjera të cilat gjenden në të njëjtën parcelë, rregullohet si në vijim:

ILUSTRIMI 7: PËRCAKTIMI I DISTANCAVE DHE POZITA E OBJEKTEVE


Vija ndërtimore paraqet vijën e cila përcakton kufirin e gabaritit mbitokësor të objektit apo objekteve në katet e përdhese apo për tërë gabarin e objektit. Në mes të vijës rregulluese dhe ndërtimore nuk lejohet asnjë lloj ndërtimit, përveç shkallëve për qasje në objekt.




Lartësia maximale e shkallëve për hyrje është 0.9m në rastet kur vija ndërtimore është min 3.0m nga vija rregulluese. Në rastet kur lartësia e shkallëve e kalon 0.9m duhet të vendosen brenda gabaritit të objektit.




Lartësia e gardhit duhet të jetë max 1.40m, nga e cila lartësi vetëm max 0.9m bën të ndërtohet me material të fortë.



Distanca në mes të objekteve në parcelë, në raport me vijën ndërtimore, vijave anësore dhe fundore të parcelës përcaktohet horizontalisht. Përcaktimi i distancës nuk e përcjell terrenin/relievin në të gjendet parcela.




Pozita e objekteve në parcelë duhet të korrespondojë me vijën ndërtimore pavarësisht orientimit të objektit.



3.1 KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME PËR TERËSI HAPËSINORE

Kushtet zhvillimore të përgjithshme janë hartuar edhe për tërësi hapësinore, të cilat janë të definuara në PZHK në kuadër të konceptit për zhvillim. Duke marrë parasysh karakteristikat e ndryshme të tërësive hapësinore, kushtet zhvillimore të përgjithshme vlejnë për tërësi hapësinore në veçanti, përveç në rastet ku rregullat aplikohen në tërë territorin e komunës. Tërësitë hapësinore të përcaktuara nga PZHK janë: **Qyteti, Toka Bujqësore, Pyjet dhe Aeroporti.**

HARTA 3: SHITESAT E PËRGJITHSHME – ORTOPHOTO 2018



3.1.1 TERËSIA HAPËSINORE: QYTETI LIPJANIT

Shfrytëzimet e lejuara

Shfrytëzimet e tokës në vijim lejohen vetëm në tërësinë hapësinore të qytetit:

Banim, shërbim tregtar, shërbim profesional dhe i informacionit, shërbim i komunitetit, shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ; bujqësi; industri (e rëndë, lëndëve të para dhe prodhimeve të lehta); rrjete të transportit; dhe shërbim publik.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime të lejuara dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzim dytësor konsiderohen shfrytëzimet që shërbejnë vetëm si strukturë mbështetëse për objektet e shfrytëzimit primar të parcelës. Për më shumë këto lloje të shfrytëzimeve do të përcaktohen detalisht në kaptinën e kushteve zhvillimore për çdo zonë në veçanti.

Shfrytëzimet e veçanta

Shfrytëzimet në vijim do të posedojnë rregulla zhvillimore shtesë duke marrë për bazë aktivitetin dhe ndikimet negative në ambientet ku zhvillohen: autolarjet, parkingjet private, kafeteritë, diskotekat, lojërat e fatit, dhe trafostacionet.

Shfrytëzimet e përkohshme

Shfrytëzimet e përkohshme janë të gjitha ato shfrytëzime të cilat ndërtohen me material të lehtë dhe montues (dru, metal, plastikë) dhe shërbejnë për aktivitet të përkohshëm, maksimum dy javë. Shfrytëzimet e përkohshme si në vijim do të lejohen: panairë, koncerte, ekspozita, dhe tregje të lëvizshme.

Shfrytëzimet e ndaluara

Të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në kaptinat e shfrytëzimeve të lartëshënuara ndalohen.

3.1.2 TERËSIA HAPËSINORE: TOKA BUJQËSORE

Shfrytëzime e lejuara

Shfrytëzimet e tokës në vijim lejohen vetëm në tërësinë hapësinore të tokës bujqësore:

Banim; bujqësi; shërbim tregtar; shërbim profesional dhe i informacionit; shërbim i komunitetit; shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ; industri; rrjete të transportit; akuakulturë dhe shërbim publik.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime të lejuara dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzim dytësor konsiderohen objektet përcjellëse që shërbejnë vetëm si strukturë mbështetëse për objektet e shfrytëzimit primar të parcelës.

- Ndërtesat për mbarsjen e kafshëve;
- Ndërtesat përcjellëse për mbarsjen e kafshëve shtëpiake: oborret për bagëti, pistat e betonit për depozitimin e plehut, ndërtesat për ruajtjen e shirës;
- Ndërtesat për ruajtjen e ushqimit për bagëti;
- Ndërtesat për ruajtjen e prodhimeve bujqësore: hambarët, koshat;
- Ndërtesat tjera në ferma: ndërtesat për makina dhe automjete, ndërtesat e tymosjes, tharjes dhe ndërtesat e magazinimit të ushqimit dhe të ngjashme.

Shfrytëzimet e veçanta

Shfrytëzimet në vijim do të posedojnë rregulla zhvillimore shtesë duke marrë për bazë aktivitetin dhe ndikimet negative në ambientet ku zhvillohen: shërbime publike (impianetet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, objektet për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave, depove për mbeturina) instalimi i trafostacioneve dhe shtyllave të telekomunikacionit, minierë dhe gurore; dhe struktura për prodhim të energjisë së ripërtitshme (panele solare).

Shfrytëzimet e përkohshme

Si shfrytëzim i përkohshëm, me kohëzgjatje sezonale, lejohen pikat grumbulluese për prodhimet bujqësore, dhe tregjet e lëvizshme.

Shfrytëzimet e ndaluara

Të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në kaptinat e shfrytëzimeve të lartëshënuara ndalohen.

3.1.3 TERËSIA HAPËSINORE: PYJET

Shfrytëzimet e lejuara

Shfrytëzimet e tokës në vijim lejohen vetëm në tërësinë hapësinore të pyjeve:

Banim; bujqësi; shërbim tregtar; shërbim i informacionit; shërbim i komunitetit; rrjete të transportit; gjueti, shërbim publik; menaxhim i kafshëve shtegtare, dhe akuakulturë.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime të lejuara dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzim dytësor konsiderohen objektet përcjellëse që shërbejnë vetëm si strukturë mbështetëse për objektet e shfrytëzimit primar të parcelës.

- Ndërtesat mbështetëse, të cilat janë në funksion të prodhimit të pyjeve, përfshijnë ndërtesat të cilat janë në funksion të menaxhimit të pyjeve, përmes të cilave sigurohet mirëmbajtja dhe përmirësimi i fondit ekzistues pyjor (përfshirë edukimin, mbrojtjen, rregullimin dhe përdorimin e pyjeve, hapjen dhe mirëmbajtjen e shtigjeve dhe rrugëve pyjore) dhe përmirësimin e gjitha funksioneve tjera të pyllit.

Shfrytëzimet e veçanta

Si shfrytëzim i veçantë, me rregulla shtesë, lejohen minierat dhe guroret.

Shfrytëzimet e përkohshme

Si shfrytëzim i përkohshëm lejohen kampe të stërvitjeve për sport dhe mësim, dhe mbledhje e produkteve natyrore

Shfrytëzimet e ndaluara

Të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në kaptinat e shfrytëzimeve të lartëshënuara ndalohen.

3.1.4 TERËSIA HAPËSINORE: AEROPORTI

Shfrytëzimet e lejuara

- Shfrytëzimet e tokës në vijim lejohen vetëm në tërësinë hapësinore të aeroportit:
- Banim; shërbim tregtar; shërbim profesional financiar dhe i informacionit; shërbim i komunitetit; dhe rrjete të transporti.

Shfrytëzimet dytësore

- Shfrytëzime të lejuara dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzim dytësor konsiderohen objektet dhe strukturat që shërbejnë vetëm si mbështetje për objektet e shfrytëzimit primar të parcelës. Shfrytëzimet dytësore do të përcaktohen më detalisht në kaptinën e kushteve zhvillimore për çdo shfrytëzim brenda tërësisë hapësinore aeroporti.

Shfrytëzimet e veçanta

Shfrytëzimet në vijim do të posedojnë rregulla zhvillimore shtesë duke marrë për bazë aktivitetin dhe ndikimet negative në ambientet ku zhvillohen: shërbime publike (impianetet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, objektet për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave, depove për mbeturina) instalimi i trafostacioneve dhe shtyllave të telekomunikacionit, minierë dhe gurore; dhe struktura për prodhim të energjisë së ripërtrishme (panelet solare).

Shfrytëzimet e përkohshme

Si shfrytëzim i përkohshëm, me kohëzgjatje se zonale, lejohen pikat grumbulluese për prodhimet bujqësore, dhe tregjet e lëvizshme.

Shfrytëzimet e ndaluara

Të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në kaptinat e shfrytëzimeve të lartëshënuara ndalohen.

3.2 QASJA NË PARCELËN KADASTRALE PËR ZHVILLIM

- Zhvillimet/ndërtimet e reja në parcelën kadastrale duhet të dëshmojnë që propozimi për zhvillim/ndërtim nuk e pengon qasjen për parcelat fqinje;
- Parcela kadastrale për zhvillim duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë me së paku në një rrugë publike ose private ose me anë të krijimit të një servituti publik në një parcelë fqinje;
- Qasja adekuate në parcelën kadastrale, për këmbësor apo edhe për mjete motorrike, duhet të sigurohet dhe t'i paraprij çdo ndërtimi;
- Në mungesë të hapësirës për shfrytëzim të qasjes në rrugë publike, atëherë zhvillimet/ndërtimet duhet të dëshmojnë që kanë siguruar zgjidhje alternative të qasjes në parcelë përmes shtegut përbrenda parcelave, me gjerësi minimale 3.5m, varësisht nga përmbajtja e zonës, ashtu që të plotësojë kushtet e përcaktuara nga infrastruktura rrugore. Marrëveshja në mes të pronarëve të parcelave për alokim të shtegut përbrenda parcelave duhet të dorëzohet në organet kompetente si pjesë e dokumentacionit, kërkesës për leje ndërtimore;
- Asnjë ndërtim i ri nuk do të pajiset me leje ndërtimit pa ofruar qasje të mirëfilltë në rrugë publike.

3.3 QASJA NË INFRASTRUKTURËN TEKNIKE

- Komuna obligohet të sigurojë qasjen e parcelave kadastrale për zhvillim në infrastrukture teknike baze (rryma, sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësit) tek të gjitha zonat e alokuara për ndërtim. Infrastruktura baze ofrohet sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinorë;
- Shpërndarja dhe zhvillimi i infrastrukturës baze realizohet në fazë të përcaktuara kohore nga Komuna, dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës;
- Zhvillimet/ndërtimet e reja në parcelën kadastrale për zhvillim duhet të dëshmojnë që propozimi për zhvillim/ndërtim e ka siguruar kyqjen në infrastrukture teknike baze (rryma, sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësit). Më tutje, zhvillimet/ndërtimet e reja në parcelën kadastrale duhet të

dëshmojnë qe propozimi për zhvillim/ndërtim e ka siguruar kyqjen ne rrjet te menaxhimit te mbeturinave;

- Në zonën urbane dhe rurale nuk do të lejohet furnizimi me ujë të pijshëm nga pusët individuale pa testime të certifikuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, si dhe shkarkimi i ujërave të zeza në sistem individual të gropave septike;
- Asnjë ndërtim i ri nuk do të pajiset me leje ndërtimit pa ofruar qasje të mirëfilltë në infrastrukturë teknike.

3.4 RREGULLAT PËR PARKIM DHE SHKARKIM

- Vend-parkimi është hapësirë e projektuar, e shënuar dhe teknikisht e pajisur për të akomoduar dhe lënë një automjet. Vend-parkimet mund të jenë të akomoduar në vend-parkime të rregulluara, në rrugë dhe në garazhe;
- Kuotat minimale të përcaktuara për parkim, garazhim si dhe shkarkim/ngarkim për veturat e personelit, shfrytëzuesve dhe banorëve, duhet të parashihet në kuadër të parcelës kadastrale.

TABELA 3: KUOTAT MINIMALE TE VEND-PARKIMEVE PËR AUTOMJETE²:

Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo më pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, se paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjesë të pa ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për shfrytëzim publik, si dhe VP të definuara me rregullat ligjore për NBB.
	Ndërtesat e banimit të ulët/ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo më pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjesë të pa-ndërtuara, domosdoshmërisht të planifikohet edhe 1 VP/ 1 ndërtesë të banimit të ulët
	Ndërtesat e banimit të ulët-vilat (deri në 4 njësi maksimale)	3 VP/ njësi banimi	-
Hotelaria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve deri në 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve deri në 5*	0.75 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP/ 100 m ²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesa/hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m ²	-
Biznes dhe Publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqe me të vogla se 100m ² , të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative (publike)	2 VP/ 100 m ²	

² Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinorë

Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m ²	-
Kultura dhe Arsimi	Ndërtesat e kopshteve/ çerdheve të fëmijëve	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m ²	Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës
	Ndërtesat e shkollave të mesme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve	1 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqet e komplekseve, nr. I VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta, përkatësisht me plane operative
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat religjioze-xhamitë, kishat, etj.	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat/ sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m ²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP/ 100 m ²	Numri i VP duhet të jetë jo më i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m ²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta

3.5 RREGULLAT PËR ZHVILLIM TË PEIZAZHIT DHE SHIRITAVE TË GJELBËR MBROJTËS

Peizazhi

Larmia peizazhore - territor me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale përfshirë edhe elementet e qytetërimit;³

Peizazhi paraqet pjesë e territorit me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale, përfshirë edhe elementet e qytetërimit;⁴

Në planifikimin e rregullimit të hapësirës si dhe në planifikimin e shfrytëzimit të mirave të natyrës duhet të sigurohet ruajtja e veçorive karakteristike të peizazheve si dhe mirëmbajtja e vlerave biologjike, gjeologjike dhe kulturore të cilat e përcaktojnë rëndësinë dhe përjetimin estetik të tij.

³ Ligji për mbrojtjen e natyrës 03/L-233 (GZRK Nr.85/09.11.2010)

⁴ Ligji për Mbrojtje të Natyrës 03/L-233

Larmia e madhe peizazhore në komunën e Lipjanit është në ndërvare si me ndryshimin e lartësisë mbidetare të territorit të saj e cila shtrihet duke filluar nga 280 m deri në 2400 m mbi nivelin e detit. Në zonat natyrore, rregullimi dhe zhvillimi i peizazheve bazohet në respektimin e karakteristikave specifike peizazhore të komunës ku dallohen dy tërësi karakteristike si:

Rregullimi i larmisë peizazhore në tërësi, duhet të harmonizohet me regjimet, kushtet dhe masat e mbrojtjes të përcaktuara me vendimet përkatëse për vendosjen nën mbrojtje, si dhe me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e natyrës 03/L-233 (GZRK Nr.85/09.11.2010) dhe aktet nënligjore të nxjerrura prej tij. Ligji për mbrojtjen e natyrës vazhdimisht harmonizohet me direktivat relevante për natyrën dhe Acquisin mjedisor e posaçërisht me Direktivën e Vendbanimeve natyrore 92/43 EEC, Direktivën e zogjve të egër 79/409 EEC, Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES).

Kushtet dhe masat për mbrojtjen, rregullimin dhe zhvillimin e peizazheve natyrore duhet të sigurojnë:

- përdorimin racional të burimeve natyrore;
- funksionimin e papenguar të proceseve natyrore;
- mbrojtjen e biodiversitetit dhe llojllojshmërisë;
- revitalizimin dhe rehabilitimin e peizazhit në harmoni me regjimin e mbrojtjes;
- valorizimin dhe prezantimin e vlerave natyrore dhe estetike;
- ndërhyrjen dhe ndikimin minimal të veprimeve në peizazh (gjatë ndërtimit të objekteve të përhershme, infrastrukturës rrugore, instalimeve energjetike etj.);
- shmangien e dëmtimit të përhershëm të sistemeve natyrore dhe shkatërrimin e pjesëve me vlerë të peizazheve gjatë hulumtimit dhe eksploatimit të lëndëve të para, gjermimeve dhe argjinaturave;
- Në rast të dëmtimit të pashmangshëm të natyrës dhe peizazheve të bëhet iniciimi i suksesionit natyror, rinaturalizimi, rregullimi miqësor ndaj natyrës, ripërdorimi ose rekultivimi i tyre.

Në përgjithësi gjatë rregullimit dhe zhvillimit të peizazheve, duhet të ruhen dhe avancohen:

- Struktura dhe pamja karakteristike e peizazheve rurale dhe urbane;
- Tradita e ndërtimit dhe specifikat e strukturës fizike;
- Harmonia (përshtatjen e elementeve natyrore dhe atyre të ndërtuara);
- Identiteti arkitektonik i vendbanimit;
- Hapësirat e hapura publike kualitative;
- Hapësirat e gjelbra dhe elementet natyrore.

Në zonat rurale është e rëndësishme ruajtja e peizazhit bujqësor:

- Për ta ruajtur larminë biologjike dhe peizazhore të tokave të punueshme duhet ruajtur skajet e vlefshme të vendbanimeve të rrezikuara: gardhiqet, trungjet individuale, grupet e trungjeve, moçalet dhe skajet e livadheve;
- Gjatë planifikimit të zgjerimit të tokës bujqësore, duhet që në masë sa më të madhe të ruhen vendbanimet ekzistuese, ose nëse planifikohen të krijohen vendbanime të reja, vendosja dhe madhësia e tyre duhet të bëhet në mënyrën e cila do të sigurojë vlerat më të mëdha të vendbanimeve për larminë biologjike dhe peizazhore.⁵

Në zonën urbane, fokusi duhet të jetë në menaxhimin e zhvillimit dhe interesave konfliktuale që do të rrezikonin kontinuitetin ekzistues të peizazhit, që nënkupton se:

⁵ Ligji për mbrojtjen e natyrës 03/L-233 (GZRK Nr.85/09.11.2010)

- Lidhshmëria ekzistuese e peizazhave duhet të ruhet dhe përmirësohet përmes lidhjes së trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore dhe zonave peri-urbane me ato rurale;
- Duhet të krijohet një sistem i hapësirave të lira të cilat integrojnë funksione të ndryshme publike: brezat e gjelbër mbrojtës, parqet, sipërfaqet për lojë dhe pushim, zonat rekreative, ujë-rrjedhat dhe kolektorët e ujit atmosferik, bujqësinë urbane;
- Peizazhet duhet të ruhen në aspekt të strukturës dhe elementeve karakteristike të cilat varësisht nga përshtatshmëria dhe vendndodhja e tyre shërbejnë për rekreacion aktiv apo pasiv të popullsisë. Sipërfaqet e përshtatshme për këtë qëllim duhet të mbrohen dhe, kur është e nevojshme, të mirëmbahen, rregullohen dhe bëhen të qasshme;
- Duhet të ruhen dhe valorizohen habitatet ekzistuese natyrore si: dru-radhitjet, “gardhet e gjalla”, kopshtet botanike, ujë-rrjedhat, etj., si dhe të gjitha strukturat e vogla që kanë rëndësi ekologjike;
- Në zonat e banimit, të gjitha sipërfaqet e parcelës kadastrale për zhvillim që nuk janë të destinuara për ndërtim të ndërtesave, rrugëve ose shtigjeve të këmbësorëve duhet të peizazhohen me barë, drunj, shkurre ose materiale të tjera bimore dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt;
- Çdo pjesë e një parcele me shfrytëzim të përzier, komercial, industrial, për shërbime publike, që është e dukshme nga një rrugë publike ose vend-parkim publik dhe e cila nuk përdoret për ndërtim, ngarkim dhe shkarkim, parkim, magazinim, rrugë dhe trotuare do të zhvillohet me peizazhe që do të mirëmbahen;
- Peizazhi urban nënkupton kombinimin e vegjetacionit të gjallë (bari, bimët, shkurret ose drunjtë) dhe hapësirave të hapura publike (parqet, shëtitorët, sheshet...) dhe pajisjeve dhe mobilierisë urbane (bankat për ulje, fontanat, ndriçimi publik, panelet për shpallje, kiosqet, elemente të artit publik dhe të ngjashme). Rrugët publike ose hapësirat për ngarkim, parkim ose ruajtje të automjeteve ose materialeve, nuk janë peizazhe;
- Në të gjitha zonat, aty ku ekziston profili i mjaftueshëm i rrugës urbane duhet të formohen dru-radhitjet në të dy anët e rrugës (te rrugët e ngushta vetëm në anën e diellosur të saj). Drunjtë duhet të jenë të llojit të njëjtë dhe të mbillen në distancë uniforme të mbjelljes prej së paku 5 m (në varësi të llojit/madhësisë së drunjve mund të jetë 5-15m). Dru-radhitjet ekzistuese duhet të ruhen duke bërë zëvendësimin e trungjeve të thara ose të moshuara;
- Gjerësia e shiritit të gjelbër për mbjelljen e dru-radhitjeve rekomandohet të jetë ndërmjet 2.5-4.5 m (varësisht nga gjerësia e kursorit të drurit). Largësia e trungjeve nga skajori i rrugës duhet të jetë së paku 1.5 m, ndërsa distanca nga vija rregulluese e ndërtesës së paku 4m;
- Nëse dru-radhitja është pjesë integrale e trotuarit dhe jo pjesë e shiritit të veçantë të gjelbëruar, ajo mund të formohet vetëm në rrugë ku gjerësia e trotuarit është të paktën 2.50 m;
- Largësia e rekomanduar e trungjeve të dru-radhitjeve nga instalimet nëntokësore (kanalizimi, ujësjellësi, linjat telefonike etj.) është 1.5-2m, për përçuesit e ndriçimit publik min 1.0m. Përçuesit kryesor nëntokësor (kabllot primare, tubacionet/kanalet e betonit) duhet të jenë në largësi prej 5.0m;
- Shiritat e gjelbërimit duhet të ngriten 15 cm nga niveli i rrugës / trotuarit dhe kanë një rënie tërthore prej 0,5 - 5%;
- Për të siguruar shikueshmërinë e nevojshme në kryqëzimet e rrugëve, duhet mbjellur vetëm shkurre të cilat nuk janë më të larta se 70-75 cm;
- Gjatë formimit të dru-radhitjeve në vend – parkime publike, duhet të sigurohet mbjellja e një druri për 2 vend-parkime kur ato janë të vendosura në pozitë tërthore, ndërsa te parkimi gjatësor, për çdo vend-parkim nga një dru;
- Peizazhet do të mirëmbahen rregullisht për të minimizuar dëmtimin e pronës dhe rrezikimin e sigurisë publike. Veprimet e lejuara te dru-radhitjet ekzistuese përfshijnë: largimin degëve të thara dhe jo të shëndosha, heqjen e degëve të varura të ulëta dhe atyre që pengojnë ndriçimin në rrugë dhe distancat e nevojshme për shikueshmëri të papenguar. Duhet të sigurohet ujitja e rregullt (sipas nevojës të bëhet vendosja e instalimeve nëntokësore të ujitjes);
- Peizazhet e dëmtuara duhet të zëvendësohen nga pronarët aktual të pronave në afat sa më të shkurtër, varësisht nga sezoni i rritjes, brenda një maksimumi prej 150 ditësh;


- Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP) paraqet raportin mes sipërfaqes gjelbëruese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim, shumëzuar me 100. Çdo zhvillim/ndërtim i ri duhet të siguroj ne minimum 10% hapësirë gjelbëruese, nga hapësira e përgjithshme e parcelës kadastrale. Kërkesat për SGJP mund të akomodohen ne tokë, por edhe mund të shtrihet edhe në mënyrë vertikale (maksimum 30% te kërkesës për gjelbërim), gjithmonë te lokalizuara përbrenda parcelës kadastrale. Kështu, kopshtet dhe hapësirat mbi kulm (duke përfshirë kulmet mbi strukturat e parkimit) si dhe strukturat vertikale te ndërtuara mund të përdoren për të përmbushur kërkesat për sipërfaqe të gjelbërta;
- Për çdo 5 vend-parkime te krijuara, duhet te mbillet 1 dru gjetherënës. Drunjët duhet te mbillen ne brendi te parcelës kadastrale. Gjelbërimi i rregulluar duhet të mbrohet me anësore, ose pajisje të tjera për mbrojtje nga dëmtimi;
- Kufizohet pllakosja e parqeve publike ne maksimum 10% te hapësirës së përgjithshme të tyre;
- Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve përgjatë sistemit lokal të infrastrukturës rrugore duhet t'i përmbahet karakteristikave si më poshtë:
 - ≥ 10 m për rrjetin primar
 - ≥ 8 m për rrjeti sekondar
 - ≥ 3 m për brez te gjelbër përgjatë shtigjeve
 - ≥ 2.5 - 4.5m, për brez te gjelbër përgjatë vend-parkimeve.

3.6 KËRKESAT DHE DIZAJNI I NDRIÇIMIT NATYROR DHE ARTIFICIAL

Ndricimi natyror

- Zhvillimet/ndërtimet e reja si dhe rindërtimet duhet të shfrytëzojnë ajrosjen natyrale, si dhe ndriçimin natyror - si burim dominues i ndriçimit;
- Ndriçimi natyror për dritaret ekzistuese paraqet rregullin e rrafshit imagjinar 45 shkallë për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të strukturave ekzistuese. Rregulli 45 shkallë kontrollon hijezimin të strukturave dhe pronave fqinje dhe përdoret kryesisht në zonat me densitet të mesëm dhe të lartë të zhvillimit, ose ndërmjet dy zonave me densitet të ndryshëm të zhvillimit. Rregulli kontrollon që asnjë pjesë e vëllimit të zhvillimit të ri të mos e kalojë vijën e tërhequr në këndin prej 45 shkallë nga qendra e dritares më të afërt të një dhome të banueshme të katit përdhese të ndërtesës fqinje, siç ilustrohet më poshtë:

ILUSTRIMI 8: RREGULLI I RRAFSHIT 45 SHKALLË NE MES TE 2 PARCELAVE FQINJE



- Rregulli siguron që asnjë pjesë e vëllimit të zhvillimit të ri të mos e kalojë vijën e tërhequr në këndin prej 45 shkallë nga një lartësi të caktuar. Në këtë mënyrë, distanca ndërmjet ndërtesave varet nga lartësia e ndërtesës përballë dhe pjerrtësisë së terrenit. Kjo lartësi mund të përcaktohet si vlerë numerike plus ose minus dhe varet sipas pjerrtësisë së terrenit. Ky rregull mund të përdoret ndërmjet dy zhvillimeve fqinje ose që përballen në terren të pjerrët;

- Strukturat e renditura më poshtë mund të ndërhyjnë përmes rrafshit 45 shkallë të ndriçimit natyror:
 - Oshaqet, boshtet e ventilimit, boshtet e ashensorëve, boshtet e shkallëve, dhe rezervuarët e ujit në çati me kusht që dimensionin maksimal nuk tejkalon 1m², dhe me kusht që distanca minimale ndërmjet secilës prej këtyre strukturave është 20m, dhe me kusht që këto struktura nuk tejkalojnë muret e jashtme të ndërtesës ku janë vendosur
 - Kulmet e pjerrëta kur prekin rrafshin e tërhequr jo më poshtë se në gjysmë ndërmjet strehëve dhe vijës kurrizOore të kulmit, atëherë pjesët e larta të kulmeve të tilla të ndërhyjnë në rrafshin e tërhequr.

ILUSTRIMI 9: RREGULLI I RRAFSHIT 45 SHKALLË NË MES DY NDËRTIMEVE PËRBALLË NJËRA TJETRËS



Ndriçimi artificial

- Ndriçimi i hapësirave publike (rrugë, shtigje, rrugëkalime, parqe, parkingje, etj.) është i një rëndësie të veçantë për sigurinë e hapësirës publike. Përdorimi i duhur i ndriçimit në një hapësirë publike duhet të siguron:
 - përmirësimin lexueshmërinë e vendeve kyçe, shenjave dhe reperëve, komunikimeve dhe hapësirave për aktivitete të ndryshme në hapësirën publike;
 - lëvizje më të sigurt të këmbësorëve dhe automjeteve, përmirësimin e sigurisë dhe zvogëlimin e situatave të mundshme që mund të rrezikojnë përdoruesit ose pronën në zonë;
 - rigjallërim të hapësirave publike më pak të përdorura dhe inkurajon përdorimin e hapësirës publike gjatë natës.
- Përzgjedhja e llojit dhe intensitetit të ndriçimit duhet të përshtatet me karakterin e mjedisit lokal. Efektet e dëmshme të shpërndarjes së tepërt dritës dhe "ndotjes nga ndriçimi" në eko-sistemet ekzistuese në rastin e zonave të gjelbëra dhe parqeve, banorët ose shoferët duhet zvogëluar në minimum.
- Shtyllat e ndriçimit duhet të vendosen brenda korridoreve të rrugës në atë mënyrë që të sigurojnë ndriçim të plotë të të gjitha zonave të trafikut në të gjitha kushtet e motit. Distanca minimale e shtyllave nga cepi i skajshëm i profilit tërthor të rrugës është 0.50m.
- Furnizimi i shtyllave me energji bëhet nga kabllo të nëntokësore të tensionit të ulët dhe rekomandohet që menaxhimi i ndriçimit të planifikohet në mënyrë qendrore, me sistem automatik të fikjes/ndezjes së çdo të dytit ndriçues dhe mundësinë e zvogëlimit të intensitetit të ndriçimit me 50% në periudha të caktuara gjatë natës (ndërmjet 01 - 04 h).
- Rekomandohet përdorimi i burimeve të dritës LED pasi ato kanë një rezistencë të lartë ndaj dridhjeve, goditjeve mekanike dhe lagështisë, si dhe jetë më të gjatë në raport me burimet klasike të dritës.

3.7 KËRKESAT PËR ZVOGËLIMIN E ZHURMËS

- Zhvillimet /ndërtimet e reja, si dhe të gjitha aktivitetet në komune (kryerja e punimeve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera) duhet të operojnë në mënyrë që të mos prodhojnë zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara të përcaktuara më poshtë:

TABELA 4: NIVELI MAKSIMAL I ZHURMËS I LEJUAR (NË DB(A))

Shfrytëzimi i hapësirës	Dita: 06:00-20:00	Nata: 22:00-06:00
Zone banimi	59db	49db
Zonat komerciale	59db	49db
Zonat industriale	69db	59db

- Zonat tjera te komunës duhet te ndjekin udhëzimet për zhurmë nga UA 08/2009 mbi vlerat e lejuara te emisioneve te zhurmës nga burimet përkatëse; si dhe ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

3.8 KËRKESAT PËR FORMËSIMIN ARKITEKTONIK

Kërkesat për formësimin arkitektonik do të zbatohen për zhvillimet e shfrytëzimeve, banimeve të përhershëm, ndërtimeve me shumë njësi dhe me shfrytëzim të përzier. Ato zbatohen për ndërtimet e reja, duke përfshirë shtesat në ndërtimet ekzistuese, si dhe për riparimin ose rehabilitimin thelbësor të fasadës së jashtme të një ndërtese ekzistuese;

- Objektet e planifikuara përveç që së bashku duhet të paraqesin kompozicion arkitektonik, duhet që edhe si të veçanta, me volumin e tyre, proporcionet dhe destinimin të paraqiten si tërësi arkitektonike;
- Fasadat e ndërtesave përgjatë rrugëve publike, nuk duhet të përmbajnë sipërfaqe të mureve pa hapje primare, që tejkalojnë 10 metra gjatësi. Fasadat e ndërtesave që janë prej 40 metrave ose më shumë gjatësi, do të përfshijnë një model arkitektonik të përsëritur me dy ose më shumë elemente të mëposhtme: ndryshim i ngjyrës, i strukturës, i materialit ose ndryshimi, zbulimi, ndërprerja, ose mënjanimi i shtyllave;
- Të gjitha pajisjet mekanike, të montuara në çati ose tokë, duhet të largohen nga pamja, deri në masë të mundshme praktike. Matësit dhe pajisjet tjera të shërbimeve publike dhe pajisjet duhet të vendosen në vende që nuk janë të dukshme nga rruga publike;
- Ndalohet përdorimi i materialeve te fasadës dhe kulmit që prodhojnë shkëlqim verbues, me përjashtim të paneleve diellore ose çative të bardha, që synojnë të rrezatojnë energji diellore të absorbuar ose të pa-pasqyruar dhe të zvogëlojnë akumulimin e nxehtësisë në ndërtesë.
- Çdo ndërtim i ri duhet të përshtatet me stilin dominues të zonës (rrugës, sheshit, bllokut, lagjes, etj.). Gjatë mbindërtimit ose adaptimit të ndërtesave ekzistuese, kërkohet që të gjitha pjesët dhe elementet e reja të bëhen në stilin arkitektonik të ndërtesës ekzistuese (format, materialet, ngjyrat); Ndërtesat në varg dhe ato dyshe duhet të jenë të harmonizuara në aspekt të formësimit arkitektonik;
- Formësimi i ndërtesës duhet të shfaqë përdorim të qëndrueshëm të ngjyrave, materialeve dhe detajeve në tërë fasadën e ndërtesës; ndërtesat dytësore duhet të jenë konsistente me formësimin arkitektonik të jashtëm të atyre primare;
- Fasadat e ndërtesave përgjatë rrugëve publike, nuk duhet të përmbajnë sipërfaqe të mureve pa hapje primare, që tejkalojnë 10 m gjatësi. Fasadat e ndërtesave që janë prej 40m ose më shumë gjatësi, do të përfshijnë një model arkitektonik të përsëritur me dy ose më shumë elemente të mëposhtme, si ndryshimi i ngjyrës, strukturës, materialit ose ndryshimi, zbulimi, ndërprerja ose mënjanimi i shtyllave;
- Gjatë përmirësimit dhe rekonstruimit të ndërtesave, vëllimi i tyre në raport me ndërtesat ekzistuese fqinje, këmbësorët ose me ndërtesat e tjera ekzistuese do të ruhet ose përmirësohet. Zgjidhja burimore e fasadave në aspektin arkitektonik dhe ngjyrave të përdorura duhet të ruhet,

duke shmangur vendosjen e ngjyrave dhe elementeve dekoruese të cilat nuk kanë ekzistuar në fasadën origjinale;


- Veshja e fasadave duhet të bëhet me materiale kualitative, të qëndrueshme dhe që mirëmbahen lehtë;
- Përzgjedhja e ngjyrave për fasadat e ndërtesave ka një ndikim të rëndësishëm estetik dhe vizual në pronat fqinje prandaj ngjyrat duhet të zgjidhen në harmoni të përgjithshme me ato të ndërtesave ekzistuese të lagjes. Preferohen ngjyrat natyrore ose nuancat e dheut, në tone të buta, neutrale me reflektim të ulët. Nuk lejohen ngjyrat neon, fluorescente, reflektuese apo ngjyrat e forta;
- Materiali për mbulimin e kulmit duhet të jetë në përputhje me stilin arkitektonik të ndërtesës dhe ndërtesat përreth dhe i përshtatshëm për kushtet lokale të mjedisit. Përdorimi i materialeve që shkaktojnë shkëlqim verbues janë të ndaluara, me përjashtim të paneleve solare të cilat kanë për qëllim emetimin e energjisë diellore të absorbuar ose të pa-reflektuar duke zvogëluar akumulimin e nxehtësisë në ndërtesë;
- Të gjitha pajisjet mekanike, të montuara në kulm ose tokë, aq sa është e mundur, duhet të jenë sa më pak të dukshme. Matësit dhe pajisjet tjera të shërbimeve publike, pajisjet e ngrohjes, ajrit të kondicionuar dhe ventilimit duhet të vendosen në atë mënyrë që të mos e prishin pamjen estetike të fasadave ose në vende që nuk janë të dukshme nga rruga publike;
- Për objektet që mund të ndërtohen në zonat natyrore të mbrojtura (monumentet e natyrës) aplikohen rregulla të veçanta në përputhje me ligjet respektive, planet hapësinore dhe planet e menaxhimit për këto zona;
- Për objektet që mund të ndërtohen në zonat me interes të veçantë dhe ato të sigurisë shtetërore e civile aplikohen rregulla të veçanta në përputhje me ligjet respektive dhe planet hapësinore përkatëse.

4 LISTA E ZONAVE

Duke u bazuar në hartën e shfrytëzimit të tokës së PZHK-së, në analizën e gjendjes ekzistuese në terren, dhe kërkesave dhe nevojave të qytetarëve më poshtë janë renditur zonat bazë dhe zonat mbishtresore për shfrytëzim të tokës në gjithë territorin e komunës së Lipjanit, përveç qytetit të Lipjanit ku jepet lista specifike e zonave dhe nënzonave.


Qyteti i Lipjanit ndahet në 9 zona urbane (1 Zonë urbane qendrore “Z1”, si dhe 8 Zona urbane “Z2”, “Z3”, “Z4”, “Z5”, “Z6”, “Z7”, “Z8” & “Z9”). Zonimi sipas dendësisë është përcaktuar si më poshtë.

TABELA 5: LISTA E ZONAVE DHE NENZONAVE NË GJITHË TERRITORIN E KOMUNËS

ZONAT	NENZONAT	KODI	NGJYRA
ZONË BANIMI	Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët	ZB-R2	
	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	ZB-R1	
	Sipërfaqe suburbane	ZB-U3	
	Sipërfaqe urbane e përgjithshme	ZB-U2	
	Sipërfaqe urbane qendrore	ZB-U1	
ZONË INDUSTRIALE	/	ZI	
ZONË KOMERCIALE	/	ZK	
ZONË BUJQËSORE	/	ZBJ	
ZONË PYJORE	/	ZP	
ZONË TURISTIKE	/	ZT	
ZONË MINIERË SIPËRFAQËSORE	/	ZMS	
SIPËRFAQE UJORE	/	SU	

4.1 ZONAT MBISHTRESORE


TABELA 6: LISTA E ZONAVE MBISHTRESORE

Zonat	KODI	NGJYRA
ZONË E MBROJTUR E AEROPORTIT	ZMA	
ZONË MBISHTRESORE: ZONË E INTERESIT TË VEÇANTË	ZMIV	
ZONË MBISHTRESORE SEIZMIKE	ZMS	
ZONË MBISHTRESORE E NDIKUAR NGA VËRSHIMET	ZnV	
ZONË MBISHTRESORE ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)	ZMNL	
ZONË MBISHTRESORE E MBROJTUR - TRASHËGIMI KULTURORE	ZMTK	
ZONË MBISHTRESORE E MBROJTUR - TRASHËGIMISË NATYRORE	ZMTN	

5 ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KUSHTET ZHVILLIMORE TË TYRE

Kaptina në vijim përmban shfrytëzimet e tokës dhe kushtet zhvillimore për çdo zonë. Shfrytëzimet e tokës për çdo zonë caktojnë shfrytëzimet e lejuara, dytësore, veçanta, dhe të ndaluara. Shfrytëzimet e veçanta i nënshtrohen kushteve zhvillimore shtesë, përveç atyre të aplikueshme për çdo zonë. Kushtet zhvillimore shtesë për shfrytëzimet e veçanta hartohen veçanërisht nga drejtoria për planifikim/urbanizëm në raste të aplikimit.

HARTA 4: SHFRYTËZIMI TOKËS



5.1 ZONA E BANIMIT



5.1.1 NUMRI DHE PARASHIKIMI I RITJES SË BANORËVE NË 8 VITET E ARDHSHE (PZHK – ASK)

Sipas PZHK-së dhe regjistrimit të popullsisë nga ASK, komuna e Lipjanit në vitin 2011 ka shënuar 57,605 banorë. Në vitin 2019, sipas vlerësimit të rritjes së banorëve nga ASK-së, komuna e Lipjanit shënon 58,247 banorë. Rritja e numrit të banorëve vlerësohet si trend i rritjes me 0.93% për cdo vit.

Sipas trendit të rritjes të përcaktuar nga vlerësimi i ASK (0.93% në vit), komuna e Lipjanit në vitin 2021 vlerësohet të ketë 59,350 banorë. Bazuar në trendin e përvetësuar të rritjes së popullsisë, numri i banorëve në vitin 2029 parashikohet të jetë 63,779 banorë. Zona urbane parashikohet të ketë 7,630 banorë, dhe zona rurale 56,149 banorë.

Numri i parashikuar i banorëve në vitin 2029		
Zona urbane	7,630	12%
Zona rurale	56,149	88%
Komuna	63,779	100%

HARTA 5: ZONAT E BANIMIT



5.1.2 [ZB-R2] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE RURALE ME INTEZITET TE ULËT

Nënzona është planifikuar për banim rural me intensitet të ulët **5-10 banorë/hektarë**. Nënzona ofron hapësirë për zhvillim për shtëpi të veçanta, dyshe, dhe në varg; dhe shfrytëzime tjera të përshtatshme për këtë hapësirë.

Në këtë nënzona bëjnë pjesë 55 vendbanime: Akllap, Babush i Muhaxherve, Baicë, Banullë, Breg i Zi, Brus, Bujan, Bukovicë, Divlakë, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gadime e Ulët, Gllanicë, Gllavicë, Glllogoc, Grackë e Vjetër, Grackë e Vogël, Gumnasellë, Hallaç i Madh, Hallaç i Vogël, Hanroc, Kleqkë, Kojskë, Konjuh, Kraishtë, Krojmir, Leletiq, Lipovicë, Llugagji, Llugë, Marec, Medvec, Mirenë, Okosnicë, Plitkoviq, Poturoc, Qellapek, Qylagë, Resinoc, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Rubofc, Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Smallushë, Shisharkë, Teqe, Tërbufc, Topliqan, Torinë, Varigoc, Vërshec, Vogaçicë, Vrellë, Vrellë e Goleshit, dhe Zllokuqan.

Bazuar në trendin e përvetsuar të rritjes së popullsisë, kjo nënzona e banimit në vitin 2021 shënon 39,100 banorë. Në 8 vitet e ardhshme, 2021 – 2029, nënzona do të shënoj rritje për 2,927 banorë, apo 7.5%. Bazuar në trendin e rritjes së popullsisë dhe dendësisë së banimit, janë planifikuar 27 hektarë tokë për të akomoduar zhvillimin për banim të përherëshëm në 8 vitet e ardhshme (shih shtojcën 3 dhe 4).

Sipërfaqja e planifikuar për banim, dendësia e banimit, dhe numri i banorëve që mund të akomodojnë të gjitha vendbanimet në 8 vitet e ardhshme në nënzona janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nënzona e banimit	Sipërfaqja e përgjithshme për zhvillim (PZHK)	Sipërfaqja e shfrytëzuar për zhvillim (ndërtim aktual)	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)	Numri i banorëve në 8 vitet e ardhshme	Sipërfaqja e nevojshme për banim të përherëshëm 8 vitet e ardhshme	Dendësia e banimit	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)
Sipërfaqe rurale me intenzitet të ulët	2,234 ha	1,433 ha	801 ha	2,927 banorë	27 ha	5 - 10 banorë / hektarë	774 ha

PZHK në fuqi ka planifikuar sipërfaqe shumë më të madhe të tokës për akomodim të zhvillimit të ardhshëm në krahasim me kërkesat për zhvillim. Në këtë kontekst komuna duhet të kontrolloj zhvillimin në faza, duke lejuar sasi të caktuar të tokës për zhvillim bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për zhvillim.

Vendbanimet e nënzona janë të kategorizuara sipas U.A. MMPH-NR. 08/2017, si në vijim:

	Vendbanimi	Parashikimi i numri të banorëve 2029	Kategorizimi sipas madhësisë		Vendbanimi	Parashikimi i numri të banorëve 2029	Kategorizimi sipas madhësisë
1	Lipovicë	0	/	28	Rufc i Ri	561	mesëm rural
2	Shisharkë	0	/	29	Mirenë	575	mesëm rural
3	Vogaçicë	0	/	30	Ribar i Vogël	600	mesëm rural
4	Okosnicë	2	/	31	Torinë	651	mesëm rural
5	Bukovicë	13	shumë i vogël rural	32	Konjuh	695	mesëm rural

6	Tërbufc	33	shumë i vogël rural	33	Bujan	706	mesëm rural
7	Hanroc	56	shumë i vogël rural	34	Hallaç i Vogël	735	mesëm rural
8	Plitkoviç	62	shumë i vogël rural	35	Akllap	774	mesëm rural
9	Divlakë	75	shumë i vogël rural	36	Resinoc	778	mesëm rural
10	Gllanicë	92	shumë i vogël rural	37	Poturoc	797	mesëm rural
11	Vrellë	174	shumë i vogël rural	38	Rubofc	800	mesëm rural
12	Teqe	220	i vogël rural	39	Vërshec	992	mesëm rural
13	Dobrajë e Vogël	238	i vogël rural	40	Qylagë	1060	mesëm I madh rural
14	Kleqkë	252	i vogël rural	41	Rufc i Vjetër	1133	mesëm I madh rural
15	Gllavicë	275	i vogël rural	42	Baicë	1155	mesëm I madh rural
16	Varigoc	279	i vogël rural	43	Llugagji	1281	i mesëm I madh rural
17	Zllokuqan	299	i vogël rural	44	Medvec	1304	i mesëm I madh rural
18	Marec	300	I vogël rural	45	Babush i Muhaxherve	1335	i mesëm I madh rural
19	Qellapek	317	i vogël rural	46	Gumnasellë	1355	i mesëm I madh rural
20	Llugë	362	i vogël rural	47	Smallushë	1413	i mesëm I madh rural
21	Brus	363	i vogël rural	48	Kraishtë	1522	i mesëm I madh rural
22	Vrellë e Goleshit	372	i vogël rural	49	Glllogoc	1594	i mesëm I madh rural
23	Leletiq	388	i vogël rural	50	Krojmir	1736	i mesëm I madh rural
24	Kojskë	404	i vogël rural	51	Banullë	1876	i mesëm I madh rural
25	Breg i Zi	446	i vogël rural	52	Topliqan	2068	i mesëm I madh rural
26	Grackë e Vogël	451	i vogël rural	53	Ribar i Madh	2436	i mesëm I madh rural
27	Hallaç i Madh	463	i vogël rural	54	Dobrajë e Madhe	2462	i mesëm I madh rural
				55	Gadime e Ulët	3695	Vendbanim rural I madh

5.1.2.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Nënzona përmbanë ndërtesa të banimit me një njësi, banim i përhershëm: shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte, shtëpi dyshe, dhe shtëpi në varg. Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet edhe me shfrytëzim për prodhim bujqësor për konsum vetjak (stallë e vogël kafshësh), dhe me shërbim tregtar (bujtina, restorant/kafeteri). Banimi i përhershëm mund të kombinohet me shërbim tregtar vetëm për ato parcela që kanë qasje direkte si në rrugët në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1;
- Shërbim tregtar: shitore me pakicë, dhe shërbim i akomodimit të ushqimit (bujtina, restorant/kafeteri).

- Shërbim i akomodimit të ushqimit, konkretisht bujtina dhe vila banimi do të lejohen vetëm në vendbanimet: në Brusë, Akllap, Hanrofc, Shisharë, Plitkoviç, Ribarë i Madhë, Kraishtë, Vërshevc, Krojmirë, dhe Kleçkë.

Këto lloje të shfrytëzimit (përvec bujtinave) lejohen të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:

- Rrugë nacionale, dhe rajonale;
- Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1;
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare. Këto lloje të shfrytëzimit lejohen të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1
- Infrastrukturë bujqësore për konsum vetanak: ferma të vogla.
- Shërbim i komunitetit: shërbim fetar.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe shtalla.

Të gjitha shfrytëzimet dytësore se bashku me shfrytëzimet e lejuara për parcelë nuk do të kalojnë përqindjen maksimale të Indeksit të Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) të lejuar në kushtet zhvillimore.

Shfrytëzime të ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, veçanta, dhe dytësore.

5.1.2.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Banim i përherëshëm		Infrastrukturë bujqësore: ferma	Shërbim tregtar: shitore me pakicë, restaurant/kafeteri	Shërbim tregtar: bujtina	Shërbim profesional
Madhësia e parcelës	Shtëpi të vecanta	Min 400m ²	Min 200m ² Max 1,000 m ²	Min 200m ² Max 400m ²	Min 500m ² Max 1000m ²	Min 200m ² Max 400m ²
		Max 600m ²				
	Shtëpi dyshe	Min 400m ²				
		Max 700m ²				
Balli i parcelës ¹	Shtëpi në varg	Min 200m ²	Min 12m'	Min 10m'	Min 18m'	Min 10m'
		Max 300m ²				
	Shtëpi të vecanta	Min 16m'				
		Min 20m'				
	Shtëpi në varg	Min 8m'				

Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.3 Vlera max 0.5	Vlera bazë 0.3 Vlera max 0.50	Vlera bazë 0.3 Vlera max 0.50	Vlera bazë 0.3 Vlera max 0.50	Vlera bazë 0.3 Vlera max 0.50
Etazhiteti	Max P +1 (max 7.5 m’)	Max P+2 (max 11.0 m’)	Max P + 2 (max 11.0 m’)	Max P + 2 (max 11.0 m’)	Max P+2 (max 11.0 m’)
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Vlera bazë 10% Vlera max 40%	Vlera bazë 10% Vlera max 40%	Vlera bazë 10% Vlera max 40%	Vlera bazë 10% Vlera ax 40%	Vlera bazë 10% Vlera ax 40%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min 40%	Min 40%	Min 40%	Min 40%	Min 40%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Max 35%	0%	0%	Max 35 %	0%
Rrjetet e vijave					
Vija Ndërtimore (VN)	Min 7m	-	Min 5m	Min 5m	Min 5m
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNT)	Min 7m	-	-	Min 5m	-
Vija rregulluese (VRr)	Duhet të përputhet me profilin e rrugës së planifikuar të nënzonës së banimit. Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale të rrugës.				
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.50H (zonë e pandërtuar) Min 0.25H (zonë e ndërtuar)	-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.25H (zonë e pandërtuar) Min 0.10H (zonë e ndërtuar)	-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët fqinjë arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri				
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m ² , gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m’, p.sh:					
• Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 400m ² – 500m ² = 16.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë);					
• Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 501m ² – 600m ² = 18.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës).					
Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë nënzonë.					

5.1.3 [ZB-R1] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE RURALE ME INTENZITET TË LARTË

Nënzona është planifikuar për banim rural me intensitet të lartë **25-50 banorë/hektarë**. Nënzona ofron hapësirë për zhvillim për shtëpi të veçanta, dyshe, dhe në varg; dhe shfrytëzime tjera plotësuese në pajtueshmëri me intensitet të zhvillimit. Në këtë nënzona lejohet që banimit të kombinohet edhe me shfrytëzim për prodhim bujqësor për konsum vetanak (kopshte dhe stallë të vogël kafshësh), dhe me funksione të turizmit rural.

Sipas PZHK, nënzona e banimit rural me intensitet të lartë përfshinë **5 qendra të rendit të ulët**: Janjevë, Sillovi, Shalë, Gadime dhe Magure.

Bazuar në trendin e përvetsuar të rritjes së popullsisë (ASK vlerësimi 2019 – 0.9% rritje), kjo nënzona e banimit në vitin 2021 shënon 12,766 banorë. Në 8 vitet e ardhshme, 2021 – 2029, nënzona do të shënoj rritje për 956 banorë, apo 7.5%. Bazuar në trendin e rritjes së popullsisë dhe dendësisë së banimit, janë planifikuar 10 hektarë tokë për të akomoduar zhvillimin për banim të përherëshëm në 8 vitet e ardhshme (shih shtojcën 5 dhe 6).

Sipërfaqja e planifikuar për banim, dendësia e banimit, dhe numri i banorëve që mund të akomodojnë të gjitha vendbanimet në 8 vitet e ardhshme në nënzonë janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nënzona e banimit	Sipërfaqja e përgjithshme për zhvillim (PZHK)	Sipërfaqja e shfrytëzuar për zhvillim (ndërtim aktual)	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)	Numri i banorëve në 8 vitet e ardhshme	Sipërfaqja e nevojshme për banim të përherëshëm 8 vitet e ardhshme	Dendësia e banimit	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)
Sipërfaqe rurale me intenzitet të lartë	703 ha	366 ha	337 ha	956 banorë	10 ha	25 - 50 banorë / hektarë	327 ha

PZHK në fuqi ka planifikuar sipërfaqe shumë më të madhe të tokës për akomodim të zhvillimit të ardhshëm në krahasim me kërkesat për zhvillim. Në këtë kontekst komuna duhet të kontrolloj zhvillimin në faza, duke lejuar sasi të caktuara të tokës për zhvillim bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për zhvillim.

Vendbanimet e nënzonës janë të kategorizuara sipas U.A. MMPH-NR. 08/2017, si në vijim:

	Vendbanimi	Parashikimi i numrit të banorëve 2029	Kategorizimi sipas madhësisë
1	Silovi	3'795	Vendbanim rural i madh
2	Gadime e Epërme	2'924	Vendbanim rural i madh
3	Shalë	2'787	Vendbanim rural i madh
4	Janjevë	2'366	Vendbanim i mesëm i madh rural
5	Magurë	1'849	Vendbanim i mesëm i madh rural

5.1.3.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Nënzona përmbanë ndërtesa të banimit me një njësi, banim i përherëshëm: shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte, shtëpi dyshe, dhe shtëpi në varg. Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet, me shfrytëzim për prodhim bujqësor për konsum vetjak (stallë e vogël kafshësh), me shërbim tregtar në përdhese, apo/dhe bujtina. Banimi i përherëshëm mund të kombinohet me shërbim tregtar dhe/apo bujtina vetëm për ato parcela që kanë qasje direkte si në rrugët në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1;
- Banim i përherëshëm: ndërtesa më shumë njësi do të lejohen vetëm në Magurë.
- Shërbim tregtar: shitore me pakicë, dhe shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant/kafeteri) dhe bujtina

- Shitoret me pakicë dhe shërbim i akomodimit të ushqimit, konkretisht restorant/kafeteri, do të lejohen në të gjitha qendrat e rendit të ulët. Këto lloje të shfrytëzimit lejohen të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1;
- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit, konkretisht bujtina do të lejohen vetëm në Gadime dhe Janjevë.
- Infrastrukturë bujqësore për konsum vetanak dhe komercial.
- Shërbim i komunitetit: shërbim fetar.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe shtalla.

Të gjitha shfrytëzimet dytësore se bashku me shfrytëzimet e lejuara për parcelë nuk do të kalojnë përqindjen maksimale të Indeksit të Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) të lejuar në kushtet zhvillimore.

Shfrytëzimet e veçanta

- Shërbim tregtar: kafeteri, hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; automekanik; autolarje; parkingje private; saldues (farkëtar); dhe pompë të karburanteve (Shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta). Këto lloje të shfrytëzimit lejohen të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë në vendbanime rurale: kategoria 1

Shfrytëzime të ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, veçanta, dhe dytësore.

5.1.3.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Banim i përherëshëm		Infrastrukturë bujqësore: ferma	Shërbim tregtar: shitore me pakicë, restaurant/kafeteri	Shërbim profesional	Shërbim tregtar: Bujtina
Madhësia e parcelës	Shtëpi të vecanta	Min 400m ²	Min 200m ² Max 1,000 m ²	Min 200m ² Max 500m ²	Min 200m ² Max 400m ²	Min 500m ² Max 1000m ²
		Max 500m ²				
	Shtëpi dyshe	Min 400m ²				
		Max 600m ²				
	Shtëpi në varg	Min 200m ²				
		Max 250m ²				
Balli i parcelës ¹	Shtëpi të vecanta	Min 16m’	Min 12m’	Min 10m’	Min 10m’	Min 18m’
	Shtëpi dyshe	Min 20m’				
	Shtëpi në varg	Min 8m’				
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.1 Vlera max 0.25		Vlera bazë 0.1 Vlera max 0.25	Vlera bazë 0.1 Vlera max 0.25	Vlera bazë 0.1 Vlera max 0.25	Vlera bazë 0.1 Vlera max 0.25
Etazhiteti	Max B+P+2 (max 11.0 m’)		Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Vlera bazë 10% Vlera max 50%		Vlera bazë 10% Vlera max 50%	Vlera bazë 10% Vlera max 50%	Vlera bazë 10% Vlera max 50%	Vlera bazë 10% Vlera max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min 40%		Min 40%	Min 40%	Min 40%	Min 40%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Max 35%		0%	0%	0%	Max 35%
Rrjetet e vijave						
Vija Ndërtimore (VN)	Min 7m		-	Min 5m	Min 5m	Min 5m
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt)	Min 7m		-	-	-	
Vija rregulluese (VRr)	Duhet të përputhet me profilin e rrugës së planifikuar të nënzonës së banimit. Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale të rrugës.					
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.50H (zonë e pandërtuar) Min 0.25H (zonë e ndërtuar)		-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.50H (zonë e pandërtuar) Min 0.25H (zonë e ndërtuar)
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.25H (zonë e pandërtuar) Min 0.10H (zonë e ndërtuar)		-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H (zonë e pandërtuar) Min 0.10H (zonë e ndërtuar)
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët fqinjë arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri					
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m ² , gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m’, p.sh:						
• Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 400m ² – 500m ² = 16.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë);						
• Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 501m ² – 600m ² = 18.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës).						

5.1.4 [ZB-U3] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE SUB-URBANE

Nënzona gjendet në zonën urbane, qytet. Nënzona është planifikuar për banim, si sipërfaqe suburbane me dendeësi **30 -105 banorë/hektarë**. Nënzona ofron hapësirë për zhvillim për shtëpi të veçanta, dyshe, dhe në varg; dhe shfrytëzime tjera të përshtatshme për këtë hapësirë, dhe shfrytëzime tjera plotësuese në pajtueshmëri me intenzitet të zhvillimit.

Në këtë nënzona bëjnë pjesë zonat e banimit si në vijim: ZB7

Bazuar në trendin e përvetsuar të rritjes së popullsisë (ASK vlerësimi 2019 – 0.9% rritje), kjo nënzona e banimit në vitin 2021 shënon 3,450 banorë. Në 8 vitet e ardhshme, 2021 – 2029, nënzona do të shënoj rritje për 256 banorë, apo 7.5%. Bazuar në trendin e rritjes së popullsisë dhe dendësisë së banimit, janë planifikuar 2.3 hektarë tokë për të akomoduar zhvillimin për banim të përherëshëm në 8 vitet e ardhshme (shih shtojcën 7 dhe 8).

Sipërfaqja e planifikuar për banim, dendësia e banimit, dhe numri i banorëve që mund të akomodojnë të gjitha vendbanimet në 8 vitet e ardhshme në nënzona janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nënzona e banimit	Sipërfaqja e përgjithshme për zhvillim (PZHK)	Sipërfaqja e shfrytëzuar për zhvillim (ndërtim aktual)	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)	Numri i banorëve në 8 vitet e ardhshme	Sipërfaqja e nevojshme për banim të përherëshëm 8 vitet e ardhshme	Dendësia e banimit	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm (kufiri i ndërtimit sipas PZHK)
Sipërfaqe sub-urbane	331 ha	226 ha	105 ha	258 banorë	2.3 ha	30 - 105 banorë / hektarë	102.7 ha

PZHK në fuqi ka planifikuar sipërfaqe shumë më të madhe të tokës për akomodim të zhvillimit të ardhshëm në krahasim me kërkesat për zhvillim. Në këtë kontekst komuna duhet të kontrolloj zhvillimin në faza, duke lejuar sasi të caktuar të tokës për zhvillim bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për zhvillim.

5.1.4.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Banim i përherëshëm: shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte, shtëpi dyshe, shtëpi në varg, dhe ndërtesa terracore. Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet me shërbim tregtar/profesional, dhe shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare në përdhese të objektit. Shfrytëzimi i përzier lejohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë urbane: kategoria 1, 2, dhe 3;


- Shërbim tregtar: shitore me pakicë, dhe shërbim i akomodimit të ushqimit: restorant, hotel, hostel, bar, kafeteri etj. Këto lloje të shfrytëzimit lejohen të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë urbane: kategoria 1, 2, dhe 3;
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare. Ky lloj shfrytëzimi lejohet të zhvillohet vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët si në vijim:
 - Rrugë nacionale, dhe rajonale;
 - Rrugë urbane: kategoria 1, 2, dhe 3;
- Shërbim i komunitetit: shërbim fetar.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe shtalla.
- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe shtalla.

HARTA 6: SHFRYTËZIMI TOKËS NË QYTET LIPJAN



Shfrytëzimet e veçanta

- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; automekanik; autolarje; parkingje private; pompë të derivateve; saldues (shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).

Shfrytëzime të ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, veçanta, dhe dytësore.

5.1.4.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

[ZB-U3] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE SUB-URBANE

Treguesit bazë	Banim i përherëshëm		Shërbim tregtar: hotel	Shërbim tregtar: shitore me pakicë, restaurant/kafeteri	Shërbim profesional	Shërbim tregtar: Bujtina
Madhësia e parcelës	Shtëpi të vecanta	Min 300m ²	Min 200m ² Max 1,000 m ²	Min 200m ² Max 500m ²	Min 200m ² Max 400m ²	Min 500m ² Max 1000m ²
		Max 400m ²				
	Shtëpi dyshe	Min 400m ²				
		Max 500m ²				
	Shtëpi në varg	Min 150m ²				
		Max 200m ²				
Balli i parcelës ¹	Shtëpi të vecanta	Min 16m’	Min 12m’	Min 10m’	Min 10m’	Min 18m’
	Shtëpi dyshe	Min 20m’				
	Shtëpi në varg	Min 8m’				
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 1 Vlera max -2		Vlera bazë 1 Vlera max 2	Vlera bazë 1 Vlera max 2	Vlera bazë 1 Vlera max 2	Vlera bazë 1 Vlera max 2
Etazhiteti	Max B+P+2 (max 11.0 m’)		Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)	Max B+P+3 (max 14.0 m’)
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Vlera bazë 30% Vlera max 50%		Vlera bazë 30% Vlera max 50%	Vlera bazë 30% Vlera max 50%	Vlera bazë 30% Vlera max 50%	Vlera bazë 30% Vlera max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min 40%		Min 40%	Min 40%	Min 40%	Min 40%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Max 35%		0%	0%	0%	Max 35%
Rrjetet e vijave						

Vija Ndërtimore (VN)	Min 7m	-	Min 5m	Min 5m	Min 5m
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt)	Min 7m	-	-	-	
Vija rregulluese (VRr)	Duhet të përputhet me profilin e rrugës së planifikuar të nënzonës së banimit. Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale të rrugës.				
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.50H (zonë e pandërtuar) Min 0.25H (zonë e ndërtuar)	-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.50H (zonë e pandërtuar) Min 0.25H (zonë e ndërtuar)
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.25H (zonë e pandërtuar) Min 0.10H (zonë e ndërtuar)	-	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H e ndërtësës	Min 0.25H (zonë e pandërtuar) Min 0.10H (zonë e ndërtuar)
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët fqinjë arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri				
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për çdo shfrytëzim të lejuar. Për çdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m ² , gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m', p.sh:					
- Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 400m² – 500m² = 16.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë); - Shtëpi individuale: madhësia e parcelës 501m² – 600m² = 18.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës). Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë nënzonë.					

5.1.5 [ZB-U2] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE E PËRGJITHSHME URBANE

Nënzona gjendet në zonën urbane, qytet. Nënzona është planifikuar për banim, si sipërfaqe urbane e përgjithshme me dendeësi **105-200 banorë/hektarë**. Nënzona ofron hapësirë për zhvillim për shtëpi të veçanta, dyshe, dhe në varg; ndërtesa të banimit me shumë njësi, dhe shfrytëzime tjera plotësuese në pajtueshmëri me intenzitet të zhvillimit.

Në këtë nënzonë bëjnë pjesë zonat e banimit si në vijim: ZB2, 3, 4, 5, dhe 6.

Bazuar në trendin e përvetsuar të rritjes së popullsisë (ASK vlerësimi 2019 – 0.9% rritje), kjo nënzonë e banimit në vitin 2021 shënon 1,677 banorë. Në 8 vitet e ardhshme, 2021 – 2029, nënzona do të shënoj rritje për 126 banorë, apo 7.5%. Bazuar në trendin e rritjes së popullsisë dhe dendësisë së banimit, janë planifikuar 1 hektarë tokë për të akomoduar zhvillimin për banim të përherëshëm në 8 vitet e ardhshme (shih shtojcën 9 dhe 10).

Sipërfaqja e planifikuar për banim, dendësia e banimit, dhe numri i banorëve që mund të akomodojnë të gjitha vendbanimet në 8 vitet e ardhshme në nënzonë janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nënzona e banimit	Sipërfaqja e përgjithshme për zhvillim ¹	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për ndërtesa banimi me shumë njësi ²	Sipërfaqja për dendësim ³	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim ⁴	Rritja e numrit të banorëve 2021 – 2029 ⁵	Sipërfaqja e nevojshme për banim të përherëshëm 2021 – 2029 ⁶	Sipërfaqja e lirë për banim të përherëshëm pas vitit 2029 ⁷
-------------------	---	--	--------------------------------------	---	--	--	--

Sipërfaqe e përgjithshme urbane	136.4 ha	4.5 ha	29.2 ha	103 ha	126 banorë	1 ha	130 ha
1 – Sipërfaqja e planifikuar për zhvillim të nënzonës së banimit sipas dendësisë 105-200 banorë/hektarë. 2 – Sipërfaqja aktuale (e ndërtuar) e shfrytëzuar për ndërtesa me shumë njësi. 3 – Sipërfaqja aktuale (e ndërtuar) e shfrytëzuar për shtëpi njëshe dhe dyshe. Kjo sipërfaqe është tokë që mund të përdoret për dendësim – ngritje të dendësisë nga shtëpi njëshe/dyshe në ndërtesa banimi me shumë njësi sipas kushteve zhvillimore në këtë nënzonë. 4 – Sipërfaqja e lirë për ndërtim (e pandërtuar). Kjo sipërfaqe është e planifikuar të përdoret për ndërtesa banimi me shumë njësi, apo edhe për shtëpi njëshe/dyshe, dhe në varg sipas kushteve zhvillimore në këtë nënzonë. 5 – Rritja e numrit të banorëve nga 2021 në 2029. 6 – Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim, sasi të tokës, duke u bazuar në rritje të numrit të popullsisë. Llogaritja e sipërfaqës është bërë duke u bazuar në dendësinë për ndërtesa për banim me shumë njësi. Një përqindje e caktuar i është shtuar sipërfaqës për banim për të akomoduar kërkesat për njësi të reja të banimit që dalin nga migrimi i brendshëm dhe diaspora. 7 – Sipërfaqja e lirë për banim për të akomoduar zhvillimin pas 8 viteve të planifikuara, pas vitit 2029. Kufiri i vendosur nga PZHK në fuqi.							

PZHK në fuqi ka planifikuar sipërfaqe shumë më të madhe të tokës për akomodim të zhvillimit të ardhshëm në krahasim me kërkesat për zhvillim. Në këtë kontekst komuna duhet të kontrolloj zhvillimin në faza, duke lejuar sasi të caktuara të tokës për zhvillim bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për zhvillim.

5.1.5.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

Banim i përhershëm: shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte, shtëpi dyshe, shtëpi në varg, ndërtesa terracore, dhe ndërtesa me shumë njësi. Ky lloj i shfrytëzimit lejohej të kombinohet edhe me shërbim tregtar/profesional, dhe shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare në përdhese të objektit.

- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shitore me pakicë; dhe shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant, bare).
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.
- Shërbim i komunitetit: shërbim fetar.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe shtalla.

Shfrytëzimet e veçanta

- Shërbim tregtar: automekanik; autolarje; parkingje private, dhe pompa të derivateve (shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).

Shfrytëzime të ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.1.5.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

ZB-U2] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE E PËRGJITHSHME URBANE

Kushtet zhvillimore

Treguesit bazë		Banim i përherëshëm						Shërbim tregtar	Shërbim profesional	
		Qytet Lipjan					Magure	Pjesë tjera	Pjesë tjera	
		ZB2	ZB3	ZB4	ZB5	ZB6				
Madhësia e parcelës	Shtëpi të vecanta	n/a	Min 300m ²						Min 200m ² Max 500m ²	Min 200m ² Max 500m ²
	Shtëpi dyshe	n/a	400m ²							
	Shtëpi në varg	n/a	150m ²							
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 2000m ²	Min 1000m ²	Min 1000m ²	Min 1000m ²	Min 1000m ²	Min 3,000m ²			
Balli i parcelës	Shtëpi të vecanta	n/a	Min 14m						Min 12m’	Min 12m’
	Shtëpi dyshe	n/a	Min 16m							
	Shtëpi në varg	n/a	Min 6m							
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 30m	Min 25m	Min 20m	Min 20m	Min 20m	Min 50m			
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Shtëpi të vecanta, dyshe, varg	n/a	Vlera bazë 1 Max 1.5						Vlera bazë 1 Max 1.5	Vlera bazë 1 Max 1.5
	Ndërtesë me shumë njësi	Vlera baze 2.5 max 3.2	Max 2.5	Max 2.0	Max 1.8	Max 1.6	Vlera bazë 1.0 Max 2.8			
Etazhiteti	Shtëpi të vecanta, dyshe, varg	n/a	B+P+2						B+P+2 Max 15m’	B+P+2 Max 15m’
	Ndërtesë me shumë njësi	B+P+6 Max 24m’	B+P+ 5 Max 21 m’	B+P+4 Max 18 m’	B+P+4 Max 18 m’	B+P+3 Max 15 m’	B+P+5 Max 24 m’			

Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Vecantë, dyshe, varg	Max 40%	Max 40%					Max 50%	Max 50%
	Ndërtesë me shumë njësi	40%	50%	50%	50%	50%	Max 35%		
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	--	Min 30%	Min 40%	Min 40%	Min 40%	Min 30%	Min 40%	Min 30%	Min 30%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	--	60%	50%	50%	50%	50%	Max 30%	Max 50%	Max 50%
<i>Rrjetet e vijave</i>									
Vija Ndërtimore (VN)	Vecantë, dyshe, varg		Min 5m'					Min 10m'	Min 10m
	Ndërtesë me shumë njësi	10m'	Min 10m'						
Vija rregulluese (VRr)	Duhet të përputhet me profilin e rrugës së planifikuar të nënzonës së banimit. Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale të rrugës.								
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNT)	Vecantë, dyshe, varg		Min 5m'					Min 10m'	Min 10m'
	Ndërtesë me shumë njësi	Min10m'	Min 10m'						
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Vecantë, dyshe, varg	Min 0.50H (zonë e pandërtuar); Min 0.25H (zonë e ndërtuar)						Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 0.50H (zonë e pandërtuar); Min 0.25H (zonë e ndërtuar)							
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Vecantë, dyshe, varg	Min 0.25H (zonë e pandërtuar); Min 0.10m' (zonë e ndërtuar)						Min 0.2H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 0.25H (zonë e pandërtuar); Min 4m' (zonë e ndërtuar)							
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët fqinjë arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri								
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m², gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 1.0m', p.sh:									
- Ndërtesë me shumë njësi: madhësia minimale e parcelës 3,000m² – 3,100 m² = 50.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë); - Ndërtesë me shumë njësi: madhësia e parcelës 3,101m² – 3,200m² = 51.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës);									
<u>Rregulla e rritjes proporcionale të gjerësisë së ballit të parcelës 1.0m për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 – 100m² vlenë vetëm për ndërtesat me shumë njësi në këtë zonë.</u>									

Për të gjitha shfrytëzimet tjera, përvec ndërtesave me shumë njësi, vlenë rregulli i rritjes së gjerësisë minimale të ballit të parcelës me 2.0m për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 – 100m².

Në rastet kur parcela për zhvillim gjendet në kënd dhe është e kufizuar me dy kategori të rrugës, njëra pjesë me kategori më të lartë dhe tjetra pjesë me kategori më të ulët, rregulli për vijë ndërtimore është si në vijim:

- Për pjesën e parcelës që kufizohet me rrugë të kategorisë më të lartë, aplikohet vija ndërtimore e përcaktuar nga kushtet zhvillimore në tabelë, psh për ndërtesat me shumë njësi 15.0m;
- Për pjesën e parcelës që kufizohet me rrugë me kategori më të ulët, aplikohet vija ndërtimore 2 metra me e vogël, psh. për ndërtesat me shumë njësi 13m.
- Vija ndërtimore zvogëlohët proporcionalisht për 2.0m për cdo kategori më të ulët në raport me kategorinë më të lartë të rrugës.

Në rastet e shfrytëzimit të lejuar për banim të përhershëm (shtëpi individuale, dyshe, dhe në varg), për parcelat të cilat janë vecse të formuara dhe nuk i përmbushin kërkesat e kushteve zhvillimore (madhësisë minimale të parcelës), vlejnë rregullat si në vijim:

- Për parcelat me madhësi prej 200 – 299m² lejohet ndërtimi i shtëpisë individuale: etazhitet=B+P+1K, ISHPKZH=35%; VN=4m; DAP1=0.30H; DAP2=0.15H.
- Për parcelat me madhësi nga 150 – 199m² lejohet ndërtimi i shtëpisë individuale: etazhitet=B+P, ISHPKZH=40%; VN=3m; DAP1=0.30H; DAP2=0.15H.

5.1.6 [ZB-U1] NËNZONA E BANIMIT – SIPËRFAQE URBANE QENDRORE

Nënzona gjendet në zonën urbane, qytet. Nënzona është planifikuar për banim, si sipërfaqe urbane qendrore me dëndësi **mbi 200 banorë/hektarë**. Nënzona ofron hapësirë për zhvillim për ndërtesa të banimit me shumë njësi, dhe shfrytëzime tjera plotësuese në pajtueshmëri me intenzitet të zhvillimit.

Në këtë nënzona bënë pjesë zona e banimit: ZB1 & ZB7

Bazuar në trendin e përvetsuar të rritjes së popullsisë (ASK vlerësimi 2019 – 0.9% rritje), kjo nënzona e banimit në vitin 2021 shënon 2,221 banorë. Në 8 vitet e ardhshme, 2021 – 2029, nënzona do të shënoj rritje për 166 banorë, apo 7.5%. Bazuar në trendin e rritjes së popullsisë dhe dëndësisë së banimit, janë planifikuar 1 hektarë tokë për të akomoduar zhvillimin për banim të përherëshëm në 8 vitet e ardhshme (shih shtojcën 9 dhe 10).

Sipërfaqja e planifikuar për banim, dëndësia e banimit, dhe numri i banorëve që mund të akomodojnë të gjitha vendbanimet në 8 vitet e ardhshme në nënzona janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nënzona e banimit	Sipërfaqja e përgjithshme për zhvillim ¹	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për ndërtesa banimi me shumë njësi ²	Sipërfaqja për dëndësim ³	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim ⁴	Rritja e numrit të banorëve 2021 – 2029 ⁵	Sipërfaqja e nevojshme për banim të përherëshëm 2021 – 2029 ⁶	Sipërfaqja e lirë për banim të përherëshëm pas vitit 2029 ⁷
Sipërfaqe urbane qendrore	36 ha	12.3 ha	23.7 ha	0 ha	166 banorë	1.25 ha	22.5 ha

- 1 – Sipërfaqja e planifikuar për zhvillim të nënzonaës së banimit sipas dëndësisë 105-200 banorë/hektarë.
2 – Sipërfaqja aktuale (e ndërtuar) e shfrytëzuar për ndërtesa me shumë njësi.
3 – Sipërfaqja aktuale (e ndërtuar) e shfrytëzuar për shtëpi njëshe dhe dyshe. Kjo sipërfaqe është tokë që mund të përdoret për dëndësim – ngritje të dëndësisë nga shtëpi njëshe/dyshe në ndërtesa banimi me shumë njësi sipas kushteve zhvillimore në këtë nënzonaë.
4 – Sipërfaqja e lirë për ndërtim (e pandërtuar). Kjo sipërfaqe është e planifikuar të përdoret për ndërtesa banimi me shumë njësi, apo edhe për shtëpi njëshe/dyshe, dhe në varg sipas kushteve zhvillimore në këtë nënzonaë.
5 – Rritja e numrit të banorëve nga 2021 në 2029.
6 – Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim, sasi të tokës, duke u bazuar në rritje të numrit të popullsisë. Llogaritja e sipërfaqës është bërë duke u bazuar në dëndësinë për ndërtesa për banim me shumë njësi. Një përqindje e caktuar është shtuar sipërfaqës për banim për të akomoduar kërkesat për njësi të reja të banimit që dalin nga migrimi i brendshëm dhe diaspora.
7 – Sipërfaqja e lirë për banim për të akomoduar zhvillimin pas 8 viteve të planifikuara, pas vitit 2029. Kufiri i vendosur nga PZHK në fuqi.

PZHK në fuqi ka planifikuar sipërfaqe shumë më të madhe të tokës për akomodim të zhvillimit të ardhshëm në krahasim me kërkesat për zhvillim. Në këtë kontekst komuna duhet të kontrolloj zhvillimin në faza, duke lejuar sasi të caktuara të tokës për zhvillim bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për zhvillim.

5.1.6.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Banim i përhershëm: ndërtesa me shumë njësi. Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet edhe me shërbim tregtar/profesional, dhe shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare në përdhese të objektit.
- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shitore me pakicë; dhe shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant, bare).
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.
- Shërbim i komunitetit: shërbim fetar.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.

Shfrytëzimet e veçanta

- Shërbim tregtar: automekanik; autolarje; parkingje private, pompa të derivateve (shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.1.6.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë		Banim i përhershëm		Shërbim tregtar	Shërbim profesional
		ZB1	ZB7		
Madhësia e parcelës	Shtëpi të veçanta/dyshe/ne varg	--	Min 300m ² / 500m ² / 150m ²	Min 200m ² Max 500m ²	Min 200m ² Max 500m ²
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 2000m ²	--		
Balli i parcelës	Shtëpi të veçanta/dyshe/ne varg	--	14m / 16m / 6m	Min 12m'	Min 12m'
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 30m'	--		
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Shtëpi të veçanta/dyshe/ne varg	--	0.8	Vlera bazë 1.0 Max 2	Vlera bazë 1.0 Max 2
	Ndërtesë me shumë njësi	Vlera bazë 3.0 Vlera max 4.0			
Etazhiteti	Shtëpi të veçanta/dyshe/ne varg	--	Max B+P+2 Max 8m'	B+P+3 Max 12 m'	B+P+3 Max 12 m'
	Ndërtesë me shumë njësi	B+P+8 Max 32m'			

Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Max 35%	Max 50%	Max 50%
	Ndërtesë me shumë njësi	Max 40%	--		
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Min 40%	Min 30%	Min 30%
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 30%	--		
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	50%	Max 50%	Max 50%
	Ndërtesë me shumë njësi	60%	--		
<i>Rrjetet e vijave</i>					
Vija Ndërtimore (VN)	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Min 15m’	Min 5m’	Min 5m’
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 15m’	--		
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNT)	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Min 5m’	Min 5m’	Min 5m’
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 10m’	--		
Vija rregulluese (VRr)	Duhet të përputhet me profilin e rrugës së planifikuar të nënzonës së banimit. Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale të rrugës.				
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Min 0.50H (zonë e pandërtuar); Min 0.25H (zonë e ndërtuar)	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 0.50H (zonë e pandërtuar); Min 0.25H (zonë e ndërtuar)	--		
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Shtëpi të veçanta/ dyshe/ne varg	--	Min 0.25H (zonë e pandërtuar); Min 0.10m’ (zonë e ndërtuar)	0.10H e ndërtesës	0.10H e ndërtesës
	Ndërtesë me shumë njësi	Min 0.25H (zonë e pandërtuar); Min 4m’ (zonë e ndërtuar)		Min 3m	Min 3m
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri				
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të					

parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m², gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 1.0m', p.sh

- Ndërtesë me shumë njësi: madhësia e parcelës 2110m²- 2,200m² = 22.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës);
- Ndërtesë me shumë njësi: madhësia e parcelës 2000m²- 2,100m² = 21.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës);

Rregulla e rritjes proporcionale të gjerësisë së ballit të parcelës 1.0m për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 – 100m² vlenë vetëm për ndërtesat me shumë njësi në këtë zonë.

Në rastet kur parcela për zhvillim gjendet në kënd dhe është e kufizuar me dy kategori të rrugës, njëra pjesë me kategori më të lartë dhe tjetra pjesë me kategori më të ulët, rregulli për vijë ndërtimore është si në vijim:

- Për pjesën e parcelës që kufizohet me rrugë të kategorisë më të lartë, aplikohet vija ndërtimore e përcaktuar nga kushtet zhvillimore në tabelë, psh për ndërtesat me shumë njësi 15.0m;
- Për pjesën e parcelës që kufizohet me rrugë me kategori më të ulët, aplikohet vija ndërtimore 2 metra me e vogël, psh. për ndërtesat me shumë njësi 13m.
- Vija ndërtimore zvogëlohet proporcionalisht për 2.0m për cdo kategori më të ulët në raport me kategorinë më të lartë të rrugës.

5.2 ZONË INDUSTRIALE [ZI]

Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim të industrisë. Zona ofron hapësirë për zhvillim të industrisë së rëndë, të mesme dhe të lehtë. Në të njëjtën kohë zona do të akomodojë shfrytëzime komerciale të cilat janë në shërbim të industrisë. Zona përfshinë sipërfaqe prej 185 ha nga territori i komunës së Lipjanit.

5.2.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Industri e lëndës së parë: prodhim i produkteve të tekstilit, drurit, letrës, kimike dhe firave, metaleve, minerale, të gomës dhe plastikës.
- Industri e prodhimeve të rënda: prodhim i makinerive, i automjeteve dhe pajisjeve transporti, dhe produkteve tjera (shiko UA për zona industriale).
- Industri e prodhimeve të lehta: prodhim i pijeve dhe produkteve të duhanit, rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, dhe pajisje elektrike dhe optike.
- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant); automekanik; dhe autolarje.
- Shërbim tjetër tregtar: depo/magazinim.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: industri; shfrytëzim dytësor: kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.

Shfrytëzimet e veçanta

- Shërbim tregtar: pompa të derivateve (shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.2.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Industri e lëndës së parë / rëndë	Industri e prodhimeve të lehta	Shërbim tregtar	Shërbim tjetër tregtar	Shërbim profesional
Madhësia e parcelës	Min 2,000m ²	Min 1,500m ²	Min 1,000m ²	Min 1,000 m ²	Min 500m ²
Balli i parcelës ¹	Min 50m	Min 40m’	Min 25m’	Min 25 m’	Min 20m
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.50 Max 1.0	Vlera bazë 0.50 Max 1.0	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.5 Max 1	Vlera bazë 0.5 Max 1
Etazhiteti	P + 0 (7.0 m’) P + 1 (12 m’)	P + 0 (7.0 m’) P + 1 (12 m’)	B+P+1 Max 9 m’	B+P+0 (5.0 m’) B+P+1 (8.0 m’)	B+P+1 Max 9 m’
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	30%	30%	30%	30%	30%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	0%	0%	50%	50%	50%
<i>Rrjetet e vijave</i>					
Vija Ndërtimore (VN)	Min 10m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 10m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt)	Min 10m	Min 10m’	Min 5m’	Min 7m’	Min 5m’
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare ²	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri.				
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m ² , gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m’, p.sh:					
- Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 2,000m² – 2,100m² = 50.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë); - Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 2,101m² – 2,200m² = 12.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës).					
<u>Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë zonë.</u>					
2 - Objektet industriale duhet të vendosen në lokacionet që do të jenë larg zhvillimeve fqinje, si dhe në distanca të përcaktuara me ligjet dhe aktet ligjore përkatëse nga monumentet natyrore e kulturore, dhe resurset natyrore, ashtu që të pengohet apo shmanget ndikimi negativ. Gjithashtu, distanca e këtyre objekteve nga infrastruktura e transportit hekurudhor, infrastruktura ekzistuese e telekomunikacionit, trajtimin e mbeturinave apo të					

ujësjellësit, ujërave të zeza dhe energjisë termike elektrike ekzistuese duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligje dhe aktelgjore të sektorëve përkatës. Objektet industriale nuk duhet të ndërtohen në afërsi të zonës së banimit, shërbimeve dhe hapësirave të hapura rekreative. Objektet industriale duhet të jenë të larguara së paku 800.0m' nga shkollat dhe qendrat shëndetësore.

Sipërfaqe urbane e përgjithshme			Kushtet zhvillimore	
Numri maksimal i kateve	3 deri 7	2000	madhesia e parceles ari	
2.Vlera maksimale e (ISHPKZh):	50% - 70%	6400	ISN 3.2	
3.Vlera bazë e (ISN)	2.5	1000	ishpkzh 50%	
4.Vlera maksimale e (ISN)	4	6.4000	Etazhiteti	
5.Dendësia e banimit:	105 - 200 banorw/ha	100	mestarja m ² per nje banese /njesi banimit	
		64	numri i njesive totale te banimit	
madhesia e parceles	2000			
Isn	3.2			
ISHPKZH	50%			
Etazhiteti	7			

Sipërfaqe urbane qendrore			Kushtet zhvillimore	
Numri maksimal i kateve /	/	2000	madhesia e parceles	
2.Vlera maksimale e (ISHPKZh)	70%	8000	ISN 4	
3.Vlera bazë e (ISN) 3.0	3	1000	ishpkzh 50%	
4.Vlera maksimale e (ISN) 5.0	5	8	Etazhiteti	

5.3 [ZK] ZONË KOMERCIALE

Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim komercial. Zona komerciale ka sipërfaqe totale prej 769 ha, nga e cila 138.8 ha (18%) shtrihet në zonë urbane, ndërsa 630.2 ha apo (82%) jashtë zonës urbane. Zona ofron hapësirë për zhvillim të tregtisë dhe industrisë së lehtë. Në të njejtën kohë zona do të akomodojë shfrytëzime tjera të cilat janë në shërbim të zonës. Zona komerciale planifikohet të zhvillohet në dy lokacione, një sipërfaqe brenda zonës urbane në qytet, dhe sipërfaqja tjetër jashtë zonës urbane.

5.3.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant/bare); automekanik; dhe autolarje.
- Industri e lëndës së parë: prodhim i produkteve të tekstilit, drurit, letrës, kimike dhe firave, metaleve, minerale, të gomës dhe plastikës.
- Industri e prodhimeve të lehta: prodhim i pijeve dhe produkteve të duhanit, rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, dhe pajisje elektrike dhe optike.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: industri; shfrytëzim dytësor: kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.


Shfrytëzimet e veçanta

- Industri e prodhimeve të lëndës së parë (Shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).


Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

HARTA 7: HARTA E ZONËS KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE



HARTA 8: HARTA E ZONËS EKONOMIKE



5.3.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Qytet		Pjesë tjera		
	Shërbim tregtar	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta	Shërbim tregtar	Shërbim profesional	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta
Madhësia e parcelës	Min 1000m ²	Min 500m ²	Min 500m ²	Min 500m ²	Min 1,000m ² Max 1,500 m ²
Balli i parcelës	Min 20m’	Min 20m’	Min 15m’	Min 15m’	Min 30m’
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.5 Max 1.5	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlerë bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1
Etazhiteti	B+P+2 Max 12m’	P + 0 (7.0 m’) P + 1 (12 m’)	B+P+1 Max 9 m’	B+P+1 Max 9 m’	P + 0 (7.0 m’) P + 1 (12 m’)
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	20%	20%	20%	20%	20%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	50%	0%	50%	50%	0%
Rrjetet e vijave					
Vija Ndërtimore (VN)	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt)	Min 6m	Min 6m	Min 8m	Min 8m	Min 8m
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri.				
1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m ² , gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m’ , p.sh:					
- Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 500m² – 600m² = 20.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë); - Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 601m² – 700m² = 22.0m’ (gjerësia minimale e ballit të parcelës).					
Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë zonë.					

5.4 [ZBJ] ZONË BUJQËSORE

Sipas Ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore: “Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdha peshku dhe moçale,

si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike”. Në këtë zonë përfshihet toka bujqësore e cila shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore intensive kryesisht për prodhim komercial - kultivimin e kulturave lavërtare, perimeve, dhe prodhimtari blegtorale - infrastrukturë bujqësore si dhe aktivitetet mbështetëse në funksion të tyre. Në këtë zonë përfshihen toka bujqësore të klasës II, IV dhe V. Toka bujqësore përdoret për aktivitete bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç në rastet dhe në kushtet e përcaktuara me Ligjin për tokën bujqësore 02/6L dhe dokumentin e HZK – së.

5.4.1 PËRSHTATSHMËRIA E TOKËS BUJQËSORE

Sipas PZHK-së, zona bujqësore përfshin në total 14,531 ha, nga e cila sipërfaqe 11,091 ha (76%) e sipërfaqes i përket klasës I-IV, dhe 3,440 (24%) i takon klasës V–VII. Në këto sipërfaqe është rekomanduar të zhvillohen bujqësia dhe blegtoria. Duke pas parasysh që sipas Ligjit për tokën bujqësore në fuqi nuk lejohet ndërtimi i infrastrukturës bujqësore si fermave dhe objekteve tjera bujqësore në tokën e klasës I–IV, ndërtimi i tyre do të lejohet në tokën e klasës V – VII. Ky kusht do të mund të ndryshohet në rast të shfuqizimit të pjesërishtë apo të plotë të ligjit në fuqi.

5.4.2 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim bujqësor. Zona ofron hapësirë për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë, respektivisht pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë, kultivimin e bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletarisë. Në të njëjtën kohë, zona do të akomodojë shfrytëzime tjera të cilat janë në shërbim të zonës, si ndërtesat bujqësore ku përfshihen: fermat për kultivimin e kafshëve të trasha, ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësore përcjellëse për bagëti dhe shpezëtar, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës, hapësira për makineritë dhe pajisjet bujqësore dhe peshkim.

Tokë bujqësore e kategorisë I - IV

Sipas ligjit për tokën bujqësore 02/6L, tokat bujqësore të klasave II dhe IV⁶ do të shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore dhe aktivitete të ndërlidhura me këtë veprimtari sipas kushteve të përcaktuara me HZK.

Shfrytëzimet e lejuara

- Prodhim bujqësor komercial: kultura bujqësore të përhershme dhe kullota në përdorim bujqësor;
- Prodhim bujqësor për konsum vetjak: si pemëtaria, perimtaria në të hapur dhe në serra në, lavërtaria, kultivimi i bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletaria në të gjithë zonën, prodhim bimor ose i kafshëve për konsum vetjak.

Shfrytëzimet dytësore

- Infrastruktura bujqësore – ndërtesat mbështetëse në funksion të prodhimit bujqësor parësor si: objekte strehë për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore (hambarët, koshat), dhoma frigoriferike, përpunimin primar të prodhimeve bujqësore (tharëse) dhe magazinimit të tyre, ndërtesa për mjete të punës dhe mekanizimin bujqësor dhe paisjet tjera.
- Infrastruktura blegtorale – fermat e mesme dhe të mëdha për mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve dhe ndërtesat e tyre përcjellëse (oborret për bagëti, pistat e betonit për depozitimin e

⁶ Ky kusht do të mund të ndryshohet pas shfuqizimit të pjesshëm apo të plotë të ligjit në fuqi Ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore

plehut, depozitat e ujit, etj), ndërtesat për ruajtjen e ushqimit për bagëti (hangar për sanë, depo silazhi, silosat,...), sallat për mjelje, hapësirat për përpunim primar të prodhimit Ndërtesat në funksion të prodhimitarisë bujqësore jashtë zonës së vendbanimit, mund të vendosen vetëm në sipërfaqet e tokës bujqësore që punohen dhe për të cilat dëshmohet arsyeshmëria ekonomike dhe se nuk do të bëhet krijimi i parcelave të reja ose parcelimi i pronës.

Shfrytëzimet e veçanta

Infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe e kullimit dhe ujitjes së tokës bujqësore, ndërtimet që bëhen për mbrojtje të tokës bujqësore nga përmytjet ose për rregullimin e përrockave ujore; infrastruktura e transportit: rrugët publike dhe të pakategorizuara, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta; infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit; prodhimi i energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (sipërfaqe me panele solare që shfrytëzojnë burimin diellor për prodhimin e ujit të ngrohtë edhe për energji elektrike).

Për të gjitha ndërtesat të cilat janë në funksion të shfrytëzimeve të veçanta të lejuara, përveç kushteve të përcaktuara me HZK është e domosdoshme edhe Leja mjedisore apo raporti i VNM-së në pajtim me legjislacionin përkatës.

Shfrytëzimet e përkohshme

Shërbime tregtare: shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale; peshkim rekreativ dhe profesional; shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët.

Shfrytëzimeve të ndaluara

Ndalohet të gjitha shfrytëzimet që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

Tokë bujqësore e kategorisë V- VII

Këto kategori të tokës bujqësore sipas UA për NTPH klasifikohet si tokë me përshtatshmëri nën mesatare për prodhimtari bujqësore komerciale. Rrjedhimisht HZK ka planifikuar që në këto kategori të tokës të zhvillohet kryesisht blegtoria, pemtaria, prodhimi bujqësor për konsum vetjak, dhe aktivitetet tjera.

Shfrytëzimet e lejuara

- Prodhim bujqësor komercial dhe bujqësi për konsum vetjak si pemëtaria e perimtaria në të hapur dhe në serra, lavërtaria, bletaria, kultivimi i fidanëve, dhe i bimëve mjekuese e dekoruese.
 - Fermat për kultivimin e kafshëve (lopë, dele, dhi), ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësore përcjellëse për bagëti dhe shpezëtarë, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, dhe ndërtesa për mjete të punës.

Shfrytëzimet dytësore

Banimit në rastet kur kemi zhvillim të bujqësisë për konsum vetjak; hapësirë e hapur rekreative; infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes të cilat janë në funksion të plotësisht të përmbytjeve të lejuara.

Shfrytëzimet e veçanta

Industri për prodhime të qumështit, dhe mishit; infrastruktura e transportit si rrugët publike dhe të pakategorizuara; shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta; infrastruktura e shpërndarjes së energjisë

elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit; prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë; prodhim i energjisë së ripërtërishme; hurdhat e peshqve.

Shfrytëzimet e përkohshme

Shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairot, peshkim rekreativ .

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.4.3 KUSHTET ZHVILLIMORE

- Tokës bujqësore në sistemin e ujitjes nuk mund t'i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçantë publike;
- Në rastet kur parcela përdoret për prodhimtari bujqësore komerciale madhësia e parcelës në të cilën do të ndërtohen objektet në funksion të bujqësisë duhet të ketë madhësinë jo më të vogël se 5,000 m².
- Në rastet kur parcela përdoret për prodhimtari bujqësore për konsum vetjak, madhësia minimale e parcelës për të cilën mund të lejohet ndërtimi i këtyre objekteve është 500.0m². Së paku 95% e sipërfaqes së parcelës duhet të përdoret si tokë e punueshme (pemishte, vreshtë, kopsht perimesh ose kopsht lulesh);
- Gabariti maksimal i shtëpizës ndihmëse për produktet bujqësore është 40.0m² për parcelat prej 500.0m² – 2000.0m² por jo më shumë se 60.0m² për parcela më të mëdha se 2000.0m². Sipërfaqja e depos mund të rritet për 20.0m² për çdo 1000.0m² më shumë, por deri në maksimum prej 80.0m²;
- Në afërsi të shtëpizës ndihmëse për produktet bujqësore lejohet ndërtimi i depos për vendosjen e prodhimeve (fruta, perime,) dhe mjeteve të punës dhe mekanizimit me sipërfaqe maksimale prej 100.0m²;
- Për kushtet rreth objekteve të banimit referoju Zonës së Banimit në vendbanimet rurale;
- Në parcelat më të mëdha se 2.0ha, lejohet ndërtimi i strehëve, verandave dhe pergolave për vendosjen e përkohshme të prodhimeve bujqësore me sipërfaqe deri 40.0m², me sipërfaqe bruto e së cilës mund të rritet për 20.0m² për çdo 5000.0m² shtesë të sipërfaqeve të kultivuara. Këto struktura duhet të ndërtohen nga materiale të lehta dhe të jenë të hapura nga të dy anët;
- Në parcelat e pemishteve me sipërfaqe më të madhe se 5.0ha mund të ndërtohet objekti i frigoriferit për ruajtjen e frutave me sipërfaqe maksimale prej 200.0 m²;
- Serat mund të vendosen në parcela të dimensioneve të ndryshme, por mos të pengojnë parcelat fqinje;
- Sipërfaqja e serave nuk duhet të jetë më e madhe se 70% e sipërfaqes së parcelës;

Infrastruktura bujqësore fermat dhe objekteve në funksion të prodhimit bujqësor vetjak dhe komercial

- Në kuadër të parcelës për ferma përfshihen shtallat për mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve dhe depo për ruajtjen e produkteve bujqësore, hambar, ahur, silose, hapësira për vendosjen e mjeteve dhe makinave bujqësore si dhe objekte për përpunimin dhe paketimin e produkteve bujqësore.
- Në këtë zonë varësisht nga madhësia e parcelës dhe kushtet ekzistuese do të ndërtohen fermat e vogla, të mesme dhe të mëdha.

Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Max 20%	/	/	/
Rrjetet e vijave				
Vija Ndërtimore (VN)	Largësia minimale e shtallave dhe objekteve në funksion të prodhimeve bujqësore nga infrastruktura rrugore dhe e hekurudhave duhet të jetë sipas ligjit Nr. 2003/11 për rrugë, ligji nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2003/11 për rrugë të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.03/L-120, dhe ligjin nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës në fuqi; • Largësia më e vogël e shtallave nga vija rregulluese është 20.0m’; • Largësia e objekteve mbështetëse nga vija rregulluese duhet të jetë së paku 5m; • Largësia më e vogël e objektit të bletores nga vija rregulluese duhet të jetë jo më pak se 40.0 m’; • Largësia e objekteve industriale nga vija rregulluese			
Distancat	• distanca e ndërtesave mbështetëse nga kufiri anësor i parcelës, në anën ku është e vendosur rruga e detyrueshme për qasje të automjeteve është 4.0m’, ndërsa nga kufiri anësor në anën e kundërt 1.0m’; • distanca minimale e objektit nga kufiri i parcelës fqinje duhet të jetë 1.0m’, dhe nga ndërtesa në parcelën fqinje jo më pak se 6.0m’; • distanca minimale e serës nga kufiri i parcelës duhet të jetë jo më pak se 3.0m’; • distanca minimale e serës nga ndërtesa e banimit në të njëjtën parcelë duhet të jetë jo më pak se 5.0m’; • distanca minimale mbrojtëse e zonave të banimit nga arat/pemishtet në të cilat aplikohet trajtimi intensiv me plehëra kimike dhe pesticide duhet të jetë jo më pak se 800.0 m’; • distanca minimale mbrojtëse e ndërtesave të prodhimit bujqësor nga zona e ndërtuar e vendbanimit duhet të jetë së paku 500.0m’; • bletoret duhet të jenë të larguara së paku 5.0m’ nga kufiri i parcelës fqinje nëse zgjojet e bletëve janë të kthyer përballë saj, dhe të paktën 3.0m’ nëse ato janë të kthyer në drejtim të kundërt; • stallat e mesme që mbarështojnë 5-10 njësi blegtorale në baza ditore duhet të jenë të larguara së paku 5.0m’ nga kufijtë e parcelës; • stallat që mbarështojnë 10-50 njësi blegtorale në baza ditore duhet të jenë të larguara së paku 10.0m’ nga kufinjtë e parcelës; • distanca minimale e shtallës së vogël nga ndërtesa e banimit duhet të jetë 15.0m’; • në rast se oborret ekonomike të parcelave fqinje kufizohen drejtpërdrejt me njëra tjetrën, distanca e objekteve të reja mbështetëse nga kufiri i parcelës nuk mund të jetë më pak se 1.50m’; • nëse oborri ekonomik i një parcele kufizohet drejtpërdrejt me pjesën rezidenciale të parcelës tjetër, largësia e strukturave të reja mbështetëse është së paku 15.0m’; • ndërtesat për grumbullimin e plehut duhet të vendosen afër stallës, me ekspozim kah veriu, dhe me qasje përmes sipërfaqes së pllakosur të rrugës; Largësia më e vogël e ndërtesave mbështetëse për vendgrumbullim të plehut, kompostim, dhe depozitim të sanës dhe kashtës nga kufijtë e parcelës është së paku 5.0m’; • distanca e hapësirës për depozitim të plehut nga shtalla duhet të jetë së paku 50.0m’; • distanca minimale e ndërtesës së banimit, pusit, ose burimit të ujit nga vendgrumbullimi i plehut të fermave të vogla dhe tualeteve në natyrë është së paku 20.0m’, dhe atë vetëm kur vendgrumbullimi i plehut është në kuotë më të ulët se ato; • distanca e objektit për ruajtjen e ushqimit të bagëtisë, silosit me kapacitet deri 100 tonelata nga muret me hapje të ndërtesës së banimit duhet të jetë 15.0m, 8.0m’ nga ndërtesat tjera në parcelë, dhe 5.0m’ nga kufijtë e parcelës; • distanca e fermave të mëdha deri në 50 njësi blegtorale nga ndërtesat e banimit duhet të jetë së paku 200m’; • distanca e fermes nga komplekset rekreative – sportive dhe të tjera publike duhet të jetë sipas ligjit dhe akteve nënligjore të sektorëve përkatës në fuqi, por jo më pak se 500.0m’; • distanca e fermës nga komplekset rekreative-sportive dhe komplekset tjera publike duhet të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse të kësaj fushe por jo më pak se 500m; • distanca minimale mbrojtëse e ndërtesave të prodhimit bujqësor nga zona e ndërtuar e vendbanimit është së paku 500.0m’.			

Masat mbrojtëse

Masat mbrojtëse për tokën bujqësore rregullohet me legjislacionet respektive në fuqi. Për më shumë, masat mbrojtëse përcaktohet edhe sipas ligjit nr. 03/L-214, konkretisht sipas VNM. Masat mbrojtëse janë përcaktuar sipas kushteve në vijim:

- ndalohet kullimi apo depozitimi i materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në tokën bujqësore dhe kanalet e ujitjes;
- në tokën bujqësore të punueshme, ndalohet përdorimi i folieve të cilat nuk janë biodegraduese;
- rekomandohet që serat të jenë në parcela në terren të rrafshët, me ekspozim të lirë ndaj jugut dhe juglindjes, i mbrojtur nga erërat;
- toka në të cilën ndërtohet shtalla duhet të jetë kompakte, dhe duhet të ketë rrjedhje të mirë të ujërave atmosferikë;
- për shkak të rrezikut nga erozioni, terrenet me pjerrësi më të madhe se 30 ° nuk janë të përshtatshme për rritjen e pemëve frutore. Rekomandohen parcelat me pjerrësi të butë prej 4 deri në 6 ° të cilat mundësojnë regjim më të favorshëm të ujitjes dhe ajrosjes;
- për mbrojtje nga erërat e forta rekomandohet ngritja e brezave të gjelbërimit mbrojtës me gjerësi 10.0-15.0m' dhe largësi 200.0-300.0m' nga pemishtja;
- lokacioni për ferma duhet të jetë jashtë zonës që mund të rrezikohet nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut;
- rekomandohet ndarja me një rrip të gjelbër (pemë, shkurre) ndarja e oborrit ekonomik të fermat e vogla nga pjesa e banimit;
- rekomandohet që serat të jenë në parcela në terren të rrafshët, me ekspozim të lirë ndaj jugut dhe juglindjes, dhe të mbrojtura nga erërat;
- për shitjen e llojeve të caktuara të artikujve (artikujve që lehtë prishen) duhet të sigurohen pajisje për temperaturë të ultë për ruajtjen e tyre;
- për shitjen e shalqinjve, pjepave, specave, lakrave, patateve dhe llojet tjera të pemëve dhe perimeve duhet të sigurohet një shtresë për vendosjen e mallit e cila duhet të jetë e ngritur nga sipërfaqja e tokës;
- shitësi ambulant mund të bëjë shitjen vetëm në vendet për të cilat organet e qeverisjes lokale kanë dhënë lejen paraprake;
- pika grumbulluese në të cilën behët grumbullimi i kafshëve duhet rrethuar , ndërtuar nga materiali i përshtatshëm me numër të mjaftueshme të hyrjeve dhe daljeve të cilat mund të mbyllen, vende për lidhjen e kafshëve, vendin për ngarkimin-shkarkimin si dhe pajisje për furnizimin me ujë të pijshëm për kafshë.

5.5 [ZP] ZONË PYJORE

Kjo zonë është e planifikuar si zonë pyjore që përfshinë tokës që mbuluar me pemë pyjore në formë të grumbullit pyjor që përfshinë edhe bashkësitë bioekologjike. Zona pyjore përfshin sipërfaqe prej 12,181 ha.

Toka pyjore përfshin sipërfaqet e tokës të mbuluara me pemë pyjore në formë të grumbullit pyjor që përfshin edhe bashkësitë bioekologjike, me sipërfaqe më të madhe se dhjetë (10) ari⁷.


⁷ UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor

Në komunën e Lipjanit rrafshlartat janë kryesisht të mbuluara me pyje, përjashtim bën zona e mihjeve përrreth Magurës. Parku nacional “ Parku Blinaja” një zonë e madhe pyjore e mbrojtur që shtrihet në jugperëndim të komuëns.

Sipërfaqja e zonës pyjore (PZH)	
Pyje të larta	1,621 ha
Pyje të ulëta	2,993 ha
Shkurre	8,735 ha
Total	13,350 ha

Sipërfaqja totale e zonës pyjorë është 13,350 ha, apo 39.4% e tërritorit të përgjithshëm të komunës. Sipërfaqja e njëjtë është planifikuar nga HZK që të shfrytëzohet dhe të mbrohet në 8 vitet e ardhshme.

HARTA 10: HARTA E ZONËS PYJORE



5.5.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër;
- Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë;
- Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha ndërtesat apo strukturat teknike që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në këtë zonë, shfrytëzime

dytësore konsiderohen: ndërtesat mbështetëse (shtëpi malore⁸), të cilat janë në funksion të prodhimitarisë pyjore, përfshijnë ndërtesat të cilat janë në funksion të menaxhimit të pyjeve, përmes të cilave sigurohet mirëmbajtja dhe përmirësimi e fondit ekzistues pyjor (përfshirë edukimin, mbrojtjen, rregullimin dhe përdorimin e pyjeve, hapjen dhe mirëmbajtjen e shtigjeve dhe rrugëve pyjore) dhe përmirësimin e gjitha funksioneve tjera të pyllit.

Shfrytëzimet e veçanta

Shfrytëzime të veçanta përfshijnë prerjen e pyjeve, ripyllëzimin, meliorimin të gjitha në pajtueshmëri me dispozitat ligjore respektive.

Shfrytëzimet e përkohshme

Në sipërfaqet e zhveshura të pyjeve me propozimin dhe pëlqimet paraprake nga komuna dhe Agjensioni i pyjeve, banorëve të zonës ju lejohen ndërtime e struktura të përkohshme apo aktivitete të cilat i kontribuojnë valorizimit të zonës, dhe me kushtin që të mos ketë prerje drunj. Në kuadër të këtyre veprime do të përfshihen: kultivimi i bujqësisë dhe blegtorisë (shoqëritë e bletëve (deri në 100)), shfrytëzimi i mineraleve, gjuetia, ndërtesat e klubeve/shoqatave të gjuetareve e të ngjashme, mbledhja dhe pikat shitëse të prodhimeve bujqësore/blegtorale, aktivitete argëtuese e rekreative (hiking, turistike), peshkimi, shfrytëzimi i produkteve jo-drusore (kërpudha, frutat e egra), kultivimi i kafshëve të egra (drerit, kaprollit, lepurit, ujkut etj), etj.

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.5.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Ndërtesat mbështetëse të pylltarisë	Ndërtesat tjera
Madhësia e parcelës	Max 500 m ²	Sipas normave respektive
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Max 1	
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%	
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min. 40%	
Distanca	Shoqëritë e bletëve duhet të ndërtohen larg sipërfaqeve ujore dhe të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, infrastrukturës rrugore, si dhe shfrytëzimeve tjera të frekuentuara nga komuniteti.	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Objektet e reja duhet të jenë të ndërtuara nga materialet të cilat lehtë mund të çmontohen dhe të cilat janë miqësore me mjedisin si dru, gurë dhe qelq, me formë dhe ngjyra që janë në harmoni me mjedisin.	

5.6 [ZRT] ZONË REKREATIVE - TURISTIKE

Zona rekreative – turistike shtrihet në pjesën lindore dhe perendimore të komunës së Lipjanit duke u bazuar në burime natyrore dhe kulturore. Zona rekreative – turistike përfshin sipërfaqe prej 1,503 ha, që është shpërndarë në 5 terësi hapësinore.

⁸ Shtëpitë malore kanë karakter shërbyes strehim nga moti i keq, akomodim në rast nevojë, dhe kontrollim të hapësirës.

PZHK ka indentifikuar 5 tërësi hapësinore të cilat duhet të zhvillohen duke u bazuar në potencialet e tyre rekreative: turizëm memorial në Kleckë dhe Divjakë, turizëm agrarë në Banullë dhe Konjuh, turizëm kongresial Shalë dhe Gadime, turizëm piktoresk/malor në pjesën veri-perendimore dhe lindore. Përveç turizmit memorial, agrar, dhe kongresial, zona është e përshtatshme për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit malor, sportiv-aventurier, turizmit ekskursionist, speleoturizëit, dhe aktiviteteve rekreative në natyrë.

5.6.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Planifikimi i zonës në funksion të zhvillimit të rekreimit dhe turizmit bëhet në përputhje me vlerat e burimeve natyrore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat përfshijnë plotësimin e nevojave të mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të hapësirës. Në të njëjtën kohë, zona shërben edhe për të ofruar hapësirë dhe kushte të nevojshme për pushim aktiv dhe rekreim për të gjithë vizitorët.

Shfrytëzimet e lejuara

Në terësinë hapësinore veri-lindore (turizëm kulturor – malor) dhe atë lindore (turizëm malor, vikendor dhe kulturor) rekomandohet që të lejohet shfrytëzim i tokës për shërbim tregtar: hotel, bujtina, villa banimi dhe shtëpi malore. Për të përcaktuar lokacionin e saktë e shfrytëzimeve për këtë lloj të objekteve, dhe për të analizuar potencialin e vërtetë të zonës komuna duhet të hartoj Plan Rregulluese të Hollësishme për të dy terësitë hapësinore të lartëcekura (shih kaptinën 7).

Më poshtë janë paraqitur shfrytëzimet e lejuara:

- Hapësirat për rekreim: shtigjet për ecje malore, çiklizëm malor, kalërim në natyrë, ngjitje në shkëmbinj; pika soditëse; park aventure; vend-pikniqe; vendkampingje në natyrë;
- Ndërtesat në funksion të menaxhimit të pyjeve;
- Prerja sanitare e pyjeve;
- Ripyllëzimi në funksion të mbrojtjes dhe rregullimit të dëmtimeve mjedisore;

Shfrytëzime të veçanta

Çdo shfrytëzim i veçantë do t'i nënshtrohet kushteve zhvillimore shtesë, të cilat përcaktohen nga autoriteti përgjegjes i komunës për të parandaluar ndikimin negativ që ndodh nga zhvillimi i propozuar. Në rastet kur nuk ka mundësi që këto ndikime negative të zvogëlohen përmes kushteve zhvillimore shtesë, drejtoria mund të refuzojë kushtet zhvillimore për aplikuesin.

- Infrastruktura rrugore-rrugët për qasje bashkë me infrastrukturë pëcjellëse;
- Bletaria;
- Aktivitetet për blegtori ekstensive (kullotja e kontrolluar)
- Vjelja e kontrolluar e frutave të imta dhe bimëve mjekuese;
- Peshkimi sportiv/rekreativ

Shfrytëzimet e përkohshme

Me pëlqimet paraprake nga komuna dhe Agjensioni i pyjeve, lejohet mundësia e ngritjes së strukturave të përkohshme vetëm jashtëzakonisht dhe me një afat të kufizuar të vlefshmërisë. Këtu përfshihen struktura portative të çmontueshme si: kiosk, garazhe, kabina të telefonit, stendat etj. Strukturat e përkohshme për shërbim të shpejtë si tendat, rimorkiot e të ngjashme mund të lejohen vetëm në raste të jashtëzakonshme për ngjarje publike: manifestime, dhe koncerte.

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, të veçanta dhe të përkohshme.

5.6.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Sic u cekë me lartë lokacionet e sakata për zhvillimet dhe ndërtimet e reja në zonë do të përcaktohen përmes një analize të detajuar dhe vlerësimit gjithpërfshirës të kushteve natyrore, teknike dhe ekonomike. Kjo analizë i paraprinë procesit të hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme për të dy tërësitë hapësinore të cekura më lartë.

Kushtet themelore gjatë projektimit dhe kryerjes së punëve ndërtimore në këtë zonë (ndërtimi i ndërtesave, rrugëve, shtigjeve, infrastrukturës, etj.) janë:

- Përshtatja e ndërtimit në mjedisin natyror;
- Përdorimi i materialeve autoktone (dru, gurë,...) dhe miqësore ndaj mjedisit;
- Shfrytëzimi i karakteristikave klimatike të lokacionit dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- Perimetri dhe etazhiteti i objekteve të jetë sa më i vogël;
- Rrethimi i objekteve parimisht duhet të shmanget, në rastet kur kjo është e domosdoshme duhet të bëhet me drunj, gjelbërim, ose materialngjashme.
- Mbetjet e materialit të përdorur për ndërtim duhet të largohen, nuk lejohet krijimi i deponive;

Shtigjet për ecje, çiklizëm, dhe kalërim

Gjatë ndërtimit të shtigjeve të reja duhet të synohet krijimi i një rrjeti funksional të rrugëve dhe shtigjeve me qëllim të prezantimit të vlerave natyrore të zonës duke i ndjekur udhëzimet në vijim:

- Trasimi i shtigjeve të reja për ecje malore, çiklizëm malor, kalërim në natyrë dhe ngjitje në shkëmbinj, duhet të bëhet në përputhje me konfigurimin e terrenit, dhe përshtatjen e tyre në mjedisin natyror. Shtigjet duhet të trasohen në drejtim të lokaliteteve tërheqëse të zonës (burime të ujit, shpella, ujëvara, kurora të maleve, kodra, vend-pikniqe, shtëpi malore, etj.)
- Kurdo që ka hapësirë të mjaftueshme, në korsitë e rrugëve lokale ekzistuese ose ngjitur me to, duhet të parashihen shtigjet për biçikleta (gjërësia minimale 2,5m);
- Shtigjet duhet të ndërtohen përgjatë kreshtave, pikave panoramike, lugina, përgjatë ujërrjedhave dhe kurdo që është e mundur duhet të shfrytëzohen trasetë ekzistuese të rrugëve fushore dhe malore të zonës duke shfrytëzuar
- Rekomandohet që përgjatë shtigjeve të ketë sa më shumë vend-pushime dhe punkte karakteristike (pika vrojtuese, ujërrjedha, drunj të vjetër,...), si dhe strehë për mbrojtje nga moti i keq (me sipërfaqe maksimale 50m²).
- Rekomandohet përdorimi i materialeve natyrore, varësisht nga lokacioni dhe destinimi i shtegut: elemente prej duri ose material prej lëvorëve të drunjve, gurë të thyer me madhësi të ndryshme, guralecë me madhësi dhe ngjyra të ndryshme, tullë e bluar, dhe i ngjeshur etj;
- Varësisht nga lokacioni dhe destinimi i shtegut mund të parashihet vendosja e mjeteve për ushtrime dhe rekreacion, hapësira të rregulluara për piknik, stola për ulje, shporta për mbeturina, gardhe mbrojtëse në segmente të rrezikshme, etj;

Hapësisra për vend-kampingje

Në lokacione të përshtatshme brenda komplekseve pyjore lejohet organizimi i kampeve të pajisura minimalisht për akomodimin e turistëve në pajtim me kushtet në vijim:

- Numri maksimal i lejuar i tendave është 10, ose më së shumti 20 persona në një lokacion;
- Lokalitetet duhet të vendosen në pajtim me kushtet natyrore të terrenit, qasshmërisë dhe qasjes në ujë të pijshëm
- Duhet të sigurohet pajisja minimale si: platforma për vendosjen e tendave, strehë prej druri dhe burim i ujit të pijshëm;
- Të kontrollohet hedhja e mbeturinave;
- Të shenjoen vendet ku lejohet ndezja e zjarrit dhe të sigurohen pajisje përkatëse për shuarjen e zjarrit (enët me rërë dhe me ujë).


Hapësira për vend-piknike

- Vendpikniqet vendosen në lokalitetet të caktuara të shënjura dhe të pajisura për këtë qëllim;
- Lokaliteti i vendpiknikut duhet të ketë sipërfaqe të mjaftueshme nën hije natyrore të krijuara nga drunjtë e lartë.
- Parkimi i automjeteve të vizitorëve duhet të vendoset në largësi optimale që mund të mund të arrihet me ecje të shkurtër ose me mjete alternative të transportit deri te lokaliteti i vendpiknikut;
- Gjatë instalimit të mobilierisë dhe strehëve, duhet të përdoren materiale natyrore dhe të qëndrueshme, dhe mund të ndërtohen duke përdorë elemente të arkitekturës tradicionale, lokale;
- Lokaliteti i vendpiknikut duhet të pajiset me ujë të pijshëm (burim, përroskë apo burim i improvizuar artificial) dhe pajisje përkatëse për shuarjen e zjarrit (enë me ujë dhe rërë);
- Në varësi të vendndodhjes së vendpiknikut duhet të shënjohen qartë vendet ku lejohet ndezja e zjarrit;
- Duhet të sigurohen lokacione adekuate për depozitimin e mbeturinave, dhe të organizohet menaxhimi i rregullt i tyre;
- Vendpikniqet duhet t'i kenë tabelat informuese lidhur me kushtet për shfrytëzimin e hapësirës, mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore etj.

5.7 [ZMS] ZONË MINIERË SIPËRFAQËSORE

Zona është planifikuar si hapësirë ë cila përmban përqendrim të rezervave specifike minerare të akumuluar, të cilat për nga sasia, cilësia dhe kushtet tjera, janë të përshtatshme për eksploatim. Në sipërfaqet e tilla mund të planifikohen ndërtesa të cilat janë mbështetje të këtij funksioni. Zona për fshinë hapësirë prej 333 ha përgjatë territorit të komunës së Lipjanit.

HARTA 11: ZONË MINIERË SIPËRFAQËSORE



5.7.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë
 - minierë për nxjerrje qymyrit, linjtit, torfës, naftës, dhe gazit natyror
- Minierë e xeheve metaleve
 - minierë për nxjerrje të hekurit dhe mineraleve të tjera metalike pa ngjyrë (me përjashtim të uraniumit dhe toriumit)
- Miniera dhe gurore tjetër
 - gurore të gurit, rërës, baltës, kimikateve, të prodhimit të kripës, dhe minierë apo gurore tjetër

Shfrytëzimet dytësor

Lejohen të gjitha shfrytëzimet për objektet mbështetëse që shërbejnë për të ushtruar funksionin e nxjerrjes së rezervave minerare, si infrastrukturë e transportit rrugor dhe hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, shërbim i logjistikës dhe magazinimit dhe administrativ dhe mbështetës si zyre administrative dhe objekte.

Shfrytëzimet e veçanta

- Prodhimtaria e eksplozivit, eksport, import, transit dhe transferim të eksploziveve dhe fishekzjarrëve (Parcela me numër: P-71409059-00562-1)
- Në sipërfaqet e eksploatura lejohet rikultivimi i sipërfaqes në pajtueshmëri me ligjet respektive, vendosja e paneleve solare për prodhimin e energjisë së ripërtërishme (me panele solate) nëse plotësohen kushtet e veçanta dhe ato mjedisore, e të ngjashme.

Shfrytëzimet e përkohshme

- Infrastrukturë/hapësirë për mbeturina si deponi e përkohshme e mbeturinave.

Shfrytëzimet e ndaluar

Ndalohet apo ushtrimi i ndonjë veprimtarie mbi shfrytëzimin e resurseve minerare në ndonjë sipërfaqe që:

- ndodhet 200 m ose më afër nga kufiri i një vendbanimi;
- ndodhet 250 m ose më afër nga ndonjë shtëpi, ndërtesë e banuar ose përkohësisht e pabanuar;
- ndodhet 20 m ose më nga ndonjë tokë e pastruar ose lëvruar, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore, ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur bartësi i licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë;
- ndodhet 200 m ose më afër nga ndonjë pendë ose rezervuar;
- ndodhet 60 m ose më afër nga ndonjë rrugë e sistemit kombëtar;
- ndodhet 100 m ose më afër nga varrezat;
- ndodhet 500 m ose më afër ndonjë aeroporti ose pjese të zonës së sigurisë së aviacionit;
- ndodhet brenda ndonjë parku kombëtar ose komunal të mbrojtur me ligj;
- ndodhet 500 m ose më afër nga ndonjë ndërtesë e banimit ose institucionale dhe publike, nëse përdoret eksploziv.

- ndodhet 150m' ose më afër të ndonjë termocentrali, largpërçuesi (35kë ose më lartë) ose lumi; Termocentrali duhet të jetë jo më afër se 150m' ose jo më larg se 250m' nga largpërçuesit nëse aktiviteti minerar zhvillohet pa minim;

5.7.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Ndërtesat mbështetëse
Madhësia e parcelës	MIN 300 m ²
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Max 0.5
Etazhitetit	Max P+1 (3.0 m')
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min. 40%
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Objektet e administratës duhet ndërtuar nga materiali ndërtimor si dru, gur, tulla, betoni, dritaret duhet të jenë nga PVC me ngjyrë të bardhë apo druri, kulmi duhet të jetë dy apo më shumë ujq, dhe parcela duhet të jetë e rrethuar me rrethojë metalike apo të drurit me lartësi 1.2m' apo me gjelbërim i lartë.
Masat mbrojtëse	Nëse është e nevojshme zhvilluesi duhet të ndërmerr masa për parandalimin e ndotjes së mjedisit, zhurmës apo rrezatimit të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit apo aktet tjera ligjore.

5.8 [SU] SIPËRFAQE UJORE

Sa i përket sipërfaqeve ujore në komën e Lipjanit lumnj të mëdhenjë janë: lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Degët e Sitnicës janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë dhe Lumi i Vërshevcit. Sipërfaqja ujore përbën 182 ha (1.1%) nga sipërfaqja totale e territorit të komunës së Lipjanit.

Sipërfaqja ujore përfshinë të gjithë ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore të cilat ndahen në burime të ujërave nëntokësore, liqenet dhe akumulimet, dhe ujë-rrjedhat e hapura.

Me qëllim të mbrojtjes së burimeve të ujërave nëntokësore, liqeneve dhe akumulimeve, dhe ujë-rrjedhave përcaktohen zonat e mbrojtura ujore, të cilat ndahen në:

- Zona 1 - Zona e kufizimit përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit dhe objekteve ujëmarrëse si dhe zonës së drejtpërdrejt të tyre nga çfarëdo dëmtimi, ndotje ose ndikim tjera të dëmshme të rastësishme ose të qëllimshme;
- Zona 2 - Zona e kontrollimit përcaktohet me qëllim të parandalimit të kontaminimit dhe rrezikut të ndotjes nga mikroorganizmat ose materiet tjera të dëmshme për cilësinë e ujit;
- Zona e 3 - Zona e mbikëqyrjes përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit nga ndotja me materie të rrezikshme ndotëse që vështirë zbërthehen dhe për pasojë dëmtojnë në afat të gjatë shfrytëzimin e ujit të burimit.


Në pasurinë ujore publike (qoftë ujërrjedhë apo akumulacion), sipas ligjit për ujëra, respektivisht UA për rregullimin e statusit të pasurisë ujore, si dhe për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve janë dhënë në kutinë e mëposhtme. Gjerësia e brezit bregudor është 5 m' nga shtrati i ujërrjedhës sipas përcaktimit ligjor.

Në veçanti, zonat e mbrojtjes të burimeve nëntokësore, rregullohen si në vijim:

- Zona I
 - zona mbrojtëse e liqenit të Gadimes 10m;
 - zona mbrojtëse e burimeve sipërfaqësore 10m;

- zona e burimeve nëntokësore formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distance prej ≥ 10 m;
- Zona II
 - zona mbrojtëse e liqenit të Gadimes 200m;
 - zona mbrojtëse e burimeve nëntokësore 100m;
 - zona mbrojtëse e burimeve sipërfaqësore 1,000m;
 - zona e burimeve në akuifer ndër-granulat formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distancë ≥ 50 m;
 - zona e burimeve në akuifer karstik dhe shkëmbinj me çarje formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distancë ≥ 500 m;
 - zona e burimeve minerale, termale dhe termike-minerale formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distancë ≥ 50 m.
- Zona III
 - zona mbrojtëse e burimeve nëntokësore 500m;
 - zona e burimeve në akuifer ndër-granulat formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth;
 - ndërtesës së mbledhjes së ujit në distancë ≥ 500 m;
 - zona e burimeve në akuifer karstik dhe shkëmbinj me çarje formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distancë ≥ 1000 m;
 - zona e burimeve minerale, termale dhe termike-minerale formohet në hapësirën e burimit menjëherë përreth ndërtesës së mbledhjes së ujit në distance ≥ 50 m.

HARTA 12: HARTA E SIPËRFAQEVE UJORE



SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- ndërtimi i objekteve të infrastrukturës publike (urat, rrugët, hekurudhat);
- ndërtimi i objekteve për rregullimin dhe mbrojtjen e ujërave;
- ndërtimi i objekteve për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike të ujërave sipërfaqësor;
- ndërtimi i objekteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës;
- ndërtimi i objekteve për shfrytëzimin e ujërave-veprat ujëmarrëse dhe veprat e akumulimit;
- ndërtimi i objekteve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja;
- ndërtimi i objekteve për nevojat e organeve shtetërore, mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve dhe pronës nga fatkeqësitë natyrore dhe për kryerjen e detyrave të policisë;

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- pasuria ujore publike mund të shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion në mënyrën që e përcakton korniza logjore përkatëse, komuna me pëlqim paraprak, të Autoritetit të rajonit të Pellgjeve lumore, dhe me kushtin që në asnjë formë të mos rrezikohet funksioni i zonës për destinimin që ka;

Shfrytëzimet e ndaluara:

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve tjera përpos atyre të përshkruara tek shfrytëzimet e lejuara.
- Eksploatimi i rërës dhe zhavorrit (përfshirë edhe gurët, dherat dhe argjilën) në zonat e rëndësishme për regjimin ujor, qoftë të rezervave të përtërishme po ashtu edhe të atyre të jopërtërishme. Përshtatim bën nxjerrja e rërës dhe zhavorrit për tu shfrytëzuar për mirëmbajtjen e ujërrjedhave dhe ndërtimin e objekteve rregulluese dhe mbrojtëse në ujërrjedha sipas përcaktimit ligjor;
- Ndërrimi i rrjedhjes së natyrshme të ujit sipërfaqësor apo nëntokësor përveç në rastet kur e lejon Ministria perkatese;
- Në brigjet e lumenjve ndalohet kryerja e aktiviteteve dhe veprimeve:
 - Në argjinaturat dhe objektet tjera rregulluese dhe mbrojtëse si: gjërmimi dhe deponimi i dheut, rërës, zhavorrit dhe materialeve tjera; vozitja dhe kalimi me mjete motorike përpos në vende ku është shprehimisht e lejuar një gjë e tillë; ndërmarrja e veprimeve tjera me të cilat mund të rrezikohet siguria dhe stabiliteti i këtyre objekteve;
 - Mbjellja e drunjve në largësi më të vogël 10 m' nga skaji i shtratit të ujërrjedhës;
 - Në zonën urbane aty ku është i rregulluar shtrati i lumit ndalohet ndërtimi i objekteve banesore dhe të tjera në distancë më të vogël se 10m' nga skaji i shtratit të ujërrjedhës;
 - Në zonën rurale ndalohet ndërtimi i objekteve banesore dhe të tjera në distancë më të vogël se 30m' nga skaji i shtratit të ujërrjedhës;
- Në brezin e inundacionit ndalohet kryerja e aktiviteteve dhe veprimeve:
 - Punimi i tokës, mbjellja e drunjve dhe shkurreve në brezin e rregulluar të inundacionit;
 - Në largësi më të vogël se 10m', ndalohet ngritja e ndërtesave, gardheve ose objekteve përpos objekteve rregulluese;
 - Nxjerrja e rërës, zhavorrit, argjilës ose materialeve tjera në distancë më të vogël 20m' nga skaji i jashtëm i objekteve rregulluese dhe mbrojtëse të trupit ujor sipërfaqësor;

- Kryerja e shpimeve dhe/apo hapja e puseve në distancë më të vogël se 20m' nga skaji i jashtë i objekteve rregulluese dhe mbrojtëse të trupit uhor sipërfaqësor, respektivisht nga vija e plotave të ujërave 100 vjeçare në rastet kur nuk ka objekte për mbrojtjen për mbrojtjen dhe rregullimin e ujërrjedhave;
- Deponimi i mbeturinave dhe materialeve tjera me çka mund të dëmtohet shtrati dhe brigjet e ujë rrjedhave, të ndryshohet traseja e saj, ta ndryshohet niveli i ujit dhe të ndikohet në sasinë dhe cilësinë e ujit.
- Për zonat e mbrojtura ujore sanitare veprimet e ndaluara janë si vijon:
 - Brenda Zonës I, nuk mund të ndërtohen ndërtesa ose instalime, të punohet toka ose të kryhen veprimtari të tjera, nëse ato rrezikojnë sigurinë e cilësisë së ujit në burim, si:
 - Instalimi i pajisjeve, magazinimi i pajisjeve dhe kryerja e aktiviteteve të cilat nuk janë në funksion të furnizimit me ujë;
 - Lëvizja e automjeteve të cilat janë në funksion të furnizimit me ujë jashtë rrugëve të veçanta, qasja e automjeteve të cilat nuk janë në funksion të furnizimit me ujë, përdorimi i barkave me motor, mbajtja e aktiviteteve sportive në ujë dhe notimi i njerëzve dhe kafshëve;
 - Pirja e ujit nga bagëtitë;
 - Kultivimi i peshkut dhe mbi-peshkimi komerciale.
 - Brenda Zonës II, nuk mund të ndërtohen ndërtesat ose instalime, të punohet toka ose të kryhen veprimtari të tjera, nëse ato rrezikojnë sigurinë e cilësisë së ujit në burim, si:
 - Ndërtimi i ndërtesave të banimit;
 - Përdorimi i plehrave kimike, të lëngshme dhe të ngurta;
 - Përdorimi i pesticideve, herbicideve dhe insekticideve;
 - Mbarsja lëvizja dhe kullotja e bagëtisë;
 - Kamping panairë dhe tubime të tjera të njerëzve;
 - Ndërtimi dhe shfrytëzimi i ndërtesave sportive;
 - Ndërtimi dhe shfrytëzimi i ndërtesave për hotelieri dhe akomodim;
 - Gërmimi dhe nxjerrja e rërës dhe zhavorrit;
 - Varreza të reja dhe zgjerimi i kapaciteteve të atyre ekzistuese.
 - Brenda Zonës III, nuk mund të ndërtohen ndërtesa ose instalimet, të punohet toka ose të kryhen veprimtari të tjera, nëse ato rrezikojnë sigurinë e cilësisë së ujit në burim, si:
 - Ruajtja e përhershme nëntokësore dhe mbitokësore e materialeve të rrezikshme dhe substancave të cilat nuk mund të sjellën drejtpërdrejt ose tërthorazi në ujë;
 - prodhimi, transporti dhe trajtimi i materialeve të rrezikshme dhe substancave të cilat nuk mund të sjellën drejtpërdrejt ose tërthorazi në ujë;
 - magazinimi komercial i naftës dhe produkteve të naftës së papërpunuar;
 - shkarkimi i ujërave të zeza dhe ujërave të cilat janë shfrytëzuar për ftohje të instalimeve industriale;
 - ndërtimi i rrugëve pa kanale për largim të ujërave atmosferike;
 - nxjerrja e naftës, gazit, materialeve radioaktive, qymyrit dhe të mineraleve;
 - deponimi i pakontrolluar i mbeturinave, automjeteve të dëmtuara, gomave të vjetra si dhe i substancave dhe materialeve të tjera të cilat mund të lirojnë ndotës gjatë shpëlarjes apo rrjedhjes;
 - shpyllëzimi i pakontrolluar;
 - ndërtimi i aeroporteve;

- punë sipërfaqësore dhe nën-sipërfaqësore, minim i tokës, depërtimi në shtresën që mbron ujërat nëntokësore dhe heqja e shtresës mbrojtëse ujë-përçuese, përveç rasteve kur këto aktivitete janë një funksion të furnizimit me ujë;
- mirëmbajtja e automjeteve dhe garave motorike.

5.8.1 KUSHTET ZHVILLIMORE

Kushtet zhvillimore sa i përket dimensionit të parcelës, lartësisë së ndërtesave, intensitetit të zhvillimit ejt. për ndërtesat dhe instalimet në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara në këto zona varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoret dhe duhet të jenë në përputhje me standardet e lejuara ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Masat mbrojtëse

- Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji;
- Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit
- Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
- Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohet të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.
- Ndalohet edhe përdorimi i substancave organike dhe inorganike për plehërimin e tokës dhe për mbrojtjen e bimëve në resurset ujore dhe brigje në largësi prej 15 metrash nga kufiri i bregut të ujit të klasit të parë dhe 5 metra largësi të bregut të ujit të klasit të dytë.
- Ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik, organizmat ujor dhe gjysmë ujor, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë pajisjet ose instalimet ujore.
- Në resurset ujore, ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme.
- Kur mund të rrezikohen kushtet cilësore apo sasiore në zonën e mbrojtur ujore mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve apo poseduesve të tokës.

6 KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFYTËZIMET E VECANTA

Kushtet zhvillimore për shfrytëzimet e veçanta vlejnë për të gjitha zonat e listuara më lartë. Të gjitha shfrytëzimet e listuara si të veçanta në të gjitha zonat duhet t'i përmbushin kushtet zhvillimore shtesë si më poshtë. Vetëm pasi që aplikuesi dëshmon që të gjitha kushtet zhvillimore shtesë janë përmbushur, do të jetë në gjendje që të vazhdojë me procedurat tjera për shfrytëzim të parcelës.


Shfrytëzim i vecantë: Shërbim tregtar – kafeteri
Kushte zhvillimore shtesë: - E tërë veprimtaria e shërbimit tregtar duhet të zhvillohet brenda kufirit të parcelës. Asnjë tavolinë e kafeterisë nuk do të lejohet të vendoset në pronë publike/komunale pa leje përkatëse; - Zhurma e gjeneruar nga zhvillimi nuk do të shkaktoj ndotje akustike për banoret përreth. Lokali duhet të posedoj izolim të përshtatshëm kundër zhurmës dhe të respektoj orarin e punës sipas rregullores komunale.
Shfrytëzim i vecantë: Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije.
Kushte zhvillimore shtesë: - Të gjitha vend parkimet e dedikuara për klientë duhet të vendosen brenda kufirit të parcelës për zhvillim vend parkim për 100m². - Ngarkimi/shkarkimi i mallit duhet të behët brenda kufijve të parcelës pa krijuar problem në qarkullim të komunikacionit në rrugët përreth parcelës.
Shfrytëzim i vecantë: Automekanik
Kushte zhvillimore shtesë: - Të gjitha automjetet që janë duke u riparuar dhe ato që janë në pritje për riparim duhet të parkohen brenda kufijve të parcelës për zhvillim – 2 vend parkime për 100m²; - Hyrja dhe dalja në parcelë/objekt duhet të jetë lehtë e qasshme dhe e sigurt për qarkullim; - Të gjitha punët mekanike që shkaktojnë zhurmë duhet të zhvillohen brenda objektit me izolim të përshtatshëm kundër zhurmës; - Kompresorët e ajrit dhe të gjitha mjetet tjera që shkaktojnë zhurmë duhet të vendosen brenda objektit; - Të gjitha llojet e fraksioneve të mbeturinave: vaj motori, bateri etj., duhet të deponohen në hapësira të veçanta brenda kufirit të parcelës deri në mbledhjen e tyre nga kompanitë e licencuara për grumbullim të mbeturinave.
Shfrytëzim i vecantë: Autolarje
Kushte zhvillimore shtesë: - Autolarjet nuk do të kenë qasje në rrjetin e ujësjellësit lokal. Shfrytëzimi i ujit për larje të automjeteve duhet të jetë burimi i ujit nga bunarët lokal apo nga burimet tjera të ujit përveç të rrjetit të ujësjellësit lokal. - Autolarjet nuk mund të vendosen në afërsi të rrathëve rrotullues. Ato do të lejohen në largësi prej 100m gjatësi afër rrathëve rrotullues. - Hyrjet dhe daljet në objekt duhet të jetë qarta, lehtë të qasshme dhe të sigurta për qarkullim. - Automjetet e pastruara dhe ato që presin të pastrohen duhet të parkohen brenda kufijve të parcelës. Nuk lejohet parkimi i automjeteve të pastruara dhe atyre që presin të pastrohen në

trotuare/rrugë përreth parcelës për zhvillim duke krijuar problem në qarkullim të komunikacionit dhe këmbësorëve – 2 vend parkime për një kompresor të ujit.
Shfrytëzim i vecantë: Parkingje private
Kushte zhvillimore shtesë: Parcela për zhvillim duhet të ketë qasje në rrugë kryesore me ballë të parcelës minimum 10m.
Shfrytëzim i vecantë: Saldues (farkëtar)
Kushte zhvillimore shtesë: - Të gjitha punët mekanike që shkaktjnë zhurmë duhet të zhvillohen brenda objektit me izolim të përshtatshëm kundër zhurmës. - Automjetet dhe strukturat për riparim duhet të parkohen/vendosen brenda kufijve të parcelës për zhvillim.
Shfrytëzim i vecantë: Pompë të karburanteve
Kushte zhvillimore shtesë: Ndalohet ndërtimi në distancë më të vogël se 1,000 m nga kufiri i parcelave për banim.
Industri e prodhimeve të lëndës së parë
Kushte zhvillimore shtesë: Shfrytëzimi për industri të prodhimeve të lëndës së parë duhet të siguroj që nuk do të shkaktoj ndotje, zhurmë, dhe shqetësime tjera për shfrytëzimet primare të zonës. Masat mbrojtëse dhe parandaluese duhet të sigurohen nga aplikuesi para së të lëshohet miratohet shfrytëzimi përkatës.

7 ZONAT MBISHTRESORE DHE KUSHTET ZHVILLIMORE TË TYRE

Bazuar në karakteristikat specifike të komunës së Lipjanti, HZK ka identifikuar katër zona mbishtresore. Sipas UA mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e HZK-së, zonat mbishtresore përkatojnë kushte dhe rregulla si në vijim.

HARTA 13: ZONAT MBISHTRESORE



- Zona mbishtresore përcakton kushte zhvillimore dhe ndërtimore plotësuese brenda një sipërfaqeje të komunës të cilës i nevojitet vëmendje e veçantë.
- Zonat mbishtresore vendosen mbi një apo disa zona bazë. Krahas kushteve të zonës bazë kushtet mbishtresore vendosin kushte apo masa plotësuese.
- Në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë.
- Zonat mbishtresore përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte dhe masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike ku përcaktohen:
 - masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
 - masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
 - masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj. të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
 - masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj.;

- përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet seizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, orteqeve, tërmetet, e të tjera, dhe
- standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për t'u zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

7.1 [ZMA] ZONË MBISHTRESORE - ZONË E MBROJTUR E AEROPORTIT

Kjo zonë është e planifikuar si zonë ekskluzive për transport ajror. Zona është me interes nacional dhe si e tillë i nënshtrohet edhe ligjeve respektive shtesë. Në të njejtën kohë zona do të ofrojë edhe hapësirë të kufizuar për banim të përhershëm. Zona përfshinë sipërfaqe prej 412 ha nga territori i komunës së Lipjanit.

Në këtë zonë është e paraqitur "Harta mbrojtëse" nënkupton hartën të definuar me ngjyra, e cila i përshkruan Zonat Mbrojtëse të Aerodromit bazuar në kufizimet e lartësisë së ndërtimeve në zonat e ndryshme përreth aerodromit.

Të gjitha aplikacionet për leje ndërtimi për secilin ndërtim që ndodhet brenda territorit të definuar të Zonës Mbrojtëse të aeroportit duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak nga Operatori i Aeroportit, sipas udhëzimeve nga Rregulloret mbi Zonën e Mbrojtur të Aeroportit. Për shfrytëzimet e lejuara dhe kushtet ndërtimore të vendbanimeve të cilat gjenden brenda zonë mbrojtëse referoju kapitullit XXX tek strukturat e ndërtuara.

Në zonën mbrojtëse të aeroportit gjenden vendbanimet. Në hartën mbrojtëse janë paraqitur 5 zona mbrojtëse në përputhje me Rregulloren Nr. 17/2017 dhe Aneksit 14 të Konventës së Çikagos për përcaktim të Sipërfaqeve për kufizimin e pengesave (SKP), të cilat përfshijnë një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve në komune në Lipjanit si:

TABELA 7 ZONAT MBOJTËSE TË AEROPORTIT DHE VENDBANIMET BRANDA TYRE

Paraqitja e ngjyrës në hartën mbrojtëse	Zonate mbrojtëse – shenjëzimi i zhvillimeve branda zoanës	Vendbanimet
	Të gjitha	Mirenë, Leletiq
	Mbi 10 m	Dobrajë e Vogël Dobrajë e Madhe
	Mbi 15 m	Llugë, Qylagë
	Mbi 30 m	Gllanicë, Puturoc, Vrellë e Goleshit, Medvec, Magurë
	Mbi 80 m	Rufci i vjetër, Rufci i ri, Ribar i Vogël, Kraishtë, Vërshet,

7.1.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Infrastruktura e transportit ajror: hapësira të shfrytëzuara për transportin ajror, si aeroportet dhe shërbime përkatëse;
- Banim i përhershëm: shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte, shtëpi dyshe, shtëpi në varg, dhe ndërtesa terracore.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha ndërtesat apo strukturat teknike që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: ndërtesat për banim të përhershëm; shfrytëzim dytësor: garazha, kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.

Shfrytëzimet e lejuara te veçanta:

- Prodhim i energjisë së ripërtitshme bazuar në burime diellore/erës. Zhvillimet rregullohen sipas udhëzimeve rregulluara sipas dispozitave të ligjeve përkatëse në fuqi.

Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

7.1.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Kushtet zhvillimore për objektet primare dhe mbështetëse për aeroport përcaktohen me rregullore të veçanta bazuar në ligje dhe udhëzime administrative respektive.

Treguesit bazë	Banim i përherëshëm	
Madhësia e parcelës	Shtëpi të vecanta	Min 400m ²
		Max 600m ²
	Shtëpi dyshe	Min 400m ²
		Max 700m ²
	Shtëpi në varg	Min 200m ²
		Max 250m ²
Balli i parcelës	Shtëpi të vecanta	Min 16m’
	Shtëpi dyshe	Min 20m’
	Shtëpi në varg	Min 8m’
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.50 Max 0.80	
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 35%	
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	Min 40%	
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	Max 30%	
Rrjetet e vijave		
Vija Ndërtimore (VN)	Min 7m	
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNT)	Min 7m	
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.5H e ndërtesës	
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.25H e ndërtesës	
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët fqinjë arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri	

7.2 [ZMIV] ZONA MBISHTRESORE: ZONË E INTERESIT TË VEÇANTË

Duhet theksuar se një pjesë e Zonës me interes të Veçantë (ZIV) të “SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË” i takon territorit të komunës së Gillogocit dhe si zonë do të vazhdojë të jetë e mbrojtur dhe të gjitha intervenimet do të jenë në harmoni me planin e lartpërmendur.

Shfrytëzimet e lejuara:

- ndërtimet apo zhvillimet industriale, si gjërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i pendëve, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite;
- ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- strukturat ose godinat më të larta se monumenti kulturor që duhet të mbrohet;
- ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, 'supermarket'-eve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër;
- tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike;
- transformimi i tokës bujqësore

KUSHTET ZHVILLIMORE:

Kushtet e përgjithshme duhet të jenë në përputhje me dispozitat që rrjedhin nga Plan i Hapesinor për ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”. Të gjitha komunat të cilave përfshihen në këtë zonë, janë të obliguara që planet e veta përkatëse ti harmonizojnë me rekomandimet dhe dispozitat që parashihen me këtë Plan.

Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike, si dhe atyre me destinime të tjera:

- Caktimi i sipërfaqeve publike dhe i atyre me destinime tjera duhet t'i plotësojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetesës dhe mosrrezikimit të shëndetit të popullatës, shfrytëzimit racional të territorit dhe të resurseve natyrore.
- Kryesisht pronësia e tokës e përcakton vendin e sipërfaqeve publike. Pra sipërfaqet publike parimisht janë në tokat që janë në pronësi publike, mirëpo nëse Qeveria vlerëson se është në interes kombëtar që disa toka në pronësi private t'i kthejë në sipërfaqe publike, ajo do ta bëjë këtë.
- Sipërfaqe publike do të jenë ato hapësira ku ndodhen shumica e ndërtesave që gjatë luftës janë përdorur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), ku ndodhen dhe ku do të ndërtohen objekte shkollore, infrastruktura rrugore (rrugët automobilistike, shtigjet e këmbësorëve dhe parkingjet), objekte dhe terrene të hapura për sport e rekreacion dhe hapësirat që janë sipërfaqe të lira, të gjelbëruara.
- Kur caktohen vendet e sipërfaqeve publike dhe të atyre me destinime tjera ku do të ketë ndërtime, përparësi kanë vendet ku ekziston infrastruktura e domosdoshme teknike si qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi. Nëse nuk ekziston infrastruktura, është e domosdoshme që para se një zonë të destinohet për ndërtim, të ndërtohet infrastruktura.
- Ndërtimi në sipërfaqet publike dhe në ato me destinime tjera duhet të bëhet sipas parametrave urbanistik, arkitektonik dhe teknik që caktohen me planet rregulluese të hollësishme dhe projektet arkitektonike të ndërtesave.
- Objektet e arsimit fillor duhet të vendosen brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre. Hapësirat ku janë të vendosura këto objekte duhet të rregullohen me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik. Në kuadër të oborrit shkollor duhet të sigurohet hapësirë e gjelbërt dhe terrene të hapura sportive.
- Si sipërfaqe të lira të gjelbëruara duhet të mbeten sipërfaqet e pyllëzuara, por edhe sipërfaqe të tjera nëse këtë e lejon plani hapësinor i ZIV dhe planet rregulluese të hollësishme të ZIV.
- Sipërfaqet publike dhe ato me destinime tjera rregullohen hollësisht me planet rregulluese të hollësishme.
- Sipërfaqet që destinohen për veprimtari tregëtare – furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre dhe pranë zonave ku ndodhen ndërtesat historike të shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës.

Kushtet për rregullimin e hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën dhe komunën:

- Objekte me rëndësi për Kosovën dhe komunën në ZIV „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” janë ndërtesat historike të shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës.
- Në hapësirën ku ndodhen këto objekte duhet të ketë qasje të mirë përmes rrugës automobilistike dhe asaj për këmbësorë dhe të sigurohet e tërë infrastruktura tjetër e nevojshme.
- Hapësira ku ndodhen këto objekte rregullohet më plane rregulluese të thollësishme
- Në këtë hapësirë nuk lejohet asnjë intervenim që nuk është në përputhje me këtë plan hapësinor dhe me plane rregulluese të thollësishme
- Në hapësirën apo zonën me vlera natyrore duhet të ketë qasje të mirë përmes shtigjeve për këmbësorë, kurse në hapësirën me vlerë historike ku ndodhen ndërtesat e shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës, duhet të sigurohet e tërë infrastruktura e nevojshme fizike dhe shërbimet që lidhen me të.
- Zonat dhe tërësitë me vlerë të veçantë duhet të mbrohen nga degradimi i mjedisit dhe dëmtimi fizik i objekteve që ndodhen atje.
- Hapësirat me vlera natyrore dhe historike rregullohen me planin hapësinor për ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe më hollësisht me plane rregulluese të thollësishme
- Në këto zona dhe tërësi nuk lejohet asnjë intervenim që nuk është në përputhje me këtë plan hapësinor dhe me plane rregulluese të thollësishme

Kushtet për vendosjen e objekteve:

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk mund të vendoset asnjë objekt në kundërshtim me planin hapësinor për këtë zonë
- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk mund të vendoset asnjë objekt që do të kishte si pasojë, në një apo në një formë tjetër, ndotjen apo degradimin e mjedisit
- Asnjë objekt nuk mund të vendoset në sipërfaqen e brezave mbrojtës të rrugëve automobilistike
- Përveç shtëpive familjare, objekteve ekonomike dhe bujqësore dhe infrastrukturave të tyre kur ato ndërtohen në fshat, Ministria është kompetente për dhënien e lejes së ndërtimit për objekte ndërtimore brenda zonës së interesit të vecantë.

Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës komunale:

- Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materiale tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen;
- Në vendet e duhura, si aty ku fillon territori i ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe përgjatë shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët
- Ndalohet çfardo ndërtimi në sipërfaqet e brezave mbrojtës të rrugëve ekzistuese automobilistike
- Përgjatë rrugëve automobilistike të zonës duhet të vendosen të gjitha shenjat e nevojshme të komunikacionit
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët automobilistike të zonës duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta lidhur me këtë që i ka nxjerrë ministria perkatese

Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

- Nuk lejohen ndërtimet, eksploatimi i pasurive dhe çdo veprimtari tjetër që do të dëmtonte zonën e mbrojtur ku ndodhet monumenti natyror Guri i Gradinës.
- Prerja e drunjeve dhe format tjera të shfrytëzimit të pyjeve, si të atyre në pronësi private poashtu edhe të atyre në pronësi shoqërore, mund të bëhen vetëm ashtu siq e thot Ligji Nr. 2003/3 për

Pyjet e Kosovës dhe Ligji Nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.

- Tërësinë historike në zonë e formojnë ndërtesat që janë shfrytëzuar nga UÇK gjatë luftës e që tani konsiderohen si ndërtesa historike. Ato duhet të riparohen dhe riparimi nënkupton kthyerjen e tyre në gjendjen e mëparshme që do të thotë ruajtjen e plotë të origjinalitetit të tyre arkitektonik.

Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” duhet të parandalohet ndikimi i dëmshëm në ajër, në krojet, përrockat ujore dhe në tokë, ndikim që do të mund të vinte nga ndonjë kapacitet ndotës industrial, djegja e gomave për shkrirjen e gëlqeres, hedhja e mbeturinave në rrjedhat ujore dhe në tokë, prerja ilegale e pyjeve apo cenimi i monumenteve natyrore përmes aktiviteteve të paplanifikuara dhe të jashtligjshme.
- Pengimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis bëhet duke futur në funksion instrumentet për mbrojtjen e mjedisit që janë të listuar në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit e që janë: - Infrastruktura ligjore; - Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit; - Instrumentet ekonomike; - Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis; - Instrumentet për monitorimin e mjedisit; - Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.
 - Infrastruktura ligjore: Përdorimi i këtij instrumenti nënkupton zbatimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit si: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ligji për Pyjet e Kosovës, Ligji për Mbeturinave dhe Ligji për Minierat dhe Mineralet.
 - Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit janë: Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, Plan i Kosovës për Veprim në Mjedis, Planet e Veprimeve Lokale në Mjedis dhe Programet Mjedisore. Këto plane duhet të zbatohen me përpikëri në mënyrë që të pengohet ndikimi i dëmshëm në mjedis.
 - Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis janë: Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM). VSM bëhet për planet dhe programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis, kurse VNM bëhet për projektet të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar e që mund të kenë ndikim të dëmshëm në mjedis. Është e domosdoshme të bëhet VNM për projekte të caktuara që i parashohin planet komunale. Nuk mund të fillojë zbatimi i projekteve të caktuara pa u bërë VNM.

Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Veprimtaria, aktivitetet apo projektet që parashihen me plan komunale dhe që do të zhvillohen në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk guxojnë të kenë ndikim negativ në gjendjen apo mirëqenjen sociale atje. Përkundrazi ato duhet të ndikojnë pozitivisht në rritjen e mirëqenjes sociale në zonë.
- Është e nevojshme të jetësohen të gjitha projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin social siq janë: ndërtimi i shkollës, i shtëpisë së shëndetit, i muzeut, i pushimores etj.
- Përparësi që të punësohen në vendet e reja të punës që do të hapen me zbatimin e planeve komunale në këtë zonë duhet të kenë banorët vendës.
- Në projektimin e objekteve që parashihen sipas planeve në ZIV „SHP. UÇK Kleçkë dhe Divjakë” duhet të aplikohen normat që ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta (rampat në objekte, parkingjet, vendkalimet, trotuare të projektuara në formën që lehtësojnë lëvizjen e lirshme të kësaj kategorie, hyrjet dhe qarkullimin e lehtë në lokale etj). Komunat nuk do të lëshojnë asnjë leje ndërtimi për objektet për të cilat nuk është marrë parasysh aplikimi i këtyre normave.

7.3 [ZMS] ZONA MBISHTRESORE SEIZMIKE

Gjatë projektimit dhe ndërtimit të strukturave me karakter publik (objekte te arsimit, shëndetësisë, administrative, kulturore, etj.), si dhe objekte shumë banesore te banimit tek zonat e banimit me densitet të mesëm dhe te larte (objektet shumëbanesore më të mëdha se P + 4), duhet te respektohen standardet nga udhëzuesi Eurokodin 8 (EN 1998, Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance). Kjo aplikohet për te gjitha zonat seizmike te identifikuar me shkalle te Rihterit 7 e me larte.

Rregullat e përcaktuara me HZK për vendosjen dhe ndërtimin e ndërtesave kanë marrë parasysh të gjithë faktorët që kanë efekt në zvogëlimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti i mundshëm si intensiteti i ndërtimit, numri i kateve, dendësia e banimit, rrjeti i sipërfaqeve të hapura publike, etj. Këto janë përcaktuar brenda kufijve optimalë / të lejueshëm, duke minimizuar kështu ndikimin nga kjo fatkeqësi e mundshme natyrore. Nga aspekti urbanistik, është bërë definimi i hapësirave të hapura të sigurta si sheshet, parqet, fushëljorat etj., të cilat në rast rreziku mund të shërbejnë si zona të sigurta për evakuim të popullsisë.

Kushtet zhvillimore

Rregullat themelore që duhen ndjekur janë si më poshtë:

- shpërndarja e harmonizuar hapësinore e funksioneve dhe shfrytëzimeve duke të siguruar hapësira të lira të mjaftueshme që përshkojnë strukturat urbane, dhe veçanërisht ti kushtohet kujdes gabariteve, etazhitetit, vendndodhjes dhe fundimit të ndërtesave;
- korridoret kryesore të infrastrukturës së shërbimeve publike duhet të drejtohen përgjatë rrugëve, nëpër hapësirat e gjelbërta dhe në distanca të përshtatshme nga ndërtesat;
- detyrimisht të zbatohen rregulloret duhet aplikuar Eurokodin 8 gjatë rekonstruimit ose ndërtimit të objekteve të reja.
- të hulumtohet gjendja e tokës ku do të ndërtohen ndërtesat

7.4 [ZMNV] ZONË MBISHTRESORE E NDIKUAR NGA VËRSHIMET

Mbrojtja nga vërshimet përfshinë aktivitetet dhe masat për shmangien apo zvogëlimin e pasojave që mund të kenë vërshimet për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik⁹. Gjithashtu duhet të ndërmerren masat dhe kushtet zhvillimore tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave dhe UA për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërrjedhave dhe Akumulacioneve si dhe Ligjin nr. 04/-L-027 -për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe aktet tjera nënligjore; dhe Ligjin nr. 04/L-147 -për ujërat e Kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore.

Kushtet zhvillimore

Për të parandaluar dhe minimizuar dëmet nga vërshimet, te gjitha zonat e identifikuar si zone vërshimesh është e domosdoshme të kryhen punimet agromelioruese, meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve, pastrimi dhe mirëmbajtja, hapja e kanaleve, zgjerimi i shtratit te lumenjve dhe përroskave, etj.

Zonat e mbrojtjes të burimeve të ujerave sipërfaqësore, rregullohen si në vijim:

⁹ Ligjin Nr. UA Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave

- Zona I: formohet në rrjedhën e epërme dhe shtrihet në një gjerësi ≥ 100 m;
- Zona II: formohet në të dyja anët në raport me rrjedhën e ujit shtrihet në një gjerësi ≥ 30 m;
- Zona III: formohet në rrjedhën e poshtme shtrihet në një gjerësi ≥ 20 m.
- Gjithashtu, çdo zhvillim duhet të jete në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave si dhe UA për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërrjedhave dhe Akumulacioneve.
- Gjatë ndërtimeve duhet të merren parasysh që ndërtesa duhet të jenë së paku 70cm mbi kuotën më të lartë mbidetare të vërshimeve që kanë ndodhur bazuar në hartën e rrezikshmërisë nga vërshimet. Shfrytëzimi i hapësirave të brendshme nën këtë nivel lejohet përderisa:
 - Janë të izoluar me materiale hidroizoluese të qëndrueshme
 - Të zbatohen masa inxhinierike shtesë, të përshkruara në mënyrë të detajuar në dokumentacionin teknik të lejes ndërtimore dhe të testuara ndërkombëtarisht

7.5 [ZMNL] ZONA MBISHTRESORE ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)

Te gjitha hapësirat industriale të kaluara dhe ekzistuese konsiderohen të jenë zona me ndotje të lartë (VSM e HZK-së). Mbrojtja nga ndotja e lartë që vjen nga Hot spotet përfshinë aktivitetet dhe masat për shmangien apo zvogëlimin e pasojave që mund të ketë për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin e që mund të jetë katastrofale.

KUSHTET ZHVILLIMORE:

- Ndalimi i deponimit të mbeturinave të rrezikshme pa u bërë trajtimi paraprak, me qëllim për të zvogëluar përqendrimin e komponentëve të dëmshme në mbeturina, zvogëlimin e veçorive të rrezikshme dhe zvogëlimin e sasisë dhe masës vëllimore të mbeturinave
- Ndalimi i hollimit të mbeturinave të rrezikshme, me qëllim të shkarkimit të tyre në mjedis, përveç në rastet kur lejohet nga MMPH
- Ndalimi i vendbanime në afërsi të deponive (deri 1000m) dhe izolimi i shtresës së epërme në mënyrë që të parandalohet shpërndarja e pluhurit
- Ndalimi depërtimi i të reshurave në deponi
- Izolimi nëntokësorë për të ndaluar rrjedhjen e materjeve drejt lumenjve.
- Izolimi me tampon mbrojtës nga gjelbërimi i lartë.

7.6 [ZMTK] ZONË MBISHTRESORE E MBROJTUR - TRASHËGIMI KULTURORE

Sipas PZHK-së është konstatuar se duhet të zhvillohen projekte që mundësojnë mbrojtjen e vlerave të TK-së nga dëmtimet e mëtutjeshme, por edhe të zhvillohen në bazë të potencialit që kanë këto vlera. Parashikimet janë që të gjitha objektet dhe vlerat të futen në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme ose përhershme në nivel komunal, të Kosovës dhe disa edhe ndërkombëtar.

Bazuar në listën e objekteve të përkohshme të MKRS-së, përpos objekteve të luajtshme të cilat nuk janë paraqitur në këtë dokument, në komunën e Lipjanit janë gjithsejtë 25 vlera të trashëgimisë kulturore si trashëgimi arkeologjike dhe trashëgimi arkitekturore.

Bazuar në Ligjin për trashëgimi kulturore, trashëgimia kulturore nën mbrojtjen e përkohshme, ka attribute të njëjta me trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme, andaj me HZK rregullat për zhvillim vlejné për të gjitha vlerat njësoj.

TABELA 8: LISTA E VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE SIPAS LISTËS SË PËRKOHSHE TË MKRS10

KATEGORIA : TRASHËGIMI ARKEOLOGJIK / NËNKATEGORIA: LOKALITET ARKEOLOGJIK/REZERVAT				
NR.	NR.UNIK	EMERTIMI	PERIUDHA	VENDI- KOMUNA
1.	691	Qyteza Parahistorike (Gadime)	Parahistori	Gadime e Eperme Lipjan
2.	3031	Lokaliteti Arkeologjik 'Ogragje'	Antikitet i Vone, Mesjete	Rubofc, Lipjan
3.	3032	Germadhat e Lokalitetit Arkeologjik Antik 'Stacio Herculana'	Romake	Gushterice e Larte dhe e ulet, Lipjan
4.	42	Qyteza ne Klecke	Antikitet i Vone	Klecke, Lipjan
5.	684	Qyteza "Kodra e Qytetit"	Parahistori, Mesjete	Bajice, Lipjan
6.	3697	Gjurmit e Qytetit te Janjeves	Antikitet i Vone	Janjeve, Lipjan
7.	3708	Lokalitet arkeologjik i kohës romake ne Torine	Romake	Torine, Lipjan
8.	3712	Lokalitet arkeologjik ne Babush te Muhaxhereve	Romake	Babush te Muhaxhereve
9.	2905	Gërmadhat e kishës se Shen Gjonit ne Sllovi	Mesjete	Sllovije, Lipjan
10.	2906	Gërmadhat e kishës se "Shen Nikoolles"	Mesjete	Sllovije, Lipjan
11.	2907	Germadhat e Manastirit mesjetare Shen Gjergji ne Sllovi	Mesjete	Sllovije, Lipjan
12.	2912	Kishe varrezore e fshatit ne Toplican	Mesjete	Toplican, Lipjan
KATEGORIA : TRASHËGIMI ARKITEKTURORE / NËNKATEGORIA: MONUMENT/ANSAMBËL				
NR.	NR.UNIK	EMERTIMI	PERIUDHA	VENDI- KOMUNA
13.	2903	Kisha e Shpalljes se Virgjërshës, Lipjan	Shek. XIV	Lipjan
14.	2904	Bunkeri i LNÇ - së - Vrellë	Shek. XX	Vrellë – Lipjan
15.	2911	Tyrbja e Isak Babës	Shek. XVIII	Teqe - - Lipjan
16.	2913	Shkolla fillore në gjuhën Sërbe - 1882	Shek. XIX	Gushtericë e Epërme-Graçanicë
17.	2760	Xhamia në Shalë (Sedllarë)	Shek. XVIII	Shalë (Sedllarë)
18.	36	Shtëpia Muze e At Shtjefën Gjeçovit	Shek. XX	Janjevë
19.	43	Kulla e Pashkë Karadakut - Janjevë		Janjevë – Lipjan
20.	41	Shtëpi me ballkon –Glasnoviq Josipa Maria.		Janjevë - Lipjan
21.	44	Xhamia e Janjevës	Shek. XVII	Janjevë – Lipjan
22.	4293	Bunari i familjes Olluri		Krojmir, Lipjan
23.	76	Xhamia ne fshatin Llugaxhi		Llugagji- Lipjan
24.	4655	Shtëpi banimi, ish-Selia e shtabit te brigades 121- "Komandant Kumanova"		Krojmir, Lipjan
25.	4685	Shkolla shqipe Banullë		Banullë-Lipjan

¹⁰ https://ëëë.mkrsk.org/repository/docs/Lista_e_Trashegimise_Kulturore_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2018.pdf

7.6.1 TRASHËGIMI ARKEOLOGJIKE

Sipas Ligjit për trashëgimi kulturore, radiusi (kufiri) i zonës së mbrojtur është 100 metra nga perimetri i vendit të trashëgimisë së mbrojtur arkeologjike. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose të ngushtohet dhe kjo përcaktohet në një plan të Institucionit kompetent.

Shfrytëzimet e lejuara

- Punime mirëmbajtjeje, punime me karakter restaurues e konservues, në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse të këtyre monumenteve të autorizuar nga organi kompetent;

Shfrytëzimet dytësore

- Instalime dhe strukturën që janë në funksion të drejtpërdrejtë të monumentit dhe të cilat nuk e dëmtojnë vlerën e objektit të trashëgimisë kulturore;
- Projekte të autorizuar nga organi kompetent për zbulimin e vlerave arkeologjike në territorin e tyre;
- Struktura të cilat plotësojnë lokacionin e monumentit siç mund të jenë kiosqet, shtandet dhe të tjerat;

Shfrytëzimet e veçanta

- Punimi/shfrytëzimi i tokës për aktivitete bujqësore e cilat gjenden në zonën mbrojtëse të monumentit, vetëm me lejen e organit kompetent;
- Aktivitete të ndryshme promovuese e turistike;
- Organizime, festivale dhe evente të ndryshëm me qëllim të promovimit të monumentit;
- Vendosa e tendave, karrigeve, tavolinave, binave gjatë organizimit të ngjarjeve të cilat kanë për qëllim promovimin e këtyre monumenteve;

Shfrytëzime e ndaluara

- Të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të lejuara janë të ndaluara.

7.6.2 TRASHËGIMIA ARKITEKTURORE

Monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet me dokumentin e hartës zonale të komunës (shih hartën ZONAT TË MBROJTURA TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE, DHE ZONAT TURISTIKE). Objektet e trashëgimisë kulturore janë të shtrira në të gjitha nënzonat e banimit.

7.6.3 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Aktivitete për konservimin dhe mbrojtjen e këtyre vlerave me lejen e organit kompetent;
- Revitalizimi në funksion të zhvillimit turistik me lejen e organit kompetent;
- Çdo punë për modifikim ose demolim i monumentit arkitektural ose ndonjë veprim konservues ose restaurues që mund të ndikojë në vlerat atribuese të monumentit me pëlqimin nga organi kompetent;
- Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në asamble ose zona konservuese arkitekturale me pëlqimin nga organi kompetent;

- Riparimi urgjent ose emergjent i monumentit ose ndërtesave brenda asambleve që janë në një gjendje të keqe të riparimit ose janë në rrezik të dëmtimit sipas procedurave të parapara ligjore.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore:

- Objekte apo struktura përcjellëse që e plotësojnë funksionin e monumentit gjithnjë në harmoni me arkitekturën origjinale dhe me leje nga organi kompetent;
- Kiosqe për informim apo tabela informuese që ofrojnë të dhëna të rëndësishme për monumentin;
- Hidranti l ujit për mbrojtje nga zjarri;
- Rugë për qasje në kuadër të asamblesë së monumenteve e rëndësishme për funksionimin e zonës dhe me leje paraprake nga organi kompetent;
- Shërbime publike të furnizimit me ujë, energji elektrike, kanalizimi të nevojshme për funksionimin e monumentit me leje nga organi kompetent.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

- Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e asambleve ose brenda Hapësirave konservuese arkitekturale me leje të shkruar nga organi kompetent;
- Përdorimi me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor i monumentit (zhvillimi i aktiviteteve turistike me qëllim promovimin e monumentit me autorizim nga organi kompetent);
- Ndërhyrja në tokë brenda zonës së mbrojtur për veprimtaritë bujqësore me leje nga organi kompetent;
- Ndërtimi i strukturave për shitje suveniresh me leje nga organi kompetent;
- Infrastrukturë rrugore lokale dhe shërbimeve publike të nevojshme për funksionimin e zonës me lejen e organit kompetent.

Shfrytëzimet e përkohshme

- Shërbim tregtar me pakicë (pikat e shitjes së prodhimeve për nevoja të zhvillimit të turizmit-suveenire, produkte artizanale, produkte të vendit);
- Tenda për panaire apo manifestime të caktuara për promovimin e monumenteve arkitekturore, etnografike, ikonografike etj;
- Vendosja e karrigeve dhe tavolinave për nevoja të bizneseve të vogla në rastet e manifestimeve të ndryshme promovuese të trashëgimisë.

Shfrytëzimet e ndaluara

- Në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë arkitekturore ndalohet:
- ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje;
- ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale;
- zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë;
- instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital;
- çdo veprimtari e cila shkakton dëmtim të ndonjë vlere të trashëgimisë arkitekturore pa leje nga organi kompetent;
- Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjesshme ose complete e ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme;
- vendosja e kontejnerëve dhe shportave tjera për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit;
- vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve që pengojnë vizurat në monument;

Kushtet e veçanta përfshijnë:

- Në rastet e zonave të vecantë të mbrojtjes kushtet zhvillimore përfshijnë dispozitat e Ligjit për zona të veçanta të mbrojtura:
 - Aktivitetet e Kufizuara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura
 - Çdo aktivitet i ri nga lista e mëposhtme e aktiviteteve mund të kufizohet nëse e kërkojnë rrethanat. Para se të kryhen aktivitete të tilla në fushat e mëposhtme, komuna përkatëse do të kërkojë marrëveshjen e Kishës Ortodokse Serbe. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, palët do t'ia referojnë çështjen KZM-së për shqyrtim, në pajtueshmëri me pikën c të nenin 4 të këtij ligji:
 - ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri/ kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet; ndërtimi i rrugëve; ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hotele-ve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale;
 - tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; dhe
 - urbanizimi i tokës bujqësore.
- Peisazhi rreth monumenteve të trashëgimisë kulturore duhet të ketë trajtim të vecante, duke e ruajtur nga dëmtimet edhe në rastet e intervenimit në ato objekte;
- Ashtu sikur objektet dhe elementet tjera karakteristike për monument, gjelbërimi duhet të trajtohet si vlerë e shtuar e monumentit, duke marrë parasysh që ato kontribuojnë drejtpërdrejtë në të;
- Kërkesat për efikasitet të energjisë: Ndërmarrja e masave për ngritjen e efikasitetit të energjisë në monumentet arkitekturore bëhet në përputhje me ligjet respektive apo me leje nga organi përgjegjës;
- Formësimi arkitektonik dhe estetik: Do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për këtë zonë:
 - Renovimi, rikonstruimi dhe revitalizimi i monumenteve duhet të përkitazi me standardet për intervenim në këto lloj objekte, duke iu përshtatë formës, materialit dhe të gjitha rregullave tjera.
 - Strukturat dytësore gjithashtu duhet të i përshtaten veçorive të monumentit dhe të bëhen në pajtueshmëri me standardet për intervenim në këto objekte;
- Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: Do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet specifike përfshijnë:
 - Qarkullimi i makinerisë më të rëndë se 3 ton, është i ndaluar në afërsi të lokaliteteve arkeologjike; kjo nuk aplikohet në raste të fatkeqësive natyrore apo të shkaktuar nga faktori njeri;
 - Implementimi i masave për uljet e shpejtësisë së trafikut në rrugët të cilat kalojnë në afërsi të monumenteve, siç janë: policët e shtrirë, rampa të ngritura, elemente peizazhore si drunjë, shkurre etj;
 - Të sigurohet qasja në monumente të trashëgimisë për persona me nevojë të veçanta;
- Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta:
 - Parkimi i veturave dhe automjeteve tjera duhet të bëhet vetëm në hapësira të dedikuara për parking, dhe të mos pengojnë pamje dhe qasjen te monumenti.

Kushte shtesë për qasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të krijimit të një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Gjerësia e hyrjes private në parcelë e cila nuk ka qasje direkte nga rruga publike nuk mund të jetë më e vogël se 2,5m;
- Shfrytëzimet apo strukturat dytësore, ato të lejuara të veçanta apo me shfrytëzim të përkohshëm nuk duhet të cenojnë qasjen në monument apo në parcelat kadastrale fqinje.

7.7 [ZMTN] ZONË MBISHTRESORE - ZONË E MBROJTUR: TRASHËGIMI NATYRORE

7.7.1 ZONAT NATYRORE ME VLERA TË MBROJTURA TË NATYRËS

Siaps PZHK-së së Lipjanit, komuna e Lipjanit posedon në tërësi 3 vlera të trashëgimisë natyrore dhe ato janë:

ZONAT E MBROJTURA NË LIPJAN SIPAS KATEGORIVE					
	EMËRTIMI I ZONËS	SIPËRFAQJA NË HA	VITI I MBROJTJES	KATEGORIA IUCN	PËRSHKRIMI ZONËS
1.	Shpella e Gadimes	55,00	1969	III	Gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore, është ndër shpellat më të bukura në Kosovë, Ballkan dhe më gjerë me rendësi shkencore, edukative, arsimore dhe turistike .
2.	Parku i Blinajës	5500 ha	1955		Territori i Blinajës shtrihet 15 km në perëndim të qytetit të Lipjanit. Sipërfaqja e Blinajës shtrihet në territorin e tri komunave: Lypjan, Shtime dhe Drenas. Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m. Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.
3.	Zonë e veçantë e mbrojtur e Zogjve	109.5	2014		Zona me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peisazhore

MONUMENT I NATYRËS – SHPELLA E GADIMËS

Monumenti i natyrës: Shpella e Gadimës gjendet në nënzonën e banimit: sipërfaqe rurale me intenzitet të ulët.

Ka zonën mborjtëse buferike, 500 m nga sipërfaqja e e shpellës. Shfrytëzimet aplikohen në gjithë zonën buferike të saj.

Shfrytëzimet e lejuara:

- Kryerja e aktiviteteve ekoturistike dhe edukativo arsimore të cilat nuk i rrezikojnë vlerat e natyrës së shpellës duke patur në konsideratë nevojat e popullatës lokale;
- Hulumtimet shkencore dhe profesionale për aktivitetet e shpelle;

Shfrytëzimet e lejuara dytësore:

- Infrastruktura e shpellës: të gjitha objektet që shërbejnë për ruajtjen, respektivisht shfrytëzimin e shpellës;
- Lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të domosdoshme të tipit montazhë të cilat shërbejnë vetëm për qëllime të vizitave dhe gjinden në afërsi të shpellës;
- Lejohet rregullimi i hapësirës para shpellës si vendosja e ulëseve, objekteve përcjellëse/mbuloja, shportave për mbeturina si dhe tabela informuese;
- Objektet duhet të jenë të ndërtuara nga guri dhe/ose druri;
- Të gjitha punimet në hapësirën para shpellës duhet të bëhet me dorë dhe vegla dore;

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- Organizimi i vizitave, edukim kulturor, ekoturizëm dhe hulumtime shkencore
- Numri maksimal i vizitorëve në shpellë nuk guxon të tejkalojë më shumë se 50 vizitorë dhe vizita nuk mund të zgjasë më shumë se 30 min;

Shfrytëzimet e ndaluara:

- Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.¹¹
- Përveç ndalesave të parapara me ligjin e natyrës ndalohen edhe:
 - Çdo ndryshim i gjendjes në shpellë si dëmtimi, thyerja dhe shkatërrim i pasurisë së shpellës;
 - Hyrja në shpellë pa përcjellje të ciceronit dhe lëvizja jashtë shtigjeve të rregulluara;
 - Përdorimi i pajisjeve audio që arrinë mbi 45 db;

“BLINAJA” - REZERVAT STRIKT I NATYRËS

Rezervati strikt i natyrës është zonë e tokës dhe/ose ujit e pandryshuar ose shumë pak e ndryshuar dhe është i dedikuar ekskluzivisht për ruajtjen e natyrës së paprekur, hulumtime shkencore të lamisë biologjike, përcjelljen e gjendjes së natyrës si dhe arsimimit nëse nuk rrezikojnë zhvillimin e lirshëm të proceseve natyrore.

Shfrytëzimet e lejuara:

- hulumtime shkencore të lamisë biologjike

Shfrytëzimet e lejuara dytësore:

- Vizita arsimore dhe edukative

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- Organizimi i vizitave, edukim kulturor, ekoturizëm dhe hulumtime shkencore
- Numri maksimal i vizitorëve në shpellë nuk guxon të tejkalojë më shumë se 50 vizitorë dhe vizita nuk mund të zgjasë më shumë se 30 min;

Shfrytëzimet e ndaluara:

- Në rezervatin strikt ndalohet kryerja e veprimtarive ekonomike dhe veprimtarive të tjera.
- Në rezervatin strikt, ndalohet:
- të kryhen aktivitete nënujore pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës;
- të ankerohen dhe/ose lidhen lundrat jashtë vendit të caktuar me plan hapësinor;

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

- peshkimi rekreativ pa leje ose në kundërshtim me kushtet e dhëna në leje;
- dëmtimi dhe/ose shkatërrimi i shenjës dhe/ose tabelës informuese;
- ndezja e zjarrit jashtë vendbanimeve dhe/ose vendeve që për këtë qëllim janë të shënuara dhe të caktuara;
- xhirimi ose fotografimi për qëllime komerciale pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës;
- fluturimi me fluturake ultra të lehtë pa lejen e Ministrisë gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës;
- vendosja e pllakave informative, panove reklamuese ose tjera pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës;
- vizita dhe/ose shikimi pa biletë kur ajo është e detyruar;
- larja jashtë vendeve të caktuara nga drejtoria e cila administron me zonën.

8 INFRASTRUKTURA RRUGORE

Infrastruktura rrugore përfshinë sipërfaqe prej 342 ha nga territori i komunës së Lipjanit.

8.1 RRUGËT PUBLIKE


Duke u bazuar ne UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, rrjeti i infrastrukturës rrugore, sipas përgjegjësiwe për mirëmbajtje dhe ndërtim, ndahet në rrjet kombëtar dhe rrjet lokal te infrastrukturës rrugore.

8.1.1 RRJET KOMBËTAR I INFRASTRUKTURËS RRUGORE


Përgjegjës i planifikimit, realizimit dhe mirëmbajtjes i këtij rrjeti është niveli qendror i qeverisjes dhe karakterizohet me tutje me:

- autoudhat: rrugët publike posaçërisht të ndërtuara dhe të destinuara vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të korsive me gjerësi së paku 3.50 m, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një korsi për ndalje emergjente në të dy anët e autoudhës, me gjerësi së paku 2.50 m;
- rrugët nacionale: rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e dy e më tepër qyteteve dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;
- rrugët rajonale: rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e qendrave me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve;
- rrugë lidhëse: rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e vendbanimeve me stacionet dhe terminalët hekurudhore, terminalët ajrore, parqet nacionale, dhe përmbajtje tjera të veçanta.

HARTA 15: RRJETI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE



HARTA 16: RRJETI I TRANSPORTIT PUBLIK



8.1.2 RRJETI LOKAL I INFRASTRUKTURËS RRUGORE

Nen menaxhim te plote nga Komuna e Lipjanit janë rrugët lokale te cilat përkufizohen si rrugë që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat; rrugët brenda vendbanimeve rurale; si dhe rrugët brenda vendbanimit urban (Qytetit Lipjan). Më tutje, rrjeti Lokal i infrastrukturës Rrugore në Komunën e Lipjanit është kategorizuar dhe paraqitet më poshtë, si dhe komplet rrjeti rrugor i kategorizuar është paraqitur në Hartën 11. Çdo rrugë e re (e cila nuk është paraqitur në këtë fazë të planifikimit), që zakonisht mund të propozohet me rregullim të blloqeve (si p.sh. me revitalizimin e blloqeve të banimit, zonës industriale, projekte regjenerimi, etj.) në tërë territorin e komunës, obligohet të kategorizohet duke respektuar njërin nga profilet e paraqitura më poshtë, në harmoni me kushtet në terren dhe hapësira që shërbejnë.

TABELA 9 KATEGORIZIMI DHE LLOJET E RRUGËVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

MODELE TË REKOMENDUARA PËR LLOJET E RUGËVE NE RRETHONEN E URBAN				
Rrjeti i rrugëve brenda kufirit urban	Paraqitja ne hartë	Lloji i rrugës	Kategoria	Profili
		Rrugë transite urbane, profil 18.5 metra	Transit - urban	18.5 m
		Rrugë Urbane	1	16.6 m
		Rrugë Urbane	2	13 m
		Rrugë Urbane	3	11 m
		Rrugë Urbane	4	11 m
		Rrugë Urbane	5.1	6 m
		Rrugë urbane	5.2	3.5 m
Rrjeti i rrugëve		Rrugë transite nëpërmjet vendbanimeve-fshatrave, profil 9.5 metra	Transit – ndër-rurual	9.5 m

		Rruge ne vendbanime rurale (Kategoria 1), profil 9.5 metra	1	9.5 m
		Kategoria 2.1: profil 7.5 metra	2.1	7.5 m
		Kategoria 2.2: profil 9 metra	2.2	9 m
		Rruge ne vendbanime rurale	3	6.5 metra

Përveç rrugëve të kategorizuara në Komunën e Lipjanit paraqiten edhe Rruge të Pakategorizuara. Zakonisht këto nuk janë rrugë publike, por shfrytëzohen për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeneve akumuluese, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme. Këto rruge nuk mirëmbahen nga Komuna e Lipjanit, por nuk është e limituar mundësia që ne të ardhmen të ri-kategorizohen si pjesë e rrjetit lokal të infrastrukturës rrugore dhe të marrin trajtimin dhe profilin përkatës. Më tutje, komplet rrjeti i infrastrukturës rrugore (rrjeti kombëtar dhe rrjeti lokal i rrugëve) duhet të plotësojë normat e planifikimit në vijim:

Për shpejtësi të lejuar për qarkullim:

≤ 40 km/h, gjerësia e korsisë është: 2.75 m

≤ 60 km/h, gjerësia e korsisë është: 3.00 m

≤ 80 km/h, gjerësia e korsisë është: 3.25 m

≥ 80-100 km/h, gjerësia e korsisë: 3.50 m

≥ 100 km/h, gjerësia e korsisë është: 3.75 m


Për ngarkesë të lejuar boshtore:

≥ 11.50 t në sistem kombëtar


≥ 6.00 t në sistem lokal

Përbërja e infrastrukturës rrugore duke përfshi të gjitha elementet (brezi i gjelbërt, numri korsive, dimensionet, brezi mbrojtës rrugor, vend parkimet në rruge, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, etj.) për të gjitha profilet e rrugëve janë paraqitur në grafikët e profileve më poshtë, përderisa profilet të rrugëve Rrugë Urbane (Kategoria 5) dhe Rruge në vendbanime rurale (Kategoria 2) i kanë dy opsione të realizimit, varësisht nga kërkesat në teren. Gjithashtu, profilet e rrugëve duhet të i respektojnë udhëzimet nga UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.


ILUSTRIMI 10: RRUGË TRANSITE URBANE (PROFIL 18.5m)




ILUSTRIMI 11: RRUGË URBANE (KATEGORIA 1, PROFIL 16.6m)




ILUSTRIMI 12: RRUGË URBANE (KATEGORIA 2, PROFIL 13m)




ILUSTRIMI 13: RRUGË URBANE (KATEGORIA 3, PROFIL 11m)




ILUSTRIMI 14: RRUGË URBANE (KATEGORIA 4, PROFIL 11m)




ILUSTRIMI 15: RRUGË URBANE (KATEGORIA 5 / OPSIONI 1, PROFIL 6m)




ILUSTRIMI 16: RRUGË URBANE (KATEGORIA 5 / OPSIONI 2, PROFIL 3.5m)




ILUSTRIMI 17: RRUGË TRANZITE NDËRMJET VENBANIMEVE RURALE (PROFIL 9.5m)




ILUSTRIMI 18: RRUGË NË VENDBANIME RURALE
(KATEGORIA 1, PROFIL 9.5m)




ILUSTRIMI 19: RRUGË NË VENDBANIME RURALE
(KATEGORIA 2 / OPSIONI 1, PROFIL 7.5m)



ILUSTRIMI 20: RRUGË NË VENDBANIME RURALE
(KATEGORIA 2 / OPSIONI 2, PROFIL 9m)



ILUSTRIMI 21: RRUGË NË VENDBANIME RURALE
(KATEGORIA 3, PROFIL 6.5m)



8.1.3 BREZI MBROJTËS RRUGOR

Brezi mbrojtës rrugor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e rrugës, distanca e të cilit kalkulohet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës rrugor, dhe shërben përveç për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut që realizohet nëpër të, gjithashtu edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes së zhvillimit në të.

- Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël se:
 - 100 m nga autoudhat;
 - 60 m nga rrugët nacionale;
 - 40 m nga rrugët rajonale; dhe
 - 30 m nga rrugët lokale.

- Brezi mbrojtës rrugor ndalon ndërtimin e ndërtesave të banimit, administrative, hapjen e puseve të ujit dhe hapjen e gropave septike, ngritjen e instalimeve të transmetuesve elektrik dhe të ngjashme, në distancë më të vogël se:
 - 40 m nga autoudhat;
 - 20 m nga rrugët nacionale; dhe
 - 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale.


Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.

8.2 RRJETI HEKURUDHOR

Hekurudha kryesore Mitrovicë/Fushë Kosovë dhe Ferizaj/Shkup kalon në mes të Lipjanit me stacionin e pasagjerëve dhe trafikut të mallrave, me një gjatësi prej 8.9km. UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor përcaktojnë kërkesat për planifikim të infrastrukturës hekurudhore, ndërsa në respekt të organizimit të hapësirës paraqiten kërkesat teknike në vijim:

- Ruajtja e brezit mbrojtës të vijës hekurudhore: për shenja dhe billborde të ndryshme deri në 7 metra
- Ndalohet ndërtimi i objekteve të banimit dhe i bizneseve, gropave septike, gjurmimi i puseve, rezervuareve, ndërtimi i linjave të gjata elektrike etj., në distance minimum bufer 25m nga binari i fundit anësorë
- Ndalohet ndërtimi i objekteve industriale, në distance (bufer) 50 metra nga binari i fundit anësor
- Gjerësia e binareve është 1435mm, me atë që nuk mund të jetë më e vogël se 1430 mm dhe as më e madhe se 1470mm, duke përfshirë zgjerimin e binareve në një kurbë
- Pjerrësia maksimale e niveletës/shtrirjes vertikale në hekurudhë të hapur është jo më shumë se 25%
- Pjerrësia maksimale e niveletës/shtrirjes vertikale në stacionin hekurudhor është: për stacion të trenit në drejtim deri në 1 %, ndërsa për stacion të trenit në kurbë deri në 2.5 %, në varësi të rrezes së lakimit
- Distancat ndërmjet hekurudhave në stacionin hekurudhor duhet të jenë të tilla që ndërmjet profileve të lira të këtyre hekurudhave të ketë hapësirë të nevojshme për lëvizje të sigurt të udhëtarëve dhe personave të tjerë dhe për vendosje të ndërtesat ndihmëse, pajisjeve mbështetëse dhe shtyllave sinjalizuese, të rrjetit elektrik, ndriçimit, etj.
- Distancat ndërmjet hekurudhave në stacion hekurudhor duhet të jenë të paktën 4.75 m, ndërsa distancat e hekurudhave ndërmjet të cilave bëhet ngritja e platformave me lartësi 0.55 m, mbi skajin e sipërm të hekurudhës është të paktën 6m.
- Distancat e hekurudhave në linjë të hapur tek binaret e dyfishtë dhe linjat paralele është të paktën 4m
- Pesha e lejuar në linjat primare është të paktën 22.5 t në bosht dhe 8.0 t për metër gjatësi, ndërsa në linjat sekondare dhe terciare 18.0 t në bosht dhe 6.4 t për metër gjatësi.

ILUSTRIMI 22: BREZI MBROJTËS DHE RREGULLUES I HEKURUDHAVE



Brezi mbrojtës dhe rregullues hekurudhor përfshin edhe hapësirën tokësore të vendeve zyrtare (stacioneve, ndalesave, kryqëzimeve, nivelatave, etj.) që përfshin gjithçka që është teknike-ndërtesat teknologjike, instalimet dhe qasjet deri në rrugën publike më të afërt në rast të zjarrit.

- Brezi mbrojtës hekurudhor përfshin tokën nën hekurudhë dhe hapësirën ajrore në një lartësi prej 14m
- Brezi mbrojtës hekurudhor i përgjithshëm është me gjerësi 8m
- Brezi mbrojtës hekurudhor në hapësira të populluara është me gjerësi 6m;
- Brezi rregullues hekurudhor ka gjerësi prej 25m. Në këtë brez lejohet vetëm mirëmbajtja dhe zhvillimi teknologjik të kapaciteteve të infrastrukturës.
- Brezi rregullues hekurudhor ka gjerësi prej 100m. Në këtë brez ndalohet ndërtimi i ndërtesave të tilla si: miniera, gurë-thyes që aplikon materiale eksplozive, ndërtesa industriale- kimike dhe të produkteve eksplozive, fabrika dhe ndërtesa tjera të ngjashme, në një gjerësi prej 50m.

8.3 TRANSPORTI AJROR

Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit. Për rritje të hapësirës së aeroportit duhet të respektohen parimet e mëposhtme:

- Përzgjedhja e shtrirjes varet nga kushtet topografike, gjeologjike dhe meteorologjike si dhe pozita në raport me hapësirat e ndërtuara përreth
- Hapësire e mjaftueshme tokësore duhet të jetë në dispozicion për:
 - rrugën e ngritjes/ aterrimin (në rastin e aeroporteve)
 - platformat (në rastin e heliopoarteve)
 - ndërtesat e terminaleve (të udhëtareve dhe të mallrave) dhe të mirëmbajtjes, depozitimit të karburanteve

Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” e ka të përcaktuar Zonën Mbrojtëse përreth, të paraqitur në Hartën 10. Të gjitha aplikacionet për leje ndërtimi për secilin ndërtim që ndodhet brenda territorit të definuar të Zonës Mbrojtëse të aerodromit, të cilat i adresohen Ministrisë përkatëse dhe/apo

Komunës/ave duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak për përmbushje të dispozitave nga Rregullores (Nr. 09/2018) mbi zonat mbrojtëse të aerodromit. Kërkesat te mëtutjeshme teknike dhe normat e planifikimit përcaktohen përmes rregulloreve tjera të veçanta.

8.4 TRANSPORTI PUBLIK

PZHK për komunën e Lipjanit, gjegjësisht ne qytet, inkurajon krijimi i rrjetit te transportit urban. Lloji, lokacionet dhe kushtet për pike-ndalesat duhet te përcaktohen me rregullore te veçantë. Momentalisht shërbime të transportit publik kanë të gjitha vendbanimet e mëdha dhe fushore, ndërsa vendbanimet e largëta kodrinoro-malore të tipit të shpërndarë dhe me numër të vogël të banorëve nuk kanë shërbime të transportit publik. Këto vndbamie janë: Kleçka, Divjaka, Vrella, Plitkoviqi, Tërbovci, Brusi, Kosnica, Vogoçica dhe Shishari. Transporti publik ndërmjet qytetit dhe vendbanimeve e përmendura duhet te zgjerohet dhe ti shërbej te. Lokacionet për pike-ndalesat e autobusëve janë paraqitur ne Hartën 10.


8.5 VEND PARKIMET PUBLIKE

PZHK në fuqi nuk ka rekomanduar hapësirë të vecantë për vendparkime publike. Vendparkimet publike janë të vendosura përgjatë rrugëve në qendrën e qytetit. Komuna duhet të respektoj normat teknike gjatë përcaktimit të vend parkimeve publike si në vijim.

Vend-parkimi për automjete është hapësire e projektuar, e shënuar dhe teknikisht e pajisur për të akomoduar dhe lënë një automjet. Vend-parkimet mund të jenë të akomoduar në vend-parkime të rregulluara, në rrugë dhe në garazhe. Llojet themelore të parkimit janë:

- Vend-parkim rrugor, nënkupton vend-parkimin në rrugë; dhe mund të jetë vend-parkim formë gjatësore, të pjerrët dhe tërthore
- Vend-parkim jashtë-rrugor publik, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor; por të qasshëm si edhe rrugët publike
- Vend-parkim jashtë-rrugor privat, nënkupton vend-parkimin si pjesë përbërëse e një ndërtese, të një qendre biznesi ose komerciale;

ILUSTRIMI 23: LLOJET E VEND-PARKIMEVE PËR AUTOMJETE



- Vend-parkim jashtë-rrugor privat për banor, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor të ndërlidhur me ndërtesat e banimit individual dhe në bashkëpronësi
- Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja/shfrytëzimi i tokës duhet te respektojë perimetrat e përcaktuar nga UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor (faqe 95).

9 INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Infrastruktura publike dhe sociale përfshinë 293 ha të territorit të komunës së Lipjanit.

Kaptina në vijim paraqet kushtet zhvillimore për objektet dhe hapësirat publike dhe sociale. Si të tilla, këto objekte dhe hapësira publike konsiderohen me pak problematike në aspekt të kontrollit të zhvillimit në raport me investimet e sektorit privat. Kaptina në vijim përmban kushte zhvillimore për të gjitha llojet e ndërtesave që mund të ndërtohen. Lartësia e ndërtesave dhe largësia nga kufiri i parcelës janë kushte zhvillimore të cilat janë të aplikueshme për të gjitha llojet e ndërtimeve në këtë kaptinë.

- Lartësia e ndërtesave


Lartësia e ndërtesave të të gjitha institucioneve publike dhe sociale përcaktohet në mënyrë të veçantë për çdo ndërtesë. Lartësia e ndërtesave varet nga kapaciteti i institucionit bazuar në metër katrorë. Metrat katrorë caktohen në varësi nga numri i banorëve që janë në rrezen e shërbimit, dhe madhësisë së parcelës të alokuar për ndërtim.

- Largësia nga kufiri i parcelës

Largësia e çdo ndërtese të të gjitha institucioneve publike dhe sociale nga kufijtë anësorë të parcelës është min 1H e lartësisë së ndërtesës.

Në vijim janë të paraqitura kushtet zhvillimore specifike për çdo kategori të ndërtesave.

HARTA 17: INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE




9.1 PARQET PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E HAPURA

Parqet publike dhe hapësirat publike në komunën e Lipjanit do të ndërtohen duke u bazuar në numrin e banorëve që i shërbejnë.

Madhësia minimale e parcelës për parqe publike dhe hapësira të hapura varet nga numri i banorëve dhe lloji i vendbanimit të cilit ju shërbejnë:

- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banorë;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banorë;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banorë;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banorë.

HARTA 18: SHERBIMET KULTURORE, ARGËTUESE DHE REKREATIVE




9.1.1 SHTRATI I LUMIT

Brenda kufijëve të zonës urbane, shtrati i lumit identifikohet me shëtitoren e sajë. Komuna do të ndërtoj shtigjet të ecjes dhe biçikletave përreth Lumit Sitnica nga rruga regjionale Ibrahim Rugova deri të rruga Muzaqetë Begolli. Rregullimi i shtigjeve do të bëhet sipas profilit të detajuar në Ilustrimin 23, në vijim.


9.1.2 RRUGE PËR KËMBËSOR DHE ÇIKLISTË

Rrugët për këmbësorë, si ajo e paraqitur në Hartën e Infrastrukturës Rrugore, në pjesën jugore të qytetit, si dhe rrugët tjera për këmbësorë që do të paraqiten në të ardhmen duhet ti përmbajnë elementet nga ilustrimi 24, i paraqitur në vijim.

ILUSTRIMI 24: SHTRATI I LUMIT



ILUSTRIMI 25: RRUGË PËR KËMBËSOR DHE ÇIKLISTË



9.2 FUSHAT SPORTIVE DHE HAPËSIRAT REKREATIVE

Lloji i ndërtesave të fushave sportive dhe hapësirat rekreative të planifikuara për ndërtim:

- Ndërtesat e stadioneve;
- Ndërtesat e sallave sportive;
 - Salla e sporteve në Kraishtë, dhe Lipjan,
 - Renovimi i qendrës Tahir Sinani,
 - Ndërtimi i sallës së sporteve në Janjevë, Babush,
- Fushat sportive – rekreative shume – funksionale;
 - Ndërtimi i 5 fushave sportive (Tëqe, Kojске, Gllanic, Jeta e re, Qallapek)

	Vendbanimi	Numri i banoreve	Parcela per fushe sportive m ²
1	Tëqe	199	497.5
2	Kojске	365	912.5
3	Gllanicë	83	207.5
4	Jeta e re	1868	4670
5	Qallapek	286	715

- Shtigjet për çiklizëm;
 - Ndërtimi i shtigjeve për ciklizëm
 - Poligonet për ecje dhe rekreacion, Vogacice dhe Akllap

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

Madhësia e parcelës bazohet në numër të banorëve që ndërtesa shërben:

- Min 200m² - max 2,000m²

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHPKZh)

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim për ndërtesa sportive: max 60 %.

9.3 HAPËSIRAT DHE NDËRTIMET PËR SHËRBIME MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore në komunë Lipjanit ofrohen nëpërmes infrastrukturës së mëposhtme:

- Infrastruktura e institucioneve shëndetësore të nivelit parësor; dhe
- Infrastruktura e institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor;

9.3.1 INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE TË NIVELIT PARËSOR

Lloji i ndërtesave të institucioneve shëndetësore të nivelit parësor të planifikuara në komunë:

- Ndërtesat e qendrave kryesore të mjekësisë familjare (QKMF);
 - Renovimi i objektit të Stomatologjisë dhe Pulmologjisë në QKMF
- Ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare (QMF);
 - Renovimi i QMF-së në Janjevë,
 - Renovimi i QMF-ve në Shalë, Magure, Gadime.
- Ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare (PMF).

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

Madhësia minimale e parcelës varet nga rrezja shërbyese e institucionit shëndetësor dhe numrit të banorëve. Madhësia minimale e parcelës për ndërtim është 0.20 m²/banorë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHPKZh):

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim: 50 %.

9.3.2 INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE TË NIVELIT DYTËSOR

Bazuar në PZHK dhe administtratën komunale, komunat Lipjanit është e mbuluar mirë me infrastrukturë shëndetësore, përveç renovimit të institucioneve të nivelit dytësor.

Lloji i ndërtesave të institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor:

- Ndërtesat e spitaleve të përgjithshme dhe specialistike me njësitë përbërëse;
- Ndërtesat e poliklinikave specialistike;
- Ndërtesat e ambulancave specialistike;
- Ndërtesat e ambulancave stomatologjike;

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

Madhësia minimale e parcelës varet nga rrezja shërbyese e institucionit shëndetësor dhe numrit të banorëve. Madhësia minimale e parcelës për ndërtim është 1.20 m²/banorë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHPKZh)

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim: 50 %.

[illegible]

Sipas PZHK-së dhe administratës komunale, komuna e Lipjanit nuk parasheh ndërtimin e ndonjë institucioni kulturor për 8 vitet e ardhshme, përpos renovimit të atyre ekzistuese.

Lloji i ndërtesave për shërbime sociale:

- Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare;
- Ndërtesat e institucioneve për përkujdesje sociale ndaj personave me nevoja të veçanta;
- Ndërtesat e institucioneve të komunitetit.

Madhësia e parcelës bazohet në numër të banorëve që institucioni shërben:

- Ndërtesat e institucioneve sociale dhe familjare: min. 0.25 m²/banorë;
- Ndërtesat e institucioneve të komunitetit: min. 0.25 m²/banorë.

Lloji i ndërtesave të institucioneve kulturore që planifikohen në Lipjan:

- Ndërtesat e bibliotekave;
- Ndërtesat e muzeve;
- Ndërtesat e galerive të arteve dhe sallave ekspozuese;
- Ndërtesat e shtëpive të kulturës;
 - Projekti për rivitalizimin e Shtëpisë së Kulturës në Lipjan.
- Ndërtesat e teatrove;
- Ndërtesat e kinemave.

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

Madhësia e parcelës bazohet në numër të banorëve që institucioni shërben:

- Ndërtesat e bibliotekave: min. 0.25 m²/banorë;
- Ndërtesat e teatrove: 0.20 m²/banorë;
- Ndërtesat e kinemave: 0.20 m²/banorë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh):

- Ndërtesat e bibliotekave: max 60%;
- Ndërtesat e teatrove: max 80 %;
- Ndërtesat e kinemave: max 80 %.

9.5 SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET

9.5.1 NDËRTESTAT E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Lloji i ndërtesave të institucioneve parashkollore që planifikohen në Lipjan:

- Ndërtesat e çerdheve, grupmoshat ≤ 3 vjeç; dhe
 - Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime.
 - Ndërtimi i çerdhes në Sllovi.
 - Ndërtimi i çerdhes në Janjevë,
 - Ndërtimi i çerdhes në Dobrajë,
 - Ndërtimi i çerdhes në Magurë,
 - Ndërtimi i çerdhes në Rufc,
 - Ndërtimi i çerdheve në Shalë.
- Ndërtesat e kopshteve, grupmoshat 3 -5 vjet.

TABELA 10 MADHËSITË E PARCELAVE PËR ÇERDHE DHE KOPSHTË NE VENDBANIMET E PLANIFIKUARA:

	Vendbanimi	Numri i banoreve	Kushtet zhvillimore	
			Madhësia e parcelës për çerdhe	Madhësia e parcelës për kopsht
1	Dobrajë e Madhe	2224	667.2 m ²	2224 m ²
2	Gadime e Ulët	3337	1001.1 m ²	3337 m ²
3	Janjevë	2137	641.1 m ²	2137 m ²
4	Magurë	1670	501 m ²	1670 m ²
5	Rufc i Vjetër	1023	306.9 m ²	1023 m ²
6	Sllovi	3428	1028.4 m ²	3428 m ²
7	Shalë	2517	755.1 m ²	2517 m ²

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

- Min 1,000m² - max 4,000m²

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHPKZh)

- Ndërtesat e çerdheve: max 30%;
- Ndërtesat e kopshteve max 25%.

9.5.2 INSTITUCIONET E ARSIMIT PARA-UNIVERSITAR

Lloji i ndërtesave të institucioneve të arsimit para-universitar të planifikuara në Lipjan:

- Ndërtesat e shkollave fillore: grupmoshat 6 – 10 vjet;
 - Ndërtimi i shkolles fillore ne Gadime e Ulet;
 - Ndërtimi i shkolles fillore ne zonën urbane Lipjan.
- Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: grupmoshat 15- 19 vjet.

	Vendbanimi	Numri i banoreve	Madhësia e parcelës për shkollë m2
1	Gadime e Ulët	3337	5339.2
3	Zona urbane Lipjan -veri	2276	3641.6
4	Zona urbane Lipjan – veri lindje	3021	4833.6
5	Zona urbane Lipjan - jug perendim	2183	3492.8

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës

- Min 3,000m² - max 6,000m²

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh):

- Ndërtesat e shkollave fillore: max 40%;
- Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: max 60 %.

9.5.3 INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Lloji i ndërtesave të institucioneve të arsimit të lartë:


- Ndërtesat e arsimit të lartë - universitetet;
- Ndërtesat për hulumtime shkencore.

Kushtet e ndërtimit


Madhësia e parcelës bazohet në numër të banorëve që institucioni shërben: min. 1.0 m²/banorë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): max 60%.

HARTA 20: INSTITUCIONET ARSIMORE



HARTA 21: OBJEKTET FETARE DHE VARREZAT



9.6 QENDRAT ADMINISTRATIVE

Lloji i ndërtesave të qendrave administrative:

- Ndërtesat e institucioneve të administratës publike.
 - Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës Lipjan

Kushtet e ndërtimit

Madhësia e parcelës bazohet në numër të banorëve që institucioni shërben: min. 0.62 m²/banorë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): max 80%.

9.7 HAPËSIRAT DHE NDËRTESSAT E SIGURISË PUBLIKE

Rregullat për ndërtim për hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike përcaktohen nga ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse për këtë lloj të ndërtesave.


9.8 VARREZAT

Madhësia minimale e parcelës për varreza varet nga numri i banorëve dhe lloji i vendbanimit të cilit ju shërbejnë. Për të përlllogaritur hapësirën e nevojshme për varreza duhet të merret parasysh 1.50 m²/banorë. Pjesa grafike e HZK-së paraqet grafiksht hapësirat e varrezave në komunën e Lipjanit.

10 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në kaptinën e infrastrukturës teknike përfshihet infrastruktura publike teknike dhe e cila sipas PZHK-së ka për synim ndërtimin dhe përmirësimin e gjithë rrjetit të infrastrukturës teknike ku përfshihen: rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i kanalizimit, impiantet për trajtimin e ujërave të zeza, sistemet e drenazhimit, rrjeti i ujitjes, rrjeti i shpërndarjes lokale me energji termike, rrjeti i shpërndarjes lokale me energji elektrike, rrjeti i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme, rrjeti i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbiotkësorë dhe nëntokësorë ndërtesat për riciklim dhe dekompozim. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të infrastrukturës teknike, përcaktohen nga legjislacioni sektoral.

HARTA 22: INFRASTRUKTURA TEKNIKE



10.1 RRJETI I UJËSJELLËSIT

Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i ujësjellësit, ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse si dhe infrastruktura rrugore në kuadër të së cilës shtrihen këto rrjete.

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese e furnizimit me ujë të pijshëm, në komunën e Lipjanit janë në sistem të ujësjellësit rreth 67 % të qytetarëve, ku një përqindje e këtyre vendbanimeve ka nevojë për fuqizim të rrjetit të ujësjellësit ndërsa vetëm 33 % të qytetarëve janë jashtë sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Në territorin e komunës së Lipjanit janë identifikuar këto mundësi të furnizimit me ujë të pishëm:

- Qyteti i Lipjanit dhe vendbanimet përreth, kërkesat e tanishme dhe të ardhshme do të plotësohen nga ujërat nëntokësorë që shtrihen në sedimentet liqenore të basenit të Kosovës, gjegjësisht sedimentet e kuaternarit, në të dy anët e lumit Sitnicë.

- Vendbanimet; Krojmirë, Shalë, Resinovec, Baicë, ekzistojnë mund të furnizohen nga kaptimi i burimeve natyrore (kroni i kuq, shavarinat në Shalë, burimet natyrore në Krojmirë, vrella e ftohtë Baicë, akumulimi i ujërave në lumin Drenicë, shfrytëzimi i ujërave nëntokësore në të dy anët e lumit Drenica segmenti Shalë – Nekovc. etj.).

TABELA 11 LLOGARITJA E SASISË SË UJIT PËR VENDBANIMET ME MUNDËSI FURNIZIMA NGA BURIMET NATYRORE

Vendbanimet	Numri i banorëve për vendbanim	Kapaciteti i nevojshëm	Sasia e nevojshme për vendbanim
Zona Urbane	≥ 5001- 20000 banor:	≥ 150- 200 litra /banor;	
Te gjitha vendbanimet rurale	< 5000 banor:	≥ 100- 150 litra /banor.	
Krojmirë	1568	≥ 100- 150 litra /banor.	235,200 l
Shalë	2517	≥ 100- 150 litra /banor.	377,550 l
Resinovec	703	≥ 100- 150 litra /banor.	105,450 l
Baicë	1043	≥ 100- 150 litra /banor.	156,450 l

- Vendbanimet: Leletiq, Magurë, Vrellë, Medvec, Vërshec, Qyqylag, Dobrajë e Madhe dhe e Vogël, Lluga, Ribar i Madhë, Kraishtë, Bujan, Bregu i Zi, Poturovc, Torinë, Gllanicë, Grackë e Vogël dhe Topliqan; kanë dy mundësi të furnizimit me ujë të pijshëm,
- mund të shfrytëzojnë ujin nga burimi i Vrellës i cili ka 30 l/s duke rritë numrin e puseve përreth , gjegjësisht ujërat nëntokësore të Minierës së Goleshit, si dhe nga ujërat nëntokësore në Blinajë, sedimentet aluviale në lokalitetin ndërmjet fshatit Vërshec dhe Qyqylagë.

Pra, zgjidhja e furnizimit me ujë për vendbanimet e territorit të Lipjanit do të arrihej kryesisht me shfrytëzimin ujërave nëntokësore rreth 85 %.

Vendbanimet	Numri i banorëve për vendbanim	Kapaciteti i nevojshëm	Sasia e nevojshme e ujit për vendbanim
Zona Urbane	≥ 5001- 20000 banor:	≥ 150- 200 litra /banor;	
Te gjitha vendbanimet rurale	< 5000 banor:	≥ 100- 150 litra /banor.	
Leletiq	1568	≥ 100- 150 litra /banor.	235200 l
Magurë	2517	≥ 100- 150 litra /banor.	377550 l
Vrellë	703	≥ 100- 150 litra /banor.	105450 l
Medvec	1043	≥ 100- 150 litra /banor.	156450 l
Vërshec	896	≥ 100- 150 litra /banor.	134400 l
Qyqylag,	957	≥ 100- 150 litra /banor.	143550 l
Dobrajë e Madhe	2224	≥ 100- 150 litra /banor.	333600 l
Dobrajë e Vogël	215	≥ 100- 150 litra /banor.	32250 l
Lluga	327	≥ 100- 150 litra /banor.	49050 l
Ribar i Madhë	2200	≥ 100- 150 litra /banor.	330000 l
Kraishtë	1375	≥ 100- 150 litra /banor.	206250 l
Bujan	638	≥ 100- 150 litra /banor.	95700 l
Bregu i Zi	403	≥ 100- 150 litra /banor.	60450 l
Poturovc	720	≥ 100- 150 litra /banor.	108000 l
Torinë	588	≥ 100- 150 litra /banor.	88200 l
Gllanicë	83	≥ 100- 150 litra /banor.	12450 l
Grackë e Vogël	407	≥ 100- 150 litra /banor.	61050 l
Topliqan	1868	≥ 100- 150 litra /banor.	280200 l

Fuqizimi i furnizimit të ujësjellësit në zonat urbane dhe ato rurale:

Në zonën urbane të qytetit duhet të planifikohet:

- zgjerimi i rrjetit nëpër lagjet periferike,

- ndërrimi i rrjetit të vjetërsuar të ujësjellësit për të rezultuar në eliminimin e humbjeve të ujit të pijshëm, si dhe
- ngritja e cilësisë së ujit duke planifikuar dhe implementuar zonat mbrojtëse të puseve nga furnizohet qyteti me ujë të pijshëm;

Në zonat rurale duhet të planifikohet:

- Vendbanimet Magurë, Vrellë, Medvec dhe Dobrajë e Vogël të futen në sistem të menaxhimit të KUR "Prishitina" në mënyrë që të rritet kapaciteti dhe cilësia e shërbimit,
- Në vendbanimin Shalë të riparohet rrjeti ekzistues për të zvogëluar humbjet si dhe rregullimi i kaptazheve për rritjen e kapacitetit të furnizimit;
- Vendbanimet Poturovc, Rufci i Ri, Rufci Vjetër, Ribar i Vogël, të futen në sistem të furnizimit nga vendburimi i ujit në Vrellë;

Identifikimi i futjes në një sistem të ujësjellësit të disa vendbanimeve për të rritë cilësinë e shërbimeve si dhe menaxhimin më të lehtë me ujë të pijshëm, planifikohet të futen në një sistem të furnizimit këto vendbanime:

- Vendbanimet - Magurë, Vrellë, Medvec, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë, Poturovc, Torinë, Qytagë, Vërshëc, Leletiq, Ribar i Madh, Kraishtë, Bujan, Topliqan dhe Grackë e Vogël;
- Vendbanimet – Shalë, Krojmir, Baicë dhe Resinove;

Ndërtimi i avancimi i kaptazheve, fabrikave, i rezervuarve të ri për kapje ,akumulim dhe trajtim të ujit shifet si shumë e rëndësishme për komunën e Lipjanit në të ardhmen.

TABELA 12: NORMAT E FURNIZIMIT TË VENDBANIMEVE, ME SASINË E NEVOJSHME DITORE TË UJIT

Numri i banorëve për vendbanim	Vendbanimet	Kapaciteti i nevojshëm
≥ 5001- 20000 banor:	Zona Urbane	≥ 150- 200 litra /banor;
< 5000 banor:	Te gjitha vendbanimet rurale	≥ 100- 150 litra /banor.
Ujë për shfrytëzim për nevojat jo-konsumuese-rekreacion/ ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike:		
Sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet:	Të gjitha vendbanimet	1.50 litër/m ² .

TABELA 13: KUSHTET PËR PËRZGJEDHJEN E LOKACIONIT TË RRJETIT TË UJËSJELLËSIT¹²

Gjerësia e rrugës	Gjerësia e shtegut të këmbësorëve/trotuarit	Distanca nga vija ndërtimore
7.00 m	1.50 m	2.00 m
6.00 m	1.00	1.50 m
5.00 m	1.00 m	trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës

10.2 RRJETI I KANALIZIMIT

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik të banorëve të komunës së Lipjanit si dhe me mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja, janë planifikuar një mori projektesh të cilat dalin nga PZHK-ja. Këto projekte janë realizuar vetëm pjesërisht dhe planifikohet që brenda afatit të HZK-së, ato të cilat janë ende relevante të kompletohen.

- Sisteme të ndara të ujërave fekale dhe atmosferike në të gjitha vendbanimet duke filluar nga qyteti i Lipjanit. Ky projekt është realizuar në zonën urbane të Lipjanit, dhe nënqendra si Gadimja, mirëpo për zonën rurale ende.
- Planifikimi i funksionalizimit të disa segmenteve me rrjetë të vjetër, me profil jo adekuat ose për nevoja më të gjera duhet bëhet edhe në vendbanimet që kanë rrjet duke filluar nga Qyteti.

¹² Në rast të pa-mundësisë së plotësisht të ndonjërit nga kriteret e kërkuar me sipër, autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësiror është i obliguar të paraqesë alternative, ne konsultim me autoritetin përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti.

- Futja në sistem të kanalizimit të gjitha vendbanimeve të cilat janë jashtë sistemit të kanalizimit brenda 4 viteve;
- Grumbullimi i ujërave të zeza përgjatë shtratis të lumit Sitnicë është në proces dhe parashihet të përfundohet në fund të viti 2023. Po ashtu, parashihet trajtimi i tyre në një impiant të përbashkët në fund të vendbanimit Dorajë e madhe në Lumin Sitnicë në afërsi të kufirit komunal të Graçanicës, sipas këtij planifikimi:
 - Vendbanimet : Leletiq, Vershevc, Magurë, Vrellë, Medvecë, Poturovc dhe Torinë me shtrirje në drejtim të rrugës Torin – Lipjan
 - Vendbanimet Ribar i Madhë, Ribari i Vogël, Kraishtë, Dobrajë e Madhe dhe e Vogël , Gllanicë dhe fshatin LLugë.
 - Grumbullimi i ujërave të ndotura të vendbanimeve lindore dhe jug lindore do të arrihej me ndërtimin e trasesë në drejtim të rrjedhës së lumit Sitnicë, duke filluar nga fshati Rubovc në drejtim të fshatrave Glogovc, Banullë, duke përfshirë edhe rrjetin nga fshatrat përreth.
 - Prej fshatit Sllovi trasa të ndërtohet në drejtim me rrugën rajonale Sllovi – Lipjan, duke përfshirë grumbullimin e ujërave të fshatrave përreth.
 - Për Janjevën dhe vendbanimet përreth planifikohet ndërtimi i trases duke përcjellur gjithashtu drejtimin e lumit Janjevë.
 - Vendbanimet: Kroimirë, Shalë, Resinovc, dhe Baicë në drejtim të rrjedhës së lumit Drenicë deri te fshati Nekovc në kufirin administrativ të komunës së Lipjanit dhe Drenasit. Planifikohet mundësia e kyçjes së këtyre katër fshatrave në sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura në komunën e Drenasit me marrëveshje ndër komunale Lipjan – Drenas.

TABELA 14: KUSHTET PËR PËRZGJEDHJEN E LOKACIONIT TË RRJETIT TË KANALIZIMIT

Gjerësia e rrugës	Gjerësia e shtegut të këmbësorëve/trotuarit	Distanca nga vija ndërtimore
7.00 m	1.50 m	6.60 m
6.00 m	1.00	6.00 m
5.00 m	1.00 m	trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës

TABELA 15: MADHËSIA E PARCELËS PËR OBJEKTET E INFRASTRUKTURËS SË UJËRAVE TË ZEZA

Infrastruktura e ujërave të zeza	
Galeritë e kullimit Stacionet e pompimit për largimin e ujërave të tepërta Drenazhet Kolektorët për pranimin dhe transportin e ujërave të zeza Deponitë për materiet e ndotura Zonat e shkarkimit të ujërave të trajtuara Impiantet e ujërave të zeza	Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza duhet të planifikohet në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha
Rrjeti i kanaleve kryesore dhe dytësore	/
Gropat septike (GS)	Madhësia e GS varet nga kapaciteti i shfrytëzuesve: -min.3000l (shtëpi individuale) -min.5700l (grup shtëpish) -19000l për objekte fabrikuese

10.3 IMPIANTET PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA

Për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe pamundësisë së grumbullimit të ujërave të ndotura në afërsi të lumit Sitnicë duhet të planifikohet trajtimi ujërave të ndotura në një impiant të veçantë për këto vendbanime, në afërsi të kufirit me komunën e Gracanicës. Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza mbetet ende projekt pezull për shkak të varësisë nga niveli qëndror.

Për ndërtesat e trajtimit të ujërave të zeza kushtet e lokacionit duhet të jenë si në vijim:

- në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha;
- në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në lokacione jashtë vendbanimeve, dhe të izoluar nga vendbanimet;

Në rastet kur rrjeti i kanalizimit nuk mund të zbatohet për shkak të faktorëve të ndryshëm siç janë konfiguracioni i terrenit dhe numri i vogël i ekonomive familjare, atëherë duhet të planifikohet sisteme të largimit të ujërave të zeza përmes gropave septike.

Gropat septike duhet të planifikohet brenda parcelës kadastrale, t'i përmbahen standardeve sanitare dhe ekologjike, si dhe të kenë qasje të lehtë në rast të intervenimit në to.

10.4 RRJETI I SHPËRNDARJES LOKALE ME ENERGJI ELEKTRIKE

Bazuar në "Planin Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" deri në vitin 2023, parashihet që sistemi energjetik i Lipjanit të përmirësohet në me projektet si vijon:

Projektet e zgjerimit të nënstacioneve ekzistuese 110/35kV edhe me pjesën 10(20) kV

- Rritja e kapacitetit edhe me një transformator 31.5 MVA, 110/10(20) kV në nënstacionin NS Lipjani 110/35/10kV dhe eliminimi i rrjetit 35kV në NS Lipjani (2020).
 - Eliminimi i linjës 35kV mes NS 110/35Lipjan - NS 35/10kV Lipjani.
 - Eliminimi i nënstacionit 35/10kV Lipjani.
 - Zgjerimi i hapësirës së ndërtesës me kthinat e TM 10(20)kV adekuate .
 - Furnizimi i nëntë daljeve të mbetura 10 kV nga NS 35/20(10)kV Lipjan në NS 110/35/10kV Lipjani.

Zëvendësimin i Linjave Ajrore të nivelit të tensionit 0,4kV me LP Ajror kabllorik -Bistek dhe Kabllorik nëntokësor me kanale kabllorike. Rekomandimet dhe rregulloret e lartshënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

- Në pjesën rurale të komunës së Lipjanit ku tani gjenden të ndërtuar LP 10(20)kV me shtylla druri dhe beton, duhet të planifikohet ndërtim i LP të ri vetëm për tensione punues 20kV në mënyrë që gradualisht të mundësohet kalimi në tensionin 20kV.
- Rrjetet e tensionit të ulët (ajror) duhet të planifikohen gjithashtu me shtylla betoni dhe me kabllor vetëmbajtëse Alumini. Në këto shtylla duhet të planifikohet edhe ndriçimi publik i rrugëve.
- Ndriçimi publik i rrugëve kryesore të fshatrave do bëhet me llampa LED të vendosura në shtylla metalike me lartësi (8-10)m.

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit të infrastrukturës energjetike:

Linjat mbitokësore dhe nëntokësore, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim^{98*}:

- në bazë të vlerësimit të ndikimit të fushës magnetike dhe elektrike të krijuar nga rrjeti i linjave mbitokësore;

- në largësi nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies⁹⁹.
 - 40 m nga autoudhat;
 - 20 m nga rrugët nacionale; dhe
 - 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale.
- për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët kalkan të ndërtesës, nuk ka kufizim;
- për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2.00 m;
- për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1.00 m nga vija ndërtimore.


10.4.1 RREGULLAT PËR ZONAT E SIGURISË

Zonat e sigurisë nënkupton hapësirat e caktuara në të cilat janë të vendosura stabilimentet energjetike, me qëllim të mbrojtjes së sistemit të energjisë, jetën, shëndetin e qytetarëve apo të mirave materiale

- Zonat e sigurisë caktohen brenda dhe rreth zonave energjetike sipas definicionit dhe përcaktimeve nga UA 03/2017 mbi rregullat për Zonat e Sigurisë, si dhe legjislacioni përkatës.
- Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, kultivimi i bimësisë së lartë si drunjtë dhe pemët, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës.
- Kur pronarët ose shfrytëzuesit e pronës bëjnë ndërtime të palejuara, rrethime, prerje ose aktivitete të tjera që janë në kundërshtim me rregullat për zonat e sigurisë, dhe kur dështojnë përpjekjet për ndalimin e ndërtimeve ose aktiviteteve të tilla ilegale të paautorizuara brenda afateve kohore të vendosura nga ndërmarrja e energjisë, ndërmarrja e energjisë është e autorizuar që të kërkojë nga komuna ndalimin dhe heqjen e ndërtimeve ilegale ose ndalimin e aktiviteteve, me shpenzime të pronarit ose shfrytëzuesit.
- Komuna pas pranimi të kërkesës nga ndërmarrja e energjisë për intervenim, brenda shtatë (7) ditësh i kryen veprimet e rrënimit të ndërtimit joligjor apo e ndalon aktivitetin joligjor.
- Asnjë veprim apo mosveprim, nuk duhet ta parandalojë, apo ta ndërprejë operimin normal të ndërmarrjes së energjisë, të rrezikojë sigurinë e stabilimentit energjetik, sigurinë dhe pronën, jetën apo shëndetin e personave.
- Çdo ndërtim, apo çdo punë e kryer nga pronari apo shfrytëzuesi i pronës që gjendet në zonën e sigurisë i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim, nga ndërmarrja e energjisë. Ndërtimi i tillë duhet t'i përmbushë kushtet adekuate teknike dhe të sigurisë dhe nuk duhet të vë në rrezik jetën, shëndetin, apo sigurinë e personave.
- Zonat e sigurisë rreth stabilimenteve të energjisë elektrike përfshijnë tokën, hapësirën ajrore apo ujin që i rrethon stabilimentet e energjisë elektrike.
- Brenda zonës së sigurisë së stabilimentit të energjisë elektrike, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, është i ndaluar ndërtimi, kryerja e çfarëdo aktiviteti të gërmimit, mbushjes, prishjes, përmbytjes, ujitjes apo përmirësimit të tokës dhe mbjellja apo prerja e drunjëve dhe e vegetacionit.

- Në linjat nëntokësore, brenda zonës së sigurisë, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë është e ndaluar kryerja e veprimeve të gërmimit në tokë, gërmimit nën ujë për të lundruar apo për të lëvizur me spirancën e lëshuar, me zinxhirë, trungje apo rrjeta, si dhe vendosja e shenjave të trafikut dhe bovave për lundrim apo për të shkatërruar apo deponuar akullin.
- Në linjat nëntokësore brenda zonës së sigurisë, pa lejen e pronarit, apo të ndërmarrjes së energjisë, është e ndaluar operimi i mekanizmave ndikues në nivel të tokës, kryerja e punëve në thellësi, sipas rregullave dhe standardeve teknike të përcaktuara nga ndërmarrjet e energjisë elektrike.
- Nën linjat transmetuese ajrore brenda zonës së sigurisë, është e ndaluar:
 - vozitja e makinave apo operimi i makinerisë, lartësia e të cilave, me apo pa ngarkesë, kalon distancën sipas rregullave teknike të përcaktuara nga ndërmarrjet e energjisë;
 - ndërtimi i stallave, rrethojave dhe vendeve të ujit për bagëtinë dhe ndërtime të tjera.

FIGURA 5: KORIDORET E MBROJTURA TË LARGPËRQESËVE



10.5 RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT DHE INSTALIMEVE TË NGJASHME

Rrejtë i infrastrukturës së telekomunikacionit në komunën e Lipjanit është duke u bërë në bazë të kërkesës. Kryesisht pjesa qendrore është e pajisur me rrjet të internetit dhe kablovikut me përjashtim të fshatrave të cilat kanë shumë pak ekonomi familjare apo të braktisura fare. Shpërndarja e rrjetit të telefonisë fikse nuk shihet si relevante.

10.6 RRJETI I GRUMBULLIMIT DHE DEPONIMIT TË MBETURINAVE MBITOKËSORE DHE NËNTOKËSORE

Komuna e Lipjanit ka plan për shtrirjen e shërbimit në të gjithë territorin e saj, si në zonat ku ofrohet (mbulimi i tyre plotësisht me shërbim) ashtu edhe në zonat ku nuk ofrohet (por jo në mbulimin e territorit në masën 100%). Bazuar në këtë plan për shtrirjen e shërbimit, komuna Lipjan është ndarë në 3 zona (të përmendura pak më lart). Siç mund ta shohim edhe në tabelën më poshtë, Zona A, e cila ka prioritetin më lartë për shtrirjen e shërbimit, ka numrin më të madh të popullsisë dhe amvisërive dhe sasinë më të madhe të mbeturinave që gjeneron. Megjithatë, Komuna si objektiv afatshkurtër dhe afatmesëm ka vendosur që shërbimi të mos shtrihet në 100% të territorit të saj, por nga 16% të amvisërive të mbuluara me shërbim, të shkojë në 35% e tyre të mbuluara me shërbim. Në tabelën dhe grafikun më poshtë tregohet më qartë kjo situatë.

TABELA 16: POPULLSIA DHE SASIA E MBETURINAVE QË GJENEROHEN

Zona	Njësia	Nr. popullsisë	Amvisëri total të shërbyera	Nr. Amvisërive në të ardhmen	Amvisëri total në komunë
------	--------	----------------	-----------------------------	------------------------------	--------------------------

Zona A Prioritet 1	Baicë, breg i Zi, Bujan, Dobra. Madhe, Dobra Vogël, Gadime e epërme, Gadime e ulët, Gllanica, Grackë e vjetër, Grackë e vogël, Janjevë, Konjuh, Kraishtë, Krojmir, Leletiq, Lipjan, Llugaxhi, Magurë, Mirena, Poturoc, Qylagë, Resinoc, Ribar i Madh, Shalë, Sllavi, Topliqan, Torinë, Vrellë e Goleshit	40,112	3,942	2,116	11,329
Zona B Prioritet 2	Babush i Mahxhirëve, Banullë, Gllavicë, Gllagoc, Gumnasellë, Hallac i Vogël, Hallac i Madh, Kojkë, Medvec, Qallapek, Ribar i Vogël, Rubofc, Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Smallushë, Vërshet, Vrellë	14,082	1,240	622	3,364
Zona C Prioritet 3	Akllap, Brus, Bukovicë, Divjakë, Hanroc, Harilaq i Vogël, Kleqkë, Okosnicë, Shisharkë, Llugë, Plitkovicë, Marec, Teqe, Terbucë, Varigoc, Vagaqica, Zllokuqan	3,411	181	135	670
Totali		57,605	5,363	2,873	15,363

Ne baze te studimeve sektorale dhe ne koordinim me MMPHI eshte përcaktuar lokacioni per Deponi Regjionale te Mbeturinave, i paraqitur ne hartën 23.

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për deponitë e mbeturinave.

Duhet të planifikohen në lokacione si në vijim ¹³ :		Nuk duhet të planifikohen në lokacione si në vijim ¹⁴ :
në gryka të rrethuara me shpatina, sipërfaqe që kanë shërbyer për eksploatim, apo në lokacione të rrafshëta;		- në zonat e rrezikuara nga erozioni; - në zonat e rrezikuara nga vërshimet apo të vërshuar në 25 vitet e fundit; - në zonat me shkallë të lartë të rrezikshmërisë sizmike; - në zonat me pjerrtësi të thukët; - në zonat ku ujërat nëntokësorë janë afër sipërfaqes së tokës; - në zonat me pasuri minerale dhe minimet; - në zonat me përdorim intensiv të bujqësisë; - në zonat ku rrezikon llojet e veçanta të florës dhe faunës; - mbi strehimore apo tunele nëntokësore; - në zonat ku distanca nga fundi i deponisë deri tek niveli ujërave nëntokësore gjatë sezonit është < 2.00 m; - në zonat ku përshkueshmëria e tokës është > 0,00001 cm/s.
në largësi nga kufiri i zonës neutrale, që rrethon deponitë deri tek shfrytëzimet në vijim:		
nga rrjetet elektrike:	100 m	
nga infrastruktura hekurudhore:	100 m;	
nga ndërtesat e banimit:	500 m;	
nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze:	600 m;	
nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e liqeneve:	1000 m;	
nga vendbanimet:	1500 m;	
nga burimet e ujit dhe ujësjellësit dhe spitalet:	2000 m;	
nga spitalet:	2000 m;	
nga infrastruktura ajrore:	4000 m.	

10.7 NDËRTESAT DHE HAPËSIRAT PËR RICIKLIM DHE DEKOMPOZIM

Hapësirat dhe ndërtesat për riciklim dhe dekompozim, rregullohet në bazë të legjislacionit sektoral në fuqi. Ndërtesat e tilla duhet të pajisen me raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në bazë të planit komunal të menaxhimit të mbeturinave (PKMM), Komuna ka paraparë stacione të transferit brenda komunës së Lipjnit me qëllim të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme. Komuna

Objektet dhe impiantet për menaxhimin e mbeturinave duhet të paisen me leje përkatëse të cilan rrjedhin nga legjislacioni i menaxhimit të mbeturinave, të cilan duhet të përmbushin standardet teknike për veprimtarnë/llojin e mbeturinës që licencohen.

11 TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE


PZHK i Lipjanit ka identifikuar 9 vendbanime joformale. Sipas definicionit nga Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 04/L – 174) vendbanimet joformale janë vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit, dhe nuk kanë në zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

VJF ne komune e Lipjanit janë: VJF1 ne Qytet Lipjan dhe lagjja e Atllapit ne Qytet Lipjan, VJF Gadime e ultë, VJF në Janjevë, VJF në Sillovi, VJF në Vrell e Magurës, VJF në Dobraj të Vogël, VJF në Hallaq i vogël. Përderisa VJF në Konjuh dhe Magure konsiderohen të rregulluara.

11.1 KUSHTET ZHVILLIMORE PËR VENDBANIMET JOFORMALE

VJF te identifikuara janë planifikuar te trajtohen e ofrimit të shërbimeve si dhe rregullarizimin, formalizimin dhe orientimin e zhvillimit të ardhshëm. Ne veçanti, VJF në Janjevë, VJF në Dobraj të Vogël, VJF në Medvec duhet te kenë trajtim të aspektit pronësor nga organet kompetente, si dhe VJF në Vrell e Magurës ka nevojë për rregullim të aspektit social nga organet kompetente. Vendbanimet joformale duhet trajtuar sipas zonimit të tërë territorit të komunës dhe rregullave zhvillimore për cdo zonë. Trajtimi i vendbanimeve joformale do të bëhet sipas rregullave zhvillimore varësisht në cilën zonë gjendet këto vendbanime. Në të njetën kohë përmirësimit të VJF-ve duhet t’ju paraprijë edhe rregullimi i infrastrukturës publike, sociale dhe teknike. Duke pas parasysh që tashmë dominon hapësira e ndërtuar duke përfshi edhe objektet që janë në ndërtim e sipër, me HZK rekomandohet që pjesa e mbetur e objekteve të ndërtohen në përputhje me kushtet zhvillimore dhe masat të përcaktuara me zonë të banimit dhe zonat tjera relevante.

HARTA 24: VENBANIMET JOFROMALE



Shih shfrytëzimin e tokës dhe kushtet zhvillimore për vendbanimin Janjëvë në nënzonën e banimit – sipërfaqe rurale më intenzitet të lartë, dhe për vendbanimet Dobraj e Vogël, Medvec, dhe Vrellë e Magurës në nënzonën e banimit – sipërfaqe rurale me intenzitet të ulët.

13 PROCESET PËR NDRYSHIME, PËRJASHTIME, JOKONFORMITETE DHE BONUSET E ZONIMIT

13.1 NDRYSHIM PLOTËSIMET

Ndryshim plotësimet nënkuptojnë ndryshimet dhe plotësimet në pjesën tekstuale dhe hartografike të HZK-së së miratuar, për t'i përshtatur dispozitat e HZK-së me ndryshimet e kushteve të identifikuara apo të dala gjatë zbatimit të saj, ose për një interes bindës publik. Ndryshim plotësimet nuk duhet të përdoren për t'i dhënë privilegje ndonjë pronari të veçantë të pronës. Ndryshime plotësimet mund të porpozohen nga: Anëtarët e kuvendit komunal, Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim urban, Pronrët e parcelave kadastrale të sipërfaqës e cila do të jetë subjekt i ndryshimi të porpozuar.

Procesi i ndryshim plotësimi duhet të bëhet në proces dyhapësh: propozimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimi e cila miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal; dhe popozimin për dryshim plotësimin e HZK që miratohet nga 2/3 e anëtarëve të kuvendit të komunës.

Kryetari i Komunës duhet të themeloj Komisionin komunal për këshillim për ndryshim plotësime dhe përjashtime, i cili sëbashku me DUMM do të jetë përgjegjës për t'i shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me ndryshim plotësime.

Ndryshim plotësimet në HZK mund të aplikohen vetëm me vendim të Kuvendit Komunal dhe pëlqim të MMPH-së.

Procedura e aplikimit për ndryshim plotësimet dhe procedura e shqyrtimit nga DUMM apo komisioni komunal dhe publiku si dhe e miratimit kryhet sipas dispozitave të UA mbi Elementet dhe Kërkesat për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e HZK-së.

13.2 PËRJASHTIMET

Përjashtimet nënkuptojnë devijimet e lejuara nga kushtet zhvillimore apo ndërtimore të HZK-së së miratuar të cilat duhet të trajtohen në përputhje me dispozitat e UA mbi Elementet dhe Kërkesat për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e HZK-së. Komuna mund të lejojë përjashtime nga kushtet zhvillimore vetëm atëherë kur dëshmohet privimi i mundësisë së zhvillimit të një parcele kadastrale për shkak të:

- karakteristikave të veçanta të tokës e bëjnë të pamundur që aplikuesi t'u përmbahet të gjitha kushteve zhvillimore;
- kushteve unike të pronës e jo për shkak të kushteve të përgjithshme të lagjes.

Gjithashtu nëse dëshmohet që:

- përjashtimi nuk ka efekt dëmtues në mjedis ose në hapësirën gjithëpërfshirëse;
- privimi nuk është rezultat i veprimeve të marra nga pronari i tokës ose ish pronari;
- përjashtimi nuk do të krijojë ndikime negative në pronat fqinje ose pronat tjera në afërsi duke ndikuar në:
 - diellëzimin dhe ajrosjen e pronave fqinje;
 - trafik të shtuar dhe vështirësi në qarkullim të korridoreve transportuese në afërsi;
 - sigurinë publike duke përfshirë dhe rritjen e rrezikut nga zjarri ose rreziqet tjera të mundshme;
 - vlerat e pronave fqinje;

- shfrytëzimin dhe zhvillimin e pronave fqinje.
- për nevojat e personave me aftësi të kufizuar me c’rast përjashtimi mund të bëhet për qëllime të bërjes së parcelës dhe ndërtesës të qasshme për personin me aftësi të kufizuara që jeton në pronë. Në të tilla raste përjashtimi mund të jetë i kufizuar me kohëzgjatjen e aftësisë së kufizuar ose me kohën derisa personi jeton në atë pronë.

13.3 JONKOFIRMITETET

Jo konformiteti që ka ekzistuar para se të miratohet HZK lejohet të vazhdojë edhe nëse nuk është në përputhje me shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore të caktuara me HZK për atë që jo konformiteti vazhdon të plotësojë kërkesat e ligjeve të tjera.

Rregulloret në fuqi që promovojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien publike, duke përfshirë por duke mos u kufizuar kërkesat ndërtimore kundër zjarrit dhe shëndetësore zbatohen ndaj jo konformiteteve.

Komuna zbaton kushtet zhvillimore ndaj jo konformitetit në rastet kur:

- shfrytëzimi jo konform është ndryshuar;
- ndërtimi jo konform është zgjeruar, ndryshuar apo/dhe rindërtuar si shfrytëzim jokonform për arsye tjera që nuk janë me rëndësi madhore.

13.4 BONUSET E ZONIMIT

Zona e përcaktuar për Bonus të Zonimit është ZONAE BANIMIT, konkretisht nënzona e banimit [ZB-U1] SIPËRFAQE URBANE QENDRORE, DHE [ZB-U2] SIPËRFAQE URBANE E PËRGJITHSHME.

Bonuset e zonimit janë stimuj që jepen nga Komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik dhe përfshijnë:

- zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
- zvogëlim apo liri nga taksat për leje ose tarifat për infrastrukturë;
- zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi; rritje të % së sipërfaqes së shfrytëzueshmërisë së shputës në raport me parcelën kadastrale;
- rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës;
- rritje të dendësisë; dhe
- stimulim i propozuar nga zhvilluesi ose komuna për të integruar dhe përmirësuar vendbanimet joformale.

Komuna duhet të hartojë dhe miratojë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuset e zonimit. Rregulloret e tilla komunale duhet të jenë në përputhje me qëllimet, objektivat dhe strategjitë e PZHK-së që përdoren për të:

- rritur hapësirat e hapura ose sipërfaqet e gjelbra;
- ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve;
- ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike;
- ruajtur tokën bujqësore;
- krijuar ndërtesa dhe hapësira publike dhe sociale prej të cilave përfiton komuniteti;
- përfshirë dhe përmirësuar vendbanimet joformale;
- ofruar mundësi të tjera të dëshiruara nga Komuna në përputhje me PZHK.

Rregulloret komunale përmbajnë:

14 DISPOZITAT PËR INTERPRETIMIN, ANKESAT, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

14.1 DISPOZITAT PËR INTERPRETIMIN E SHFRYTËZIMEVE DHE KUSHTEVE ZHVILLIMORE TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Komuna e Lipjanit është bartëse për hartimin e dokumenteve të planifikimit, si dhe është përgjegjëse edhe për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të HZK-së. Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim Hapësinor nga Komuna e Lipjanit është Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis (DPUM) është përgjegjëse për administrimin, zbatimin dhe monitorimin e HZK por edhe realizimin e qëllimeve dhe objektivave të PZHK. DPUM është përgjegjës për interpretimin e rregullave të HZK-se. Sidoqoftë, i njëjti nuk ka fuqi të ndryshimit përmbajtjen thelbësore të HZK.

Harta zonale e komunës parashihet të jetë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse, për çështje praktike nuk mund të adresojë çdo çështje specifike të zonimit.

DPUM bën shqyrtimin dhe merr vendim me shkrim pas kërkesës me shkrim për interpretim të zonimit brenda afati prej 30 ditësh.

14.2 DISPOZITAT PËR INTERPRETIMIN E PROCESIT TË ANKESAVE

Pas kërkesës me shkrim nga palët e treta, DPUM bën shqyrtimin dhe merr vendim për kërkesën e interpretimit të HZK-se, në afat kohor prej 30 ditësh. Ankesat ndaj vendimeve të nxjerra behën në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

14.3 DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

DPUM në bashkëpunim me drejtoritë tjera sektorale është përgjegjëse për zbatim të HZK-se. Parakusht për monitorim të zbatimit është themelimi i Ekipit Komunal për Zbatim dhe Monitorim (EKZM), i cili trup duhet të themelohet me vendim të Kryetarit. EKZM duhet të themelohet në afat kohor prej 30 ditësh nga miratimi i HZK-se.

Përbërja e EKZM duhet të jete nga 1 anëtarë prej të gjitha drejtorive sektorale të Komunës. Koordinator i pare i EKZM duhet të jete anëtar nga DPUM me afat 12 muaj. Pastaj koordinatori i EKZM përzgjidhet nga Bordi i Drejtoreshave me rotacion nga anëtarët e drejtorive sektorale, prap me kohëzgjatje 12 mujore.

Kordinatori i EKZM kryen rolin e sekretariatit, duke mbledh dokumentacionin e nevojshme nga drejtoritë dhe institucionet tjera, përgatitjen e takimeve të rregullta, përcakton personin për mbajtjen e minutave nga takimet, shpërndan ftesat dhe dokumentacioni të mbledhur, dhe çdo detyrë tjetër që mund të rrjedhë në qellim të mbarëvajtjes së punës së EKZM.

Me qëllim të zbatimit të HZK-se, EKZM ka për detyrë të përpilojë planin vjetorë sektorale, të cilat janë në harmoni me kërkesat për zbatim të HZK-se, për secilën drejtori komunale. Këto plane sektorale finalizohen dhe shpërndahen tek të gjitha drejtoritë në afat kohor të mjaftueshëm që siguron integritetin e tyre në planin financiar komunal final që trajtohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me qëllim të përfshirjes në buxhetin e ardhshëm komunal.

14.4 DISPOZITAT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

DPUM në bashkëpunim me drejtoritë tjera sektorale është përgjegjëse për monitorim të zbatimit HZK-ës si dhe punës së EKZM. Drejtoritë sektorale përgatisin raportin vjetor të zbatimit të prioritetëve nga HZK-ës, dhe e dorëzojnë tek Kuvendi Komunal për shqyrtim dhe miratim. Përndryshe, pas miratimit nga Kuvendi Komunal, DPUM e dorëzon në MMPH raportin informues mbi gjendjen e zbatimit të HZK-ës.

Të udhëhequr nga DPUM drejtoritë komunale duhet çdo vit të përgatisin Raportin vjetor të zbatimit dhe vlerësimit të PZHK-së dhe HZK-së, i cili sipas UA nr. 24/2015 duhet të bazohet në analizat e:

- numrit të lejeve ndërtimore dhe numrit të certifikatave të shfrytëzimit të lëshuara sipas kategorisë së ndërtimit;
- statusit të mjedisit të rrezikuar;
- shkallës së prodhimtarisë;
- shkallës së ngritjes së cilësisë të shërbimeve publike dhe sociale;
- shkallës së ngritjes së cilësisë të shërbimeve transportuese dhe teknike;
- përqindjes së investimeve kapitale publike dhe publiko-private të zbatuara, sipas planifikimeve për vitin përkatës si: ndërtimin e infrastrukturës teknike, sociale dhe publike;
- shkallës së investimeve private të mëdha të planifikuara, nëse posedohen informata;
- anketimit të familjeve bujqësore, dhe
- rishqyrtimit të sasisë së përmbajtjes dhe përmasave të zbatimit të ndryshim plotësimeve, përjashtimeve dhe bonuseve të zonimit.

14.5 HYRJA NE FUQI

Me miratim të HZK-ës, qfuqizohet çdo plan tjetër i nivelit të barabartë dhe nivelit më të ulët.

SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE					
	Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës Lipjan (kodi 47780)	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Objekti i ri i administratës
	<u>Asfaltimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre në Komunë të Lipjanit</u>	I LARTË	AGJ	BK	Komuna	Raporti i asfaltimit të rrugëve
	<u>Përmirësimi i trotuareve dhe rrjetit të ndriçimit publik</u>	I LARTË	AGJ	BK	Komuna	Raporti i përmirësimit të ndriçimit publik
	Pastrimi dhe hapja e lumenjve në fshatra	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	Raporti i pastrimit të lumenjeve
	Ndërtimi i shtratit të Lumit në Bujari	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	Shtrati i ri i lumit
	Ndërtimi i shtratit të Lumit në Smallushe	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	Shtrati i ri i Lumit
	Ndërtimi i Hapsirave publike në Llugaxhi, Smallushe, Ruc të Vjetër, Ribar të Madh, etj	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	Raporti i ndërtimit të hapsirave publike
	Ndërtimi i rrethojave dhe mirëmbajtja e varrezave në fshatra	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Varrezat
	Fasadimi i Objektëve shumë banesore në Lipjan	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	ndriçimi publik
	Mbrojtja e burimeve të ujit në Konjuh	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	
	Perpilimi i projektëve për bujqësi organike në afërsi të zonave të mbrrotjura ujore (zona e tretë) në Konjuh	I MESËM	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	Projektet e reja për bujqësi organike
	Hartimi i projektit për zhvendosje të puseve	I MESËM	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Zhvendosja e puseve nga zona urbane. Sitnica, Fabrika e letrës	I LARTË	AFM	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	

¹⁵ I ULËT: DERI 20,000€; I MESËM: 20,000-150,000€; I LARTË: MBI 150,000€

¹⁶ AFSH (afatshkurtër) 1-3vjet.; AFM (AFM) 3-5 vjet.; AFGJ (AFGJ) 5-8 vjet

¹⁷ LEGJENDA: BK = Buxheti i komunës; BQ = Buxheti qeverisës qendër; BAZH&D = Buxheti i Agjensioneve Zhvillimore & Donatorë; OJQ = Organizata Joqeveritare; SP = Sektori privat

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën e Shales Shale, Krojmir, Rusinoc, Bajince,	I MESËM	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Raporti i rregullimit të rrjetit të ujësjellësit
	Rritja e kapacitetëve të burimit të ujit deri në 110 lit/sek, Konjuh	I MESËM	AFM	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe biçikletave përreth Lumit Sitnica nga rruga regjionale Ibrahim Rugova deri të rruga "Marie Shllaku"	I MESËM	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	Shtigjet për ecje dhe biçikleta
	Ndërtimi i rrjetit të shkarkimit të ujërave atmosferik paralel me ndërtimin e trotuareve dhe rrugëve sekondare (në rrugët ekzistuese dhe projektë të reja)	I LARTË	Në vazhdimësi	BK, BAZH&D	Komuna	
	Ndërtimi i ujësjellësit: Akllap, Baicë, Breg i Zi, Bujan, Dobrajë e Vogël, Grackë e Vogël, Hallaç i Madh, Kraishtë, Leletiq, Mirenë, Resinoc, Ribar i Madh, Topliqan, Varigoc, Zllokuqan	I LARTË	AFM	BK, BAZH&D	Komuna DSHP	Raporti i ndërtimit të ujësjellësit
	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat: Brus, Vogaçicë	I ULËT	AFGJ	BK, BAZH&D	Komuna DSHP	Raporti i ndërtimit të ujësjellësit
	Ndërtimi/zgjerimi i kanalizimit në fshatra dhe lagje të qytetit	I LARTË	AFM	BK, BAZH&D	Komuna DSHP	Rrjeti i kanalizimit të ndërtuar
	Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza për fshatrat Blinaj, Qylage, Dobraje e Madhe	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Kolektori
	TRANSPORTI					
	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në rruget e qytetit dhe të fshatrave, pengesat në rrugë në afërsi të shkollave dhe QMF-ve dhe AMF-ve.	I MESEM	AFM	BK	Komuna	
	Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve në gjitha fshatrat	I MESËM	AFM	BK	Komuna, DSHP	Rregullimi i linjës së autobusëve
	PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDIS					
	Hartimi i projekteve detale (kodi 47448)	I LARTË	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	
	Plani Rregullues i Hollësishëm i Janjevës	I MESEM	AFGJ	BK, MKRS, BAZH&D	Komuna	Hartimi dhe aprovimi i PRRH
	SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE					
	Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF kodit 47647	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Pajisjet e reja për QKMF

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	Blerja e aparaturave per QKMF	I MESËM	AFSH	BK	Komuna	Aparatet e reja për QKMF
	ARSIMI					
	Ndërtimi i çerdhes ne fshatin Gadime	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Çerdhe e re
	Ndërtimi i çerdhes ne Sllovi	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Çerdhe e re
	Instalimi i Kamerave IEA në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës (SHFMU dhe SHML)	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Instalimi i Kamerave
	Kabinetët e TIK-ut ne IEA	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Kabinetet be shkolle
	Ndërtimi i shkolles Fillore ne zonën urbane Lipjan	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Shkola fillore e re
	Ndërtimi i shkolles Mesme ne Gadime	I LARTË	AFSH	BK	Komuna	Shkola fillore e re
	Ndërtimi i çerdheve të reja në , Sllovi, Gadime, Rufe i Ri dhe Shale	I LARTË	AFGJ	BK	Komuna	Çerdhet e reja
	ZHVILLIMI EKONOMIK					
	Rehabilitimi i shtretërve të lumenjëve me qëllim të eliminimit të vërshimeve dhe dëmtimit të tokave bujqësore	I LARTË	AFM	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Raporti i renovimit te shtretërve te lumenjve
	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore me qëllim të rritjes së sektorit të bujqësisë. Lokacioni: Rrugët e kategoris IV	I LARTË	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Raporti i ndërtimit te infrastrukturës rrugore
	Promovimi i brendit lokal dhe ofrimi i kushteve për produkte vendore për plasimin e tyre tek Tregu i gjelber dhe tregu i kafsheve	I MESEM	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Përkrahja e bujqve përmes ofrimit të tofrimit të ptrajnameve, këshillave me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së përmes funksionalizimit të Qendrës Trajnuese NorgesVel	I LARTË	AFGJ	BK, BQ, BAZH&D , SP	Komun, donatoret	
	Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave në viset rurale	I LARTË	AFGJ	BK, BQ, BAZH&D , SP	Komuna, niveli	

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
					qendrore, donatoret	
	Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes instalimit të stacioneve për matjen e kushteve Klimatike (Llugaxhi, Konjuh, Krojmir, Rufc)	I ULET	AFSH	BK, BQ, BAZH&D , SP	Komuna, sektori privat, donatoret	
	Krijimi i zonave zhvillimore për bujqësi	I MESËM	AFSH	SP	Komuna	Zonat e reja për bujqësi
	Funksionalizimi dhe mbajtja vjetore e Panairit për promovimin e produktëve bujqësorë, artizanatëve, dhe produktëve tjera lokale të sheshin Adem Jashari dhe NorgesVel	I ULËT	AFSH	BK, SP, OJQ	Komuna	Panairët për promovimin e produkteve bujqësore
	Ngritja e kapacitetëve për deponim, përpunim dhe konservim të frutave në hapësirat e parapara në plan por edhe në zonat komerciale dhe industriale të Lipjanit (Qylage)	I MESËM	AFM	BK, SP	Komuna	
	Fuqizimi i profileve profesionale në shkollën Adem Gllavica me qëllim të kualifikimit dhe rikualifikimit të rinjve të papunë dhe nxitja e ndërmarrësi-së të rinjtë përfshie dhe renovimin e hapësirave të shkollës për këtë qëllim	I MESËM	AFM	BK, BQ, BAZH&D , SP, OJQ	Komuna	
	Themelimi i qendrës për trajnim dhe aftësim “Life time learning” në fushën e Bujqësisë (Norges Vel)	I MESËM	AFM	BK, BQ, BAZH&D , SP, OJQ	Komuna	
	Laboratorë dhe hapësira eksperimentuese të fushës së bujqësisë për analiza dhe studime të avancimit të cilësisë dhe sasisë. Shkolla e mesme profesionale “Adem Gllavica”, Lipjan	I LARTË	AFM	BK, SP	Komuna	
	Ngritja e kapacitetëve prodhuese në pemëtari në zonat ku ka ujë të mjaftueshëm	I MESËM	AFSH	BK, SP, BQ	Komuna	
	Projektet e hortikulturës, bimëve medicinale dhe aromatike për hortikulturë në periferi të qytetit të Lipjanit, kurse për bimë mjeksore, dhe aromatike në fshatrat kodrinore malore	I ULËT	AFSH	SP	Komuna	
	Investime në pajisjet për ujë. Konjuh, Llugaxhi, Gumnasellë, Sllavi, Ribar, Banullë, Gllugoc, Bujan, Topliqan, Rufc, Dobraj, Magure, Lluga dhe në fshatrat tjera.	I MESËM	AFM	BK, BQ, SP	Komuna	Pajisjet për ujë

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	Gjetja e burimeve për ujitje dhe investimi në hapjen e burimeve për ujitje. Konjuh, Llugaxhi, Gumnasellë, Slllovi, Ribar, Banullë, Glllogoc, Bujan, Topliqan, Rufc, Dobraj, Magure, Lluga dhe në Fshatrat tjera.	I LARTË	AFGJ	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Hapja e burimeve të reja për ujitje
	Funksionalizimi dhe promovimi i Zonës Ekonomike/Industriale Qylagë	I LARTË	AFM	BK, BQ	Komuna dhe MTI	Zona ekonomike e funksionalizuar
	Kyçja e Diasporës dhe tërheqja e investimeve nga diaspora përmes organizimit të Javës së Diasporës në sheshin Adem Jashari	I ULËT	AFSH	DIASPORA	Komuna	
	Përmirësimi i klimës investive përmes thjeshtimit të procedurave administrative (decentralizimit) të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve tek drejtoratet tjera relevante të Komunës së Lipjanit	I MESEM	AFM	BK, BAZH&D	Komuna	
	Zhvillimi i Zonës ekonomike – Zona Veri-Lindore Lipjan (Konjuh)	I MESËM	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Hartimi i projektit ideor dhe kryesor i një qendre zejtar në qytetin e Lipjanit dhe plotësimi i infrastrukturës	I ULËT	AFM	BK	Komuna	Projekti ideor i qendrës zejtare
	Mbështetja dhe subvencionim i ndërmarrësve, gruas dhe të rinjeve në fushën e zejtarisë dhe krijimi i këndeve në Janjevë, Gadime, Blinajë, etj.	I ULET	AFSH	BK, OJQ, BAZH&D	Komuna	
	Krijimi i infrastrukturës fizike dhe profesionale për shkollimin profesional në zejtarë, këshillim, rritjen e aftësive të sipërmarrësve, trajnimin dhe kualifikimin profesional të artizanëve	I ULËT	AFGJ	BK, OJQ, BAZH&D	Komuna	
	Funksionalizimi i Tregjeve të hapura në qytetin e Lipjanit dhe Magure	I MESEM	AFSH	BK, OJQ, BAZH&D	Komuna	Tregjet e hapura
	Asfaltimi i rrugës në Hanroc në shërbim të turizmit	I LARTË	AFGJ	BK	Komuna, donatorë	
	Adaptimi i shkollës në Hanroc në funksion të turizmit - pushimore për fëmijë	I LARTË	AFGJ	BK	Komuna, donatorë	
	Krijimi i qendrave informative turistike. Në fillim qendra informative turistike duhet të krijohet në qytetin e Lipjanit	I MESËM	AFM	BK	Komuna	Nr i qendrave informative turistike
	Shenjëzimi i zonave, objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore nga hartat në hapësirë në tërë territorin e komunës së Lipjanit	I ULËT	AFM	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Implementimi i projektit “Restaurimi i shtëpive në Janjevë” i cili ka për qëllim zhvillimin e turizmit përmes promovimit të trashëgimisë kulturore në Janjevë	I LARTË	AFM	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	Hapja dhe Asfaltimi i Rrugës Janjevë – Brus – te infrastruktura	I LARTË	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Raporti i asfaltimit te rrugës
	Asfaltimi i Rrugës Janjevë – Vukoqince - te infrastruktura	I LARTË	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	Raporti i asfaltimit te rrugës
	Mbështjetja dhe promovimi i Banjës së Bainsës EKON	I MESËM	AFM	BK, BAZH&D	Komuna	Raporti i përfundimit te projektit te Kalasë
	Promovimi i këtyre vendbanimeve për turizmit rinorë, kulturorë, rekreativ ,rural dhe agroturizëm Janjeva (Turizmi kulturor dhe njëra ndër shkollat e para shqipe në Kosovë). Kleçka dhe Divjaka (Trashëgimia kulturo historike).Krojmir dhe Shalë(turizëm rekreativ). Gadimja (turizëm kulturor dhe rekreativ. Janjeva dhe Lypjani (turizëm kulturor "Kisha e Shën Florit dhe Kisha e Notradamit"). Lipjanit, Gadime (Trashëgimi kulturor historike si dhe mundësi të mira për turizëm kongresial. – përcaktimi i masave për turizëm (Vërshevc, zona pyjore, gryka e shalës, klëckë, kryka e shpëtimit në Krojmir)	I MESËM	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Evidentimi i objekteve hoteliere dhe kategorizimi i tyre EKONOM	I ULËT	AFGJ	BQ, BK	Komuna	
	KULTURË RINI DHE SPORT					
	Renovimi i Qendrës Tahir Sinani	10,000.00	AFSH	BK	Komuna	Raporti i renovimit te qendrës se Athir Sinani
	Ndërtimi i sallës se sporteve ne Janjeve	270,000.00	AFSH	BK	Komuna	Salle e re e sporteve nr. i aktiviteve sportive
	Ndërtimi i Sallës se Sportëve ne Babush	270,000.00	AFSH	BK	Komuna	Salle e re e sporteve nr. i aktiviteve sportive
	Ndërtimi i Qendrës Rinore ne Janjeve	350,000.00	AFSH	BK	Komuna	Salle e re e sporteve nr. i aktiviteve sportive
	Ndërtimi i ulëseve dhe shtrimi me bari artificial i fushat ekzistuese të futbollit ne fshatra (listo fshatrat)	280,000.00	AFSH	BK	Komuna	Raporti i renovimit te fushave te futbollit ne fshatra
	Ndërtimi i palestrës së re Sportive në Lipjan (ne proces)	1,900,000.00	AFSH	BK	Komuna	Palester e re e sporteve

	AKTIVITËTËT / VEPRIMI	KOSTOJA E PËRAFËRT E ZBATIMIT ¹⁵	PERIUDHA E ZBATIMIT ¹⁶	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT ¹⁷	INSTITUCION I PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	INDIKATORI I ZBATIMIT TË HZK-SË
	Ndertimi i shtsigjeve te ecjes ne Gadime	I MESËM	AFGJ	BK, BAZH&D	Komuna	
	Hartimi i projekteve dhe fillimi i zbatimit për Poligonet për ecje dhe rekreacion, Vogaçicë, Akllap.	I ULËT	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	Poligonet për ecje dhe rekreacion
	Hartimi i projektëve për çiklizëm si përmbajtje e rrugëve kryesore (sipas hartës)	I ULËT	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	
	Përgatitja e projekt propozimeve për sportin e tenisit, peshkimit, gjuetisë, kalërimit etj.	I ULËT	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	
	Hartimi i projekteve për sport dhe rekreacion në çdo vendbanim	I MESËM	Në vazhdimësi	BK, BAZH&D	Komuna	
	Krijimi i kushteve për angazhim në grupe të recitatorëve, dramatike, muzikës në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme	I ULËT	AFSH	BK, BAZH&D	Komuna	
	Përkufizimi, piketimi dhe sinjalizimi i zonës së mbrojtur në nivel të Kosovës sipas Planit të Ahtisarit për Kishën e “Shën Florit”	I ULËT	AFSH	BK, BQ, BAZH&D	Komuna	
	Projektet për parandalimin e dukurive aktuale që cenojnë trashëgiminë kulturore me masa teknike, profesionale dhe legale (të prezantuar në hartën “Trashëgimia Kulturore”)	I ULËT	AFM	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Markimi i zonave arkeologjike të definuara në listën e MKRS	I MESEM	Në vazhdimsi	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Futja në listën e Vlerave dhe marrja nën përkujdesjen institucionale të përmendoreve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së	I ULËT	AFSH	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Projekti për rivitalizimin e Shtëpisë së Kulturës në Lipjan	I ULËT	AFM	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Projektet ideore, kryesore dhe të filloj zbatim i tyre për shtëpi kulture në qendrat sekondare të parapara me këtë plan	I MESËM	AFM	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Krijimi i hapësirave dhe kushteve për biblioteka në lokalitetet e parapara me plan	I MESËM	AFM	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Përgatitët projekti ideore, Kryesor dhe të filloj zbatimi për kthimin pamjes së njëres prej Shkollave të para shqipe në Kosovë ajo në Janjevë dhe fuqizimi i sajë si muze	I MESËM	AFGJ	BK, BQ, BAZH&D, SP	Komuna	
	Përgatitja e projektit për promovim e shtëpisë së Shtjefan Gjeqovit	I ULËT	AFSH	BK, BQ	Komuna, MKRS	

SHTOJCA 2: VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

SHTOJCA 3:

	Vendbanimi	Regjistrimi i viti7 2011 (ASK)	Regjistrimi i viti7 2011, ekonomive familjare (ASK)	Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK)	Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK)	Parashikimi rritjes së popullsisë 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi rritjes së ekonomive familjare 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)
1	Akllap	699	108	707	110	720	113	774	121
2	Babush i Muhaxherve	1206	214	1219	191	1242	194	1335	209
3	Baicë	1043	141	1055	165	1074	168	1155	180
4	Banullë	1694	286	1713	268	1745	273	1876	293
5	Breg i Zi	403	74	407	64	415	65	446	70
6	Brus	328	45	332	52	338	53	363	57
7	Bujan	638	105	645	101	657	103	706	110
8	Bukovicë	12	1	12	2	12	2	13	2
9	Divlakë	68	10	69	11	70	11	75	12
10	Dobrajë e Madhe	2224	357	2249	351	2291	358	2462	385
11	Dobrajë e Vogël	215	33	217	34	221	35	238	37
12	Gadime e Ulët	3337	538	3374	527	3437	537	3695	577
13	Gllanicë	83	9	84	13	85	13	92	14
14	Gllavicë	248	41	251	39	255	40	275	43
15	Glllogoc	1440	240	1456	228	1483	232	1594	249
16	Grackë e Vogël	407	68	412	64	419	66	451	70
17	Gumnasellë	1224	183	1238	193	1261	197	1355	212
18	Hallaç i Madh	418	62	423	66	431	67	463	72
19	Hallaç i Vogël	664	108	671	105	684	107	735	115
20	Hanroc	51	9	52	8	53	8	56	9
21	Kleqkë	228	23	231	36	235	37	252	39
22	Kojस्कë	365	62	369	58	376	59	404	63

23	Konjuh	628	114	635	99	647	101	695	109
24	Kraishtë	1375	214	1390	217	1416	221	1522	238
25	Krojmir	1568	217	1585	248	1615	252	1736	271
26	Leletiq	350	58	354	55	361	56	388	61
27	Lipovicë	:	:	0	0	0	0	0	0
28	Llugagji	1157	196	1170	183	1192	186	1281	200
29	Llugë	327	48	331	52	337	53	362	57
30	Marec	271	47	274	43	279	44	300	47
31	Medvec	1178	198	1191	186	1213	190	1304	204
32	Mirenë	519	75	525	82	535	84	575	90
33	Okosnicë	2	1	2	0	2	0	2	0
34	Plitkoviç	56	7	57	9	58	9	62	10
35	Poturoc	720	117	728	114	742	116	797	125
36	Qellapek	286	49	289	45	295	46	317	49
37	Qylagë	957	147	968	151	986	154	1060	166
38	Resinoc	703	109	711	111	724	113	778	122
39	Ribar i Madh	2200	340	2225	348	2266	354	2436	381
40	Ribar i Vogël	542	104	548	86	558	87	600	94
41	Rubofc	723	131	731	114	745	116	800	125
42	Rufc i Ri	507	86	513	80	522	82	561	88
43	Rufc i Vjetër	1023	159	1034	162	1054	165	1133	177
44	Smallushë	1276	190	1290	202	1314	205	1413	221
45	Shisharkë	:	:	0	0	0	0	0	0
46	Teqe	199	30	201	31	205	32	220	34
47	Tërbufc	30	4	30	5	31	5	33	5
48	Topliqan	1868	279	1889	295	1924	301	2068	323
49	Torinë	588	105	595	93	606	95	651	102
50	Varigoc	252	31	255	40	260	41	279	44
51	Vërshec	896	135	906	142	923	144	992	155

52	Vogaçicë	:	:	0	0	0	0	0	0
53	Vrellë	157	19	159	25	162	25	174	27
54	Vrellë e Goleshit	336	51	340	53	346	54	372	58
55	Zllokuqan	270	34	273	43	278	43	299	47
		37'959	6'012	38'382	5'997	39'100	6'109	42'028	6'567

SHTOJCA 4:

	Vendbanimi	Sipërfaqja e rezervuar për banim të përhershëm për 8 vitet e ardhshme - ha	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për banim të përhershëm (ndërtimi aktual) - ha	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përhershëm - ha	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (sipas trendit të rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (sipas trendit të rritjes 0.93%)	Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përhershëm 20210-2029 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm - banim i përhershëm
1	Akllap	62	24	38	54	8	1	37
2	Babush i Muhaxherve	48	46	2	93	15	1	1
3	Baicë	37	26	10	80	13	1	9
4	Banullë	99	64	35	131	20	1	34
5	Breg i Zi	35	17	18	31	5	0	18
6	Brus	52	12	40	25	4	0	40
7	Bujan	48	31	17	49	8	0	17
8	Bukovicë	10	2	8	1	0	0	8
9	Divlakë	7	4	3	5	1	0	3
10	Dobrajë e Madhe	128	82	46	172	27	2	44
11	Dobrajë e Vogël	16	6	10	17	3	0	9
12	Gadime e Ulët	148	95	53	257	40	2	51
13	Gllanicë	10	4	6	6	1	0	6
14	Gllavicë	16	10	6	19	3	0	6

15	Gllgoc	84	53	31	111	17	1	30
16	Grackë eVogël	37	31	6	31	5	0	6
17	Gumnasellë	57	36	21	94	15	1	20
18	Hallaç i Madh	38	20	18	32	5	0	18
19	Hallaç i Vogël	36	31	5	51	8	0	5
20	Hanroc	17	6	11	4	1	0	10
21	Kleqkë	15	8	7	18	3	0	6
22	Kojskë	28	15	13	28	4	0	12
23	Konjuh	61	24	37	48	8	0	36
24	Kraishtë	84	50	34	106	17	1	33
25	Krojmir	71	53	19	121	19	1	18
26	Leletiq	30	20	10	27	4	0	10
27	Lipovicë	3	3	0	0	0	0	0
28	Llugagji	36	27	9	89	14	1	8
29	Llugë	27	11	17	25	4	0	16
30	Marec	9	8	1	21	3	0	1
31	Medvec	38	36	2	91	14	1	1
32	Mirenë	28	19	9	40	6	0	9
33	Okosnicë	2	2	1	0	0	0	1
34	Plitkoviç	16	4	13	4	1	0	13
35	Poturoc	40	35	5	56	9	1	4
36	Qellapek	12	10	2	22	3	0	2
37	Qylagë	43	40	3	74	12	1	2
38	Resinoc	49	26	23	54	8	1	23
39	Ribar i Madh	120	80	40	170	27	2	38
40	Ribar i Vogël	37	28	9	42	7	0	9
41	Rubofc	73	43	31	56	9	1	30
42	Rufc i Ri	39	37	2	39	6	0	1
43	Rufc i Vjetër	55	45	9	79	12	1	9
44	Smallushë	75	39	36	98	15	1	35
45	Shisharkë	2	2	0	0	0	0	0
46	Teqe	19	6	13	15	2	0	13
47	Tërbufc	6	1	5	2	0	0	5
48	Topliqan	57	40	17	144	23	1	15

49	Torinë	43	26	17	45	7	0	17
50	Varigoc	15	10	5	19	3	0	5
51	Vërshëc	57	39	19	69	11	1	18
52	Vogaçicë	3	1	2	0	0	0	2
53	Vrellë	10	4	5	12	2	0	5
54	Vrellë e Goleshit	35	35	0	26	4	0	0
55	Zllokuqan	14	10	4	21	3	0	4
		2234	1433	801	2927	457	27	773

SHTOJCA 5:

	Vendbanimi	Regjistrimi i viti 2011 (ASK)	Regjistrimi i viti 2011, ekonomive familjare (ASK)	Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK)	Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK)	Parashikimi rritjes së popullsisë 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi rritjes së ekonomive familjare 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)
1	Gadime e Epërme	2641	437	2'670	442	2'720	450	2'924	484
2	Janjevë	2137	401	2'161	405	2'201	413	2'366	444
3	Magurë	1670	297	1'689	300	1'720	306	1'849	329
4	Silovi	3428	562	3'466	568	3'531	579	3'795	622
5	Shalë	2517	367	2'545	371	2'593	378	2'787	406
		12393	2064	12531	2087	12766	2126	13721	2285

SHTOJCA 6:

	Vendbanimi	Sipërfaqja e rezervuar për banim të përhershëm për 8 vitet e ardhshme - ha	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për banim të përhershëm (ndërtimi aktual) - ha	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përhershëm - ha	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%) - rritja neto	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%) - rritja neto	Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përhershëm 20210-2029 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm - banim i përhershëm - ha
1	Gadime e Epërme	179	80	99	204	34	2	97
2	Janjevë	120	57	63	165	31	2	61
3	Magurë	67	51	16	129	23	1	15
4	Sllovi	251	107	144	264	43	3	142
5	Shalë	86	71	15	194	28	2	13
		703	366	337	956	159	10	328

SHTOJCA 7:

NNËZONA	Regjistrimi i vitit 2011 (ASK)	Regjistrimi i vitit 2011, ekonomive familjare (ASK)	Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK)	Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK)	Parashikimi rritjes së popullsisë 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi rritjes së ekonomive familjare 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)
Siperfaqe sub-urbane	3,350	609	3,387	616	3,450	627	3,709	674

SHTOJCA 8:

NNËZONA	Sipërfaqja e rezervuar për banim të përherëshëm për 8 vitet e ardhshme - ha	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për banim të përherëshëm (ndërtimi aktual) - ha	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm - ha	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përherëshëm 20210-2029 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm - banim i përherëshëm
Sipërfaqe sub-urbane	331	226	105	258	47	2	103

SHTOJCA 9:

NËNZONA	Regjistrimi i viti 7 2011 (ASK)	Regjistrimi i vitit 2011, ekonomive familjare (ASK)	Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK)	Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK)	Parashikimi rritjes së popullsisë 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi rritjes së ekonomive familjare 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 – 2029 (trendi i rritjes 0.93%)
Sipërfaqe urbane e përgjithshme	1628	358	1646	329	1677	335	1802	360

SHTOJCA 10:

NËNZONA	Sipërfaqja e rezervuar për banim të përherëshëm - ha	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për banim të përherëshëm -ndërtesa me shumë njësi - ha	Sipërfaqja për dendësim, hapësire aktuale e shfrytëzuar për banim të përherëshëm -shtëpi njëshe dhe dyshe aktual - ha	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm - ndërtesa me shumë njësi - ha	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%) - banorë	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%) - banorë	Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përherëshëm 20210-2029 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha	Sipërfaqja e lirë për zhvillim të ardhshëm - banim i përherëshëm
Sipërfaqe urbane e përgjithshme	136.4	4.5	29.2	103	126	25	0.07 1.0	135

SHTOJCA 11:

NËNZONA	Regjistrimi i vitit 2011 (ASK)	Regjistrimi i vitit 2011, ekonomive familjare (ASK)	Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK)	Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (trendi i rritjes 0.93%)
Sipërfaqe urbane qendrore	2,156	462	2,180	436	2,221	444	2,387	477

SHTOJCA 12:

Vendbanimi	Sipërfaqja e rezervuar për banim të përherëshëm - ha	Sipërfaqja aktuale e shfrytëzuar për banim të përherëshëm -ndërtesa me shumë njësi - ha	Sipërfaqja për dendësim, hapësire aktuale e shfrytëzuar për banim të përherëshëm -shtëpi njëshe dhe dyshe aktual - ha	Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përherëshëm - ndërtesa me shumë njësi - ha	Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2029 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - banorë	Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2029 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - banorë	Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përherëshëm 20210-2029 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha	Sipërfaqja për dendësim të ardhshëm - banim i përherëshëm - ha
Sipërfaqe urbane qendrore	36	12.3	23.7	0.0	166	33	0.08 1.25	11.00